



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 15 SHTATOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
15. SEPTEMBAR 2010. GODINE**

**SHTATOR – SEPTEMBAR
2010**

E mërkurë, 15 shtator 2010, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim ose në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare, andaj procedojmë sipas rendit të ditës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetëve deri në 3 minuta.

Fillimisht, kush është paraqit në emër të grupit?
Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryetar,
Zoti kryeministër,
Zotërinj deputetë,

Sezoni i vjeljes së rrushit në Kosovë filloi me problemin e plasimit të tij në treg. Qysh më 8 mars të këtij viti, menaxherët e kompanive ekzistuese të verërave, që janë 7 në komunën e Rahovecit, kanë shkruar shkresa për presidentin e Kosovës, ministrin e Bujqësisë, ministrin e Ekonomisë, kryetarin e komunës dhe përfaqësuesin e Zyrës Civile Ndërkombëtare, Piter Feith, duke i paralajmëruar për problemet që po ekzistojnë dhe që do të paraqiten pas vjeljes së rrushit. Por, deri para 3 jave me këtë problem nuk ka dashur të merret askush, derisa edhe vetë bujqit e kanë ngritur këtë çështje si problem. Pasi që jam deputete e Kuvendit të Kosovës dhe jam me origjinë nga Rahoveci, kam marrë disa letra nga prodhuesit e rrushit me shpresë se ndoshta edhe Kuvendi i Kosovës do ta ngrejë këtë çështje dhe do të bëjë presion në Qeverinë për ta zgjidhur këtë problem jetik për 2000 familje, të cilat mbahen nga prodhimi i rrushit. Unë sot flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për arsye se shqetësime të ngjashme ka shprehur edhe dega e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në Rahovec.

Në komunën e Rahovecit janë 3000 hektarë vreshta. Prodhuesit e verës ballafaqohen me probleme të shumta, siç janë problemi me furnizim të ujit, furnizimi jo i rregullt i rrymës, si dhe konkurrenca joreale e falsifikuesve dhe kontrabanduesve të verës. Me të gjitha vështirësitë që po përballen prodhuesit e rrushit sot, e kanë edhe një problem të madh, e ai është se rrushi që do të grumbullohet sivjet, pas vjeljes nuk ka ku të plasohet, pasi që 7 kompanitë prodhuese ekzistuese nuk kanë vend për rrush të ri, se në podrumet e tyre kanë verë nga vitet e kaluara, të cilën nuk kanë mundur ta plasojnë në tregun ndërkombëtar, ankohen për bllokadën e CEFTA-s që po e bëjnë shtetet, siç janë Serbia dhe

Bosnja. Është e qartë, edhe për prodhuesit e verës, edhe për bujqit se në Kosovë vepron ekonomia e tregut, por shtetet me sasi të madhe të verërave gjejnë forma të subvencionimit të kompanive që eksportojnë verë. Subvencionimi shkon gjerë 70 centë për një litër për verën e eksportuar. Te ne Qeveria po do t'i subvencionojë thuprat e hardhisë së rrushit, duke treguar se nuk është në ngjarje apo edhe nuk ka bërë vlerësimin në terren për nevojat ekzistuese të vreshtave që paraqet një kontradiktë të llojit të vet.

Subvencionimi është i nevojshëm për riparimin dhe krijimin e kapaciteteve të reja për bodrumet që të pranojnë sasi të reja të rrushit.

Nën dy, Qeveria të intervenojë në subvencionimin e bujqve për diferencë të çmimit të rrushit, pasi që bodrumet mund ta pranojnë rrushin vetëm me çmim që shitet në shtetet konkurrense, në këtë rast konkret, Maqedonia, e cila e ka marrë tregun e Kroacisë, të Serbisë dhe pjesërisht atë të Shqipërisë.

Nën tre, një masë e jashtëzakonshme që urgjentisht të bëhen bisedimet me Shqipërinë që t'i hapin kufijtë, vetëm Kosova dhe Shqipëria kanë akcizë në verë dhe të mundësohet eksporti i verës kosovare. Nëse asnjëra prej këtyre masave nuk ndërmerren, ekziston rreziku që 3000 hektarë vreshta të shkatërrohen plotësisht, 2000 familje të mbesin pa të ardhura dhe kompanitë që e prodhojnë verën të falimentojnë, e me këtë të humben edhe 1000 vende të punës që ato sigurojnë për punëtorët e vet. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Ngrehim një shqetësim që e kemi nga qytetarët e komunitetit Ashkali, sidomos nga komuna e Ferizajt. Ju informojmë dhe kërkojmë nga ju që të merrni masa sa më të shpejta për zgjidhjen e problemit të rrymës për 240 familje të komunitetit Ashkali në komunën e Ferizajt, ku vazhdimisht bëhen shkyçjet kolektive çdo muaj, jo vetëm në këtë komunë të Ferizajt, po në të gjitha ato vende ku jetojnë komunitetet, e ne kërkojmë, kryetar, e sidomos nga kryeministri që të marrin masa nga kjo ministri, sepse me të vërtetë kjo është bërë disi e padurueshme, bëhen disa eksperimente, mund ta them, te këto komunitete. Shkyçjet kolektive ne nuk i kemi votuar në këtë parlament deri më tani, asnjë ligj nuk e kemi nxjerr që është e drejtë të bëhen shkyçjet kolektive, sidomos në ato vende ku jetojnë komunitetet. Kjo po ndodh edhe në kampin e Plemetit, më shumë nuk kanë rrymë ato familje se sa që kanë rrymë, prandaj jemi edhe në një sezon ku tash familjet e varfra përgatiten për sezonin dimërore, ku ato të gjitha gjëra që i përgatisin për ushqim, ato vetëm kanë filluar t'ju prishën dhe ne mendojmë që shumë shpejt të merrni masa nga këto drejtori, sidomos nga KEK-u që të mos të bëhen reduktimet, mos të bëhen shkyçjet kolektive, sidomos në këto zona ku jetojnë komunitetet.

Vazhdimisht diskutohet për komunitete para ekranit, para televizioneve, kurse të drejtat e këtyre komuniteteve vazhdimisht merren diqysh sikur me dhunë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëendetje për kryeministrin dhe gjithë Kabinetin qeveritar dhe për gjithë deputetët që janë sot prezent në këtë seancë!

Grupi Parlamentar i AKR-së shpreh shqetësimin me një vendim të cilin e merr Qeveria me datën 13.5.2010 dhe i cili nënshkruhet nga vetë kryeministri, ku thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në ndërmarrjen publike Posta dhe Telekom i Kosovës, vendos se ministri për Ekonomi dhe Financa, në rolin e këtij kryesuesi të Komitetit ndërministror për ndërmarrje publike, autorizohet që të urdhërojë të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm i PTK-së dhe ndërmarrjeve të gjitha masave të ligjshme dhe të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimeve në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjore.

Unë do të shkoj në paragrafin 1.2 të këtij vendimi të Qeverisë, ku thotë: “PTK-ja dhe bordi i saj i drejtorëve të sigurojnë që PTK-ja menjëherë të vendos një ngrirje gjithëpërfshirëse të nivelit të pagave dhe të punësimit të punonjësve të rinj, duke marrë parasysh faktin se çështja e punësimit do të rregullohet me marrëveshjen e privatizimit, që PTK-ja të mos vazhdojë përtëritjen e kontratave ekzistuese të punës përtej 31 dhjetor 2010”. Duke marrë parasysh këtë vendim, të cilin e nxjerr Qeveria dhe nënshkruhet nga kryeministri, ky vendim shkelet, edhe Ligji për ndërmarrjet publike shkelet dhe në të njëjtën kohë punësohen njerëz të rinj brenda PTK-së dhe në të njëjtën kohë ngritën pagat brenda PTK-së.

Për këtë arsye, Grupi Parlamentar i AKR-së përkujton kryeministrin dhe ministrin e Ekonomisë dhe Financave që të mos shkelin as mbi Ligjin për ndërmarrjet publike, as mbi vendimet të cilat i miraton vetë në mbledhjen e Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotëri,

Zoti kryetar, kam një propozim për juve, që ju të merrni një nismë qoftë përmes shëfave të grupeve parlamentare, qoftë përmes Kryesisë, të hartoni një rezolutë në mbështetje të rezolutës së OKB-së, të mbështetje së deklaratës që Kuvendi ka bërë për Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, në të cilën do të përmbaheshin dy elemente domosdoshmërisht, njëra është që dialogu, çfarëdo që do të jetë ai, të mos ndodh fare pa praninë edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Dhe, e dyta, për t’iu ikur problemeve se do të ketë dialog të këtij apo të këtij niveli, në atë rezolutë mund të vihet edhe një mendim tjetër, që thuhet se nuk do të ketë bisedime politike. Në qoftë se gjëra të tilla ... për diçka tjetër do të ketë nevojë, atëherë Kuvendi duhet të marrë vendim. E themi këtë për shkak se ne e dimë që Bashkimi Evropian nuk e ka njohur Republikën e shtetit të Kosovës në tërësi, domethënë nuk e kanë njohur të gjithë, kemi arsye të plotë për brengë dhe konsideroj që ne si Kosovë nuk guxojmë të lejojmë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të hiqen qoftë edhe si pranim formal nëpër rezoluta të ndryshme të asambleve të ndryshme kur është në pyetje çështja e Kosovës, madje do të thosha që Brukseli ta ketë drejt këtë çështje dhe ta kuptojë drejt, nuk do të ishte fare e gabueshme në qoftë se në dispozitat kalimtare të Kushtetutës që është bërë, të vihej ndoshta aty që për çështje të ndjeshme që kanë të bëjnë relacionet Serbi – Kosovë, të jenë të pranishme gjithmonë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne nuk guxojmë t’i ofrojmë vetes një luks të tillë, që të hyjmë në çfarëdo dialogu me Serbinë, duke përjashtuar, qoftë edhe formalisht. Nuk mjafton të themi se ata janë, mbështesin, e gjërave tjera. Mendoj se ky është një luks i tepër. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë bashkëndërtues të lirisë së Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi, kujtoj, prandaj do të ishte e pafalshme nga ky Kuvend që ne ndoshta të bënim një gabim të tillë. Rezoluta do të ishte edhe në koherencë me politikat e Kuvendit të Kosovës dhe do të ishte edhe një përqafim pro politikave të

Brukselit, por duke shënuar edhe prezencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ajo rezolutë, ne pajtohemi me Catherine Ashton, po do të ishte 29 vende, 27 të Bashkimit Evropian, Serbia, plus Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Deputetë të nderuar,

Do të flas për dy çështje, nëse mbërrij shpejt e shpejt.

Në fakt, çështja e parë ka të bëjë me lirimin e kryeministrit Haradinaj. Po përpiqem parafrazoj një deklaratë të zëdhënësit të Qeverisë se Qeveria është kujdesur për procesin e Ramush Haradinajt. Të them të drejtën, me këtë deklaratë Qeveria veç ka konfirmua atë që është folur herët se sa ka punua edhe sa vërtet është kujdesur për procesin e Haradinajt, ashtu siç është thënë që është kujdesur shumë edhe SHIK-u për procesin e Haradinajt, por esenca dhe puna është që kryeministri Haradinaj duhet të lirohet. Derisa kryeministri, qoftë edhe formalisht e ka përmendur këtë çështje, derisa kryetari i Parlamentit ndoshta pak më seriozisht, presidentit të vendit nuk i ka shpëtuar asnjë fjalë prej gojës dhe është çështje jo veç e vullnetit dhe e dëshirës, por është çështje e obligimit kushtetues që e ka presidenti i vendit. Po të kishte, vetëm pak mësim të kishte marrë nga miqtë, që aq shumë i përmendin kur i kanë punët e tyre personale, do ta kishin të qartë që SHBA-ja dhe të gjitha vendet, presidenti i vendit do të reagoonte qoftë edhe për qytetarin më të rëndomtë, ndërsa është fjala për një lider, për një hero të luftës dhe të pages, por presidenti nuk ka kohë për ta ushtruar funksionin e vetë, si edhe në raste të tjera, sepse ka për ta ushtruar funksionin e kryetarit të partisë.

Dhe, së dyti, çështja e bisedimeve aq shumë të përfolura dhe një kaos deklarimesh, të cilat në kohë të fundit jepen nga zyrtarët më të lartë të vendit. Është e pa imagjinueshme çfarë kaosi deklarimesh japin përfaqësuesit e institucioneve më të larta të vendit, në veçanti pas Rezolutës Asamblesë së Përgjithshme, e cila decidivisht kërkon bisedime dhe ajo çka ka fituar Kosova nga kjo rezolutë dhe që dihet, janë bisedimet, tjerat ndoshta mbetet të shohim në të ardhmen. Ajo që dua të potencoj, është që është e domosdoshme agjenda, kurdo që do të mbahen këto bisedime. Unë jam shumë dakord me krejt ata që thonë se nuk është mirë për t'u nxituar, nuk kemi ndonjë arsye të veçantë për t'u nxituar në këto bisedime, por një ditë do të mbahen ato dhe kurdo që do të mbahen, është e domosdoshme agjenda në këtë Parlament të Kosovës. Nga agjenda ne do të shohim se a do të jenë bisedimet teknike apo politike. Është e pa imagjinueshme ...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kryeministër, ministra!

Unë edhe një herë do ta ngrejë çështjen e Universitetit të Prizrenit meqë e kemi edhe ministrin edhe kryeministrin këtu, të dytë kanë deklaruar publikisht që në Universitetin e Prizrenit do të jetë edhe Fakulteti i Edukimit, ndërsa në konkursin e hapur tashmë është hapur konkursi për boshnjakë edhe për turq, ndërsa për shqiptarët nuk është hapur në këtë universitet për Fakultetin e Edukimit. Unë veç një pyetje kisha për t'ia shtruar kryeministrit, që mjaft shumë ka qenë në Prizren dhe ka punuar për Prizrenin, a janë edhe shqiptarët e Prizrenit qytetarë të Kosovës, a kanë të drejtë edhe atë në edukim? Të lutem, kryeministër, pse është ky diskriminim të shqiptarët në Prizren për një fakultet të edukimit? 100 studentë të inkorporuar në Universitetin e Prizrenit, nuk do të thotë asgjë, do të thotë, një vlerë nuk do të thotë diskriminim, as humbje. Pse konsiderohet humbje mos angazhimi, mos hapja, mos zhvillimi i këtij fakulteti atje?

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Po ta përkujtoj, janë deklarimet e lira, jo pyetjet parlamentare.

Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të ngrejë një çështje për qëllimin më të mirë, që edhe ministri i Rendit, po edhe ai i Drejtësisë të më dëgjojnë, sepse në pyetje parlamentare konsideroj që nuk po arrihet mjaftueshëm të kontribuojnë deputetët në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe ngritjes apo eliminimit të dukurive që janë shqetësuese për qytetarët. Fjalën e kam për aspektin e sigurisë, të jetës, të pronës private të qytetarëve të Kosovës. E dini që kohëve të fundit kanë fillua të rriten rastet kur bandat hajdute kriminale i sulmojnë pronat private, shtëpitë e qytetarëve dhe si pasojë vdesin njerëz në pronën e vetë. Rastet e fundit ishte ai në Fushë Kosovë, por edhe dje në Pejë, kur vriten qytetarët pafajshëm duke tentuar të mbrojnë pronën e vet. Konsideroj që Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Policia e Kosovës duhet të jetë më efikase sa i përket patrullimit edhe natën dhe të jetë më efikase në reagimet e shpejta kur kërkohet nga qytetarët, sepse unë i di disa raste kur reagimet kanë qenë shumë të vonuara. Ndoshta janë si rezultat i ngarkesave në trafik, por gjatë orarit të natës konsideroj që ka mundësi të reagohej më shpejt. Kjo është një masë, nën një.

Nën dy, konsideroj që Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta adaptojë legjislacionin sa i përket armë mbajtjeve me leje, për atë që në popull njihet si armë e shtëpisë dhe duhet ta ketë parasysh këtë se ka praktika edhe në vendet tjera demokratike që këto lejohen.

Ndërsa, nën tre, për Ministrinë e Drejtësisë që ta adaptojë Kodin Penal të Kosovës me qëllim që të jetë në mbrojtje familjes, të jetëve të njerëzve aty kur i ekspozohen rrezikut të caktuar nga banda të ndryshme kriminale që kanë motive të ulëta dhe t'i mbrojnë Kodi Penal i Kosovës këta njerëz, edhe në rast se bëjnë veprime në mbrojtje të familjes së vet. Konsideroj që këto masa do ta parandalonin rritjen e këtyre rasteve, që për pasojë janë humbje jete të njerëzve të pafajshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Deputetë të respektuar,

Normat interesante bankare, posaçërisht të organizatave mikrofinanciare janë tepër të larta. Ndokush do të thoshte - ekonomia e tregut. Shtetet moderne ndërmarrin masa efikase, instrumente, mekanizma dhe nuk lejojnë norma interesante rjepëse. Këto janë destimulative për ekonominë, veçanërisht për bizneset e vogla e të mesme. Prodhimet vendore nuk mbrohen dot, përderisa prodhimet e jashtme, madje edhe ato të importuara kontrabandisht, në vend të luftimit, privilegjojnë në dhe nga tregu i zi. Së andejmi, ndër të tjera në Rahovec, ndër tjera, në vendin simbolik të prodhimit të rrushrave cilësorë, sivjet dita festive është shënuar ditë protestive. Dihet, edhe kolegja e mëparshme e potencoi këtë.

Numër tejet i madh i operatorëve ekonomikë të palicencuar, pra ilegalë, megjithatë kryejnë punë publike. Shënimet janë – 105, po ato mund të jenë 106 apo 95 për shkak se s'i kemi të dhënat e sakta. Nuk përfillen dispozitat ligjore pozitive, veçanërisht gjatë ekzekutimit të akteve juridike përfundimtare në administratën publike, po ashtu edhe në gjyqësorin.

Lokalet e organizatave ekonomike, siç është Marketingu nga Prishtina shembull ekzemplar, mbi 10 vite është shfrytëzuar nga qiramarrësi arbitrar, i quajtur qiramarrësi, sepse s'ka paguar kurrfarë rente, kurrfarë qiraje, më në fund e ka lënë, tanimë autoritetet publike e bllokojnë nga pronarët të cilat i kanë krejt instrumentet juridike se e kanë blerë, se janë pronarë legjitim të padiskutueshëm.

Oda e veçantë e Gjykatës Supreme ,që nuk është e Gjykatës Supreme, quhet për shkak se nuk i përgjigjet Gjykatës Supreme, nuk i vendos çështjet me vite, një.

Dy, kërkon ekskluzivisht që palët, zakonisht nevojtare dhe të varfra, krejt shkresat t'i dorëzojnë vetëm në anglisht, që është në kundërshtim me kushtetutën, me ligjin.

Këto janë disa nga shqetësimet aktuale akute. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinet qeveritar dhe për gjithë ministrat!

Zoti kryetar, tani pas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara, pritet që Kosova të hyjë në bisedime. Mendoj që është mirë që para se të shkohet në bisedime, kjo çështje të shtrohet në Kuvendin e Kosovës se a do të duhej të hyhet në bisedime dhe, nëse po, të bisedohet edhe për agjendën e bisedimeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja e fundit për sot, Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Siç e dini, edhe më tutje vazhdon gjendja e rëndë në shëndetësinë tonë. Nëse kryeministri dhe zyrtarë të tjerë politikë e kanë vizituar Qendrën Klinike Universitare, do të shohin se me çfarë mungesash dhe me çfarë gjendje ballafaqohet kjo klinikë. Kjo klinikë është klinika kryesore në Republikën tonë, nëse e shohim pajisjet mjekësore të cilat janë në QKUK, atëherë me për ato pajise mjekësore nuk kujdeset askush. Nëse vazhdimisht do të vazhdojë që kjo çështje të mos jetë prioritet i Qeverisë, sikurse ka qenë deri më tani, tashmë i kemi 2 vjet e gjysmë të qeverisjes tuaj dhe deri më tani ende nuk kemi pa asnjë lëvizje pozitive.

Zoti kryeministër,

Qe dy vite është proklamuar që Instituti Onkologjik do të hapet në Klinikën Universitare të Prishtinës, por prapë se prapë ky institut nuk është hapur. Sipas disa përlllogaritjeve, rreth 60 milionë euro dalin jashtë vendit tonë, do të thotë në Maqedoni, Serbi dhe vende tjera të rajonit, që do të duhej të mbesin ato para në vendin tonë, në klinikën tonë, sepse ai institut ka marrë jashtëzakonisht para të mëdha që të rinovohet dhe të formohet si institut i tillë. Andaj, nëse e shohim krejt buxhetin total të Ministrisë së Shëndetësisë, është krejt buxheti 71 milionë, nëse i shohim të dalat nga trajtimet jashtë vendit, rreth 60 milionë, çka do të thotë se afërsisht sa i gjithë buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dalin jashtë vendit tonë.

Një shqetësim tjetër është edhe mungesa e Ligjit për sigurime shëndetësore. Siç e dini, zoti kryeministër, në vendin tonë kafshët i kemi të siguruara, ndërsa njerëzit ende nuk janë të siguar. Sot në vendin tonë ballafaqohemi me mungesa të barërave esenciale. Shtetet e rajonit, Serbia, Maqedonia,

Slllovenia përmes bizneseve private po hapin sigurime shëndetësore private, në të cilat ne po i derdhim paratë në ato sigurime private dhe po të njëjtat para po dalin prapë në vendin tjetër.

Andaj, kërkoj nga ju që të merrni masa dhe kjo çështje të jetë prioritet i Qeverisë tuaj, ashtu siç jeni deklaruar para fitimit të mandatit tuaj, do të thotë, në fushatën elektorale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Disa çështje që u ngritën, sidomos nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ju e dini se si bëhen kërkesat për t'u shtruar çështjet për debat. Kanë të drejtë grupet parlamentare dhe së paku edhe 6 deputetë ta bëjnë një kërkesë me nënshkrime dhe të shtrohet në rend të ditës. Respektojeni të drejtën e juaj sipas Rregullores së Punës së Kuvendit.

Për deklaram të lirë, është edhe kryeministri i Qeverisë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit të Kosovës, zoti Krasniqi,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, më lejoni që në emër të Qeverisë së Kosovës t'ju uroj suksese në fillimin e sesionit vjeshtor të punimit të Parlamentit të Kosovës.

Më lejoni fillimisht që t'ju informoj për zhvillimet e fundit në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara javën e kaluar.

Pjesëmarrja e delegacionit të Kosovës, pjesëmarrja e delegacionit të lartë shtetëror të Kosovës për herë të parë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ishte legjitime, legale dhe shumë e dinjitetshme.

Kjo ndodhi për herë të parë për Kosovën, kjo është histori e re dhe relacion i ri dhe fuqiplotë i shtetit të Kosovës në raport me Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Qeveria e Kosovës e ka mirëpritur një rezolutë të tillë që respekton vullnetin e qytetarëve të vendit tonë dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili ka konfirmuar shumë qartë se pavarësia e Kosovës është në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës ka qenë e bindur për një rezultat të tillë, ngase ne kishim në anën tonë të drejtën, kishim në krah tonë botën demokratike, ngase synimet tona përkojnë paqen, stabilitetin në vend, rajon, por edhe në botë.

Serbia, të nderuar deputetë, bëri mirë që tërhoqi rezolutën e propozuar nga ajo vetë dhe, me këtë, jo vetëm që ka pranuar rezultatin e ditur humbës të saj, pra dështimin që në fillim, por ka përmirësuar gabimin e saj që kishte bërë si propozim, rezolutën në Asamblenë e Përgjithshme.

Dhe, të nderuar deputetë,

Më lejoni sot në emër të Qeverisë të falënderoj botën demokratike, në veçanti Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mesazhet pozitive që kanë dërguar për Beogradin. Po ashtu, ky është hap i parë i ndryshimit të kursit të politikës së Serbisë për Kosovën dhe rajonin.

Dua të besoj se krizat të cilat i ka shkaktuar Serbia në rajon për dekada me radhë me politikën e konfrontimit, të dunës deri në përmasa të gjenocidit, tash të transformohen dhe të zëvendësohen në bashkëpunim të nivelit ndërshtetëror edhe me Republikën e Kosovës, në interes të të dy vendeve dhe popujve tanë.

Duke pranuar një rezolutë që njeh dhe respekton vullnetin tonë dhe vendimin e GJND-së, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe secili shtet veç e veç ka dhënë një kontribut të veçantë për paqen, stabilitetin dhe politikën e bashkëpunimit në rajon dhe më gjerë. Duke pranuar rezolutën që e njeh mendimin e GJND-së për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, 192 shtete kanë njohur vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, kanë njohur sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit më të ri në botë, të shtetit të Kosovës.

Për këtë sukses të ri të shtetit të Kosovës duhet të ndihet krenar secili qytetar i Kosovës, sepse fitorja e radhës së Kosovës në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së ishte meritore dhe shumë e dinjitetshme.

Të nderuar deputetë,

Republika e Kosovës do të veprojë me përgjegjësi dhe konstruktivitet, mençuri dhe respekt për botën demokratike që po na përkrahë që të jemi gjithnjë faktor edhe më pozitiv në rajon dhe në botë.

Kjo rezolutë ka legjitimuar politikisht mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Me këtë rezolutë Organizata e Kombeve të Bashkuara ka lëvizur pozitivisht në qëndrimin e saj në raport me Kosovën dhe u ka hapur rrugë edhe vendimeve tjera që e njohin vullnetin tonë si shtet sovran dhe të pavarur.

Rezoluta fuqizon shtetin tonë dhe garanton tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës. Rezoluta hap perspektivë për njohje të reja, për konsolidim dhe fuqizim të shtetit tonë, por edhe për anëtarësim të Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë.

Duke njohur mendimin e GJND-së, rezoluta ka përcaktuar vija të gjëra të bashkëpunimit në mes nesh dhe shteteve tjera, përfshirë edhe Serbinë.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës nga përfaqësuesit e popullit, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, njohjet nga shumë shtete të fuqishme të botës, mendimi i GJND-së dhe kjo rezolutë e OKB-së të Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së janë takuar në pikën e fuqizimit të së drejtës tonë për shtet të pavarur dhe sovranitet të plotë.

Edhe kjo rezolutë përcakton se çdo bashkëpunim me Serbinë është bashkëpunim mes dy shteteve sovraane, të pavarura dhe të barabarta, që do të mund të ndërtojnë raporte ndërfqinjësore, ndërshtetërore në dobi të vendeve dhe të popujve tanë dhe paqes në përgjithësi në rajon.

Ne do të punojmë si institucione, përfshirë edhe mekanizmat ndërkombëtarë, për zbatimin e plotë të Kushtetutës sonë, për implementimin e plotë të pakos së presidentit Ahtisari dhe të ligjeve tona, si zgjidhje për çdo çështje në vendin tonë.

Republika e Kosovës do të vazhdojë të jetë partner serioz dhe shumë i përgjegjshëm me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për realizimin e synimeve tona për t'u integruar sa më parë edhe në NATO, edhe në Bashkimin Evropian, por edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Prandaj, edhe sot Qeveria e Kosovës i fton shtetet e botës që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, që ta bëjë një gjë të tillë, me çka do të kontribuonin për paqen, stabilitetin, respektimin e

vullnetit demokratik dhe respektimin e drejtësisë ndërkombëtare të shprehur përmes opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare.

Para jush, të nderuar deputetë, shprehim garantimin për qytetarët tanë se për të ardhmen e shtetit tonë nuk ka dilema, e ardhmja është e sigurt, por vetëm përkushtim të plotë do të ketë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë dhe zhvillimin përkrah vendeve dhe kombeve të lira.

Edhe një herë, dëshiroj të falënderoj me konsideratën më të lartë botën demokratike për mbështetjen që po i jep shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i dhënë më 22 korrik, ishte fitore e drejtësisë botërore që përkoi me drejtësinë tonë për të qenë shtet i pavarur dhe sovran, ndërsa miratimi i rezolutës nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara është fitore dhe legjitimim politik në organin më të lartë botor. Sot lirisht mund të themi se bota, respektivisht institucionet më të larta botërore kanë legalizuar dhe legjitimuar aspektin juridik dhe politik të shtetit tonë sovran dhe të pavarur të Kosovës. Këto janë suksese me peshë historike për shtetin tonë, por edhe me përgjegjësi për të ardhmen tonë. Pas këtyre fitoreve dhe sukseseve të reja, para nesh qëndron procesi për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimi sa i shpejtë të Kosovës në NATO, Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të nderuar deputetë,

Duke dëgjuar me vëmendje edhe diskutimet e lira tuaja paraprake, dëshiroj të theksoj se për të gjitha angazhimet e mëtutjeshme të institucioneve legjitime të Republikës së Kosovës, Parlamenti i Kosovës do të jetë i informuar, ne do të jemi plotësisht transparent para Parlamentit, para të gjithë qytetarëve dhe, natyrisht, të gjitha marrëveshjet ndërshtetërore do të ratifikohen nga Parlamenti.

Ndërsa, në Prizrenin do të rihapet Fakulteti i Edukimit dhe numri i studentëve do të rritet në Universitetin e Prizrenit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër për informacionin dhe për fjalën!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Po vazhdojmë sipas radhës.

Deputetja Gjylnaze Sylaj, nuk është këtu. Vazhdojmë me pyetjen e dytë, deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula. Deputet, do ta bësh pyetjen? Urdhëro, e ke fjalën, ministria është në udhëtim zyrtar.

NAIM RRUSTEMI: Po e lexoj pyetjen, se edhe herën e kaluar ministria e Energjisë dhe e Minierave nuk ka ardhur, por sido që të jetë desha, sepse ministria në muajin prill ishte luftëtare e denj për vendosjen e “Kosovës B” në pako tenderuese dhe hiq më larg 4 muaj më vonë, i njëjti person pa u ndërrua asnjë konditë, del dhe bëhet luftëtare e fuqishme kundër futjes së “Kosovës B2” në pakon

tenderuese. Desha ta pyes, kur e ka pasur përnjëmend, a e ka pasur në prill, apo në gusht? Në rast se e ka ndryshuar qëndrimin prej prillit e deri në gusht, çka ka ndodhur që e ka ndryshuar qëndrimin, në rast se jo, atëherë duhet të japë përgjigje para këtij Kuvendi se, mos më dëgjoni mua, se asnjëherë nuk e kam me të vërtetë atë që e them.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetja Rita Hajzeraj, s'është. Vazhdojmë. Deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi. Deputet, e ke fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit!

Zoti kryeministër, para disa muajve Qeveria bëri publike shifrën e fitimeve nga investimi i 266.476.994 eurove në letrat në vlerë nëpër bankat perëndimore gjatë vitit 2008, shuma e të cilave ishte 3.168.294 euro. Sa për informim të opinionit, e them se shkalla e inflacionit për vitin 2008 ishte rreth 3.75% në eurozonë, e më e madhe në vende tjera të G7, andaj po them edhe kamatat ishin të ndryshme. Bie fjala, Banka Qendrore e Anglisë mesataren e kishte 4.63%, Banka rezervë e Australisë, pra Banka Qendrore e Australisë e kishte rreth 6.64% e kështu me radhë. Pra, të gjitha jepnin më shumë se 1.18% kamatë. Sipas kësaj llogarie, do të duhej fitimi të ishte rreth deri në 16 milionë euro, e jo 3.168.294 euro. Pyetja është konkrete, a na tregoni saktësisht se në cilat letra në vlerë janë investuar këto para? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, a e doni fjalën, apo Ahmet Shala.

Ministri Shala përgjigjet, zoti deputet, se e ka deleguar te ministri.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti deputet Tali,

Unë e kam përgjigjen të shkruar për këtë, thjeshtë, për hir të korrektësisë edhe për përgatitje për kryeministrin edhe për juve, si deputet, por edhe të gjithë deputetët, çfarë do të doja që herëve tjera, çdo gjë që bëhet në institucionet e pavarura që i përgjigjen këtij Kuvendi, t'i drejtohen atij institucioni.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucion i pavarur i Republikës së Kosovës dhe është agjent fiskal i Qeverisë së Republikës së Kosovës për investimin dhe politikat investuese të parasë publike dhe, si të tillë, çdo komentim, intervenim apo ndërhyrje edhe në nivelin e standardeve ndërkombëtare, mbase edhe për kulturën tonë të respektimit të ndarjes së pushtetit, mund të kuptohet si interferim në pavarësinë e këtij institucioni, andaj do ta japë përgjigjen me shkrim, ndërsa për këtë do t'ju kisha lutur të thirrni institucionin përkatës, që është institucion i juaj, i këtij Kuvendi, që i përgjigjet me ligj, me ligj, të cilin e ke përligjur për t'i dhënë detajet rreth kësaj. Ndërsa, Ministria e Ekonomisë dhe Financave përmes drejtorit të Thesarit ka anëtarin e vet në këtë bord dhe i ka të gjitha informacionet për këtë, të cilat do t'ua japë juve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë? E ke fjalën.

DRITON TALI: Zoti ministër, sinqerisht, bëni diçka në atë ministrinë e juaj, se kjo informatë është dhënë publikisht nga zëvendësi i ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Siç po shihet, ju nuk i keni të qarta kompetencat e juaja. Sa i përket Bankës Qendrore, po ashtu e bëra këtë pyetje, duke pasur parasysh miqësinë tënde shumë të ngushtë me guvernatorin, po edhe të kryeministrit, andaj ia drejtova

kryeministrit. E dini se si ua imponuat disidentëve të partisë suaj dhe partnerit qeveritar që ta votojnë mikun tënd ngushtë. Unë ju lus, shkoni pyeteni mikun e juaj të ngushtë, në Dubravë, dhe njoftohu me situatën, siç është në Dubravë aty, se ku ta dimë, bënë vaki të vyen ndonjë informatë në çfarë kushte janë burgjet e Kosovës, si dihet jetës. Pyete, se tregon ku janë investuar ato para, shoku yt i ngushtë është, e di qysh na ke imponuar, në realitet ua ke imponuar disidentëve të koalicionit qeveritarë për ta votuar mikun tënd shumë të ngushtë, edhe të kryeministrit. Andaj, për hir të korrektësisë dhe të përgjegjësiave tua që i ke si ministër ...

KRYETARI: Ministër, a do të përgjigjesh?

MINISTRI AHMET SHALA: Unë veç desha të them se miqësia e ngushtë nuk e di çfarë definicioni ka. Unë vërtet dua të respektoj çdo institucion dhe person cili udhëheq një institucion publik. Miqësia ime e ngushtë me persona të caktuar është private dhe mund të them që nuk besoj që kam pasur miqësi aq të ngushtë me atë. Cilësimet e juaja janë subjektive, por secili do të përgjigjet për veprat e veta dhe unë për pyetjen që e dhatë, do t'ju kisha lutur, thirrni institucionin përkatës dhe ai është i obliguar për këtë Kuvend, për popullin e Kosovës me ligj, ashtu e keni caktua ju me këtë ligj, nëse e ndërroni ligjin, ndërrojeni, do të jep përgjegjësi ndryshe. Por, një po ju siguroj, Banka Qendrore e Kosovës me ligj është e përcaktuar si institucion i vetëm i cili bën politikat e investimeve të parash publike dhe, si të tillë, ju si Kuvend keni të drejtë ta thirrni në përgjegjësi, në informacion, ndërsa thesari i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të gjitha i bën publike në WEB sajtin e vet dhe secili ka dhe mund të ketë akses në atë BeB sajt dhe në qoftë se kërkohet këtu informacion, çdo herë do t'ua sjell. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Kadaj - Bujupi, s'është.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën.

RIZA SMAKA: Respekte, kryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Zotëri ministër për Ekonomi dhe Financa, Shala, nga raportet e Auditorit të përgjithshëm, i cili funksionon sipas nenit 157 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në radhë të parë referuar ndërmarrjeve publike, rezultojnë shumë parregullsi dhe shumë paligjësi, madje të natyrës dhe të karakterit tepër serioz. Ndër të tjera, i numëroj disa taksativisht, sipas enumeracionit: punësimeve të paligjshme, pagesave të punësuarve pa kontrata, e jo rrallë here me kontrata tepër favorizuese, pagesave jashtë kriterëve të harmonizuara sipas kërkesave themelore për punësim dhe pagesa të kontratave fiktive, të menaxhimit problematik të donacioneve me shifra e me fakte e tjera e tjera, të faturimeve të shërbimeve fiktive, shërbime që nuk kryhen fare, faturohen, të interferimeve të anëtarëve të bordeve në funksionet e menaxherëve dhe anasjelltas, por më tepër të bordeve që e pezullojnë menaxhimin e drejtë, a menaxhimi do të duhej të ishte kryesisht në konformitet aktet ligjore. Ju faleminderit për dëgjim!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar profesor, deputetë Riza Smaka, është një nga temat të cilat do të jenë këtu në shqyrtim, në Parlament, pas sjelljes së Raportit për performancën për ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet publike janë subjekt publik ekonomik, i cili qeveriset në bazë të të gjitha standardeve të OECD-së, që janë të përcaktuar edhe me Ligjin e ndërmarrjeve publike. Performancat e secilit bord konform ligjit, konform planeve të veta strategjike vlerësohen dhe janë vlerësuar nga një komision i pavarur dhe grup ekspertësh, të cilat do t'i paraqiten këtij Kuvendi. Sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike, njësia për monitorim të ndërmarrjeve publike dhe politika zhvillimore, pas dy

vjetësh është e obliguar që në bazë të raportit të performancës të marrë masa konkrete për secilin bord, përkatësisht për secilin menaxhment dhe, si të tillë, janë paraparë dhe janë propozuar masa të cilat duhet t'i aprovojë grupi ndërmintor për ndërmarrjet publike, duke ... Qeveria e Republikës së Kosovës dhe unë jam shumë i sigurt që brenda afatit një mujor, një mujor e gjysmë deri më tani do të njoftoheni edhe ju publikisht për masat që janë marrë, se vërtet në disa nga ndërmarrjet publike janë bërë disa, mbase, sjellje dhe vendime të cilat nuk janë në konform me kodin e sjelljes dhe veprimet strategjike që do të duhej të merreshin dhe ky është një proces, konsideroj strategjikisht ne jemi duke marrë të gjitha hapat që sektori privat të jetë ai i cili do të përzgjedh këto çështje më së miri sipas përvojave më të mira botërore, ndërsa ato ndërmarrje të cilat do të mbesin, sigurisht që do të mbesin ndërmarrje publike, do të përpiqemi të bëjmë përmirësime të nevojshme, por nuk mund të garantoj këtu që do të jetë prefekt çdo gjë. Mund t'ju siguroj se të gjitha masat konform ligjit do të merren për secilin bord dhe secilin menaxhment i cili nuk ka vepruar konform procedurave dhe statutit që e ka në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: ...janë çështje të padiskutueshme, domethënë të pakontestueshme, e do të duhej me të vërtetë që Qeveria njëherë nga seancat e veta t'ua dedikonte këtyre problemeve, se janë tepër serioze. Nuk është qëllimi për qortim, qëllimi është për luftim edhe tejkalim pozitiv, afirmativ të lëshimeve, të negativiteteve të mëdha në sektorin, në këtë rast, të ndërmarrjeve publike. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete, e ke fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër Shala,

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 06/2009, ka krijuar një komision i cili ka bërë licencimin e dy operatorëve, të cilët do të merren me furnizimin, shitjen dhe mirëmbajtjen e arkave fiskale, përkundër asaj që në shprehje të interesit kanë marrë pjesë 10 ofertues. MEF-i ndërkohë ka bërë ndryshimin e udhëzimit administrativ, me të cilin mundësohet që të licencohen edhe operatorë të tjerë për furnizim me këto pajisje. Për momentin, vetëm operatori GEOKOS e bën furnizimin me këto pajisje, ndërsa kompania "Dukagjini" deri tani ka bërë vetëm një shitje dhe montim të arkës fiskale. E gjithë kjo ka ndikuar që në treg të krijohet një situatë monopoliste.

Zoti ministër, pse operatori i dytë "Dukagjini" nuk bën, në të vërtetë, shitjen dhe instalimin e arkave fiskale, mos ekziston ndonjë marrëveshje mes këtyre kompanive?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara zonja deputete Pantina,

Projekti i arkave fiskale është në fazën e implementimit. Deri më datën 13 shtator janë pajisur me mjete, përkatësisht me arka fiskale ose pajisje elektronike fiskale rreth 3000 biznese, përkatësisht janë mbi 4100, e kam të saktë, 4129, të paktën këtu shkuan, sipas raport të ATK-së, arka të cilat janë instaluar në Kosovë.

Dy kompanitë e përzgjedhura janë duke instaluar, nuk është e saktë që kompani në fjalë nuk ka instaluar, nuk e di proporcionin e saktë sa ka, por shënimet më japin këtu që ka instaluar dhe është duke e rritur intensitetin e instalimit.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, konform kompetencave të ligjit dhe urdhëresës administrative, siç e dini, ka formuar një komision të pavarur, duke përfshirë ekspertë të ATK-së, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe ekspertë të pavarur për të licencuar edhe operatorë të tjerë. Sa di unë, deri më 15, sot apo kur është data e fundit, është sot për të bërë parkualifikimin e këtyre. Sa di unë, 4 janë të interesuar dhe pas një jave, pas javës së ardhshme që do të bëjnë paraqitje, prezantimin e këtyre arkave, e të cilat do të licencohen nga Fakulteti i Inxhinierisë, Fakulteti Teknik, i cili fatkeqësisht është i vetmi licencues dhe unë e bëj edhe një ftesë publike, edhe një herë e kam bërë, kemi përsëritur konkursin ose tenderin të pakën 5 ose 7 herë për ndonjë licencues tjetër dhe ftoj publikisht këtu që kushdo që ka ndonjë fakultet, institucion i cili është i profesionalizuar për këtë të konkurrojë, që të mos jetë i vetmi licencues ose certifikues i operatorëve, gjithnjë për të rritur konkurrencën dhe për të ulur, që është ngritur këtu disa herë edhe si shqetësim i juaji, edhe i ynë, për të ulur çmimin e rritur, efikasitetin dhe cilësinë në përgjithësi. Unë jam i sigurt që brenda këtij muaji do të licencohen edhe operatorë të tjerë, të cilët do të plotësojnë kushtet konform Udhëzimit Administrativ 12/2009. Komisioni ka për detyrë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për zgjidhjen e operatorëve për shitjen dhe zbatimin e procedurave të parapara dhe me këtë udhëzim drejtori i Administratës Tatimore përcakton dinamikën, afatin dhe nivelin e përcaktimit, duke respektuar kompetencat e veta si drejtor i një agjencioni të pavarur për mbledhjen e taksave.

Ju siguroj që ky proces do të jetë i hapur derisa të jetë e mundur në kuadër të suazave të madhësisë së tregut. Ne kemi për synim që të përshpejtojmë dhe të thellojmë instalimin e këtyre në nivele të ndryshme. Tani për tani janë të obliguara vetëm...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë? Deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër,
Në bazë të cilit ligj i është dhënë e drejta komisionit të caktuar nga MEF-i për të bërë licencimin e operatorëve?

MINISTRI AHMET SHALA: Ligji 03/L-071 dhe Udhëzimi Administrativ 12/2009. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Vazhdojmë. Deputeti Shkumbin Demaliaj, nuk është këtu. Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputete, e ke fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për të gjithë!
I nderuar zoti ministër,
Ne jemi të shqetësuar që deri më tani asnjë institucion relevantë nuk është marrë aktivisht apo seriozisht me shkaqet dhe pasojat, masat dhe përgjegjësitë e mosarritjes së cilësisë në arsim.

A mendoni, i nderuar zoti ministër, që tregu i punës në Kosovë me këto prodhime kuantitative të lëndëve nuk do të jetë konkurrues dhe po e humb rëndësinë dhe cilësinë e edukimit të mirëfilltë dhe konkurrues te ne? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Shumë të respektuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

T'i them disa fjali që definojnë se çka nënkuptojmë me cilësi dhe si matet.

Së pari, cilësia në shkollat fillore dhe të mesme matet përmes testeve kombëtare. Testi i klasës së pestë është diçka që ndodh çdo vit, i klasës së nëntë, i cili u mundëson të rinjve që të vendosin a shkojnë në gjimnaze të përgjithshme apo në shkolla profesionale dhe testi i maturës shtetërore, i cili është po ashtu instrument shtetërorë, i cili iu mundëson të rinjve të shkojnë në universitete ose në jouniversitete, në shkolla të larta profesionale.

Përveç kësaj, Republika e Kosovës është aktualisht në një reformë fundamentale, e cila ka të bëjë me Kurrikulumin e ri dhe kurrikulumi, rikualifikimi i mësimeve dhe standardet për tekste shkollore janë tri parakushte që ndryshojnë përmbajtjen në mësim. Dhe, kuptohet që të gjitha këto gjëra kanë ndodhur gjatë vitit 2008, 2009 dhe 2010. Ndërsa, kur përmendet cilësia, Republika e Kosovës dallon nga Republika e Shqipërisë, nga Mali i Zi, nga Bosnja, nga Serbia, nga Maqedonia, nga Kroacia, s'jemi të vetmit që kemi Agjencion për akreditim dhe në vitin 2008, 2009 dhe 2010 kemi pasur tri valë të akreditimit. Prandaj, edhe Republika e Kosovës merret si shembull në rajon për procesin e akreditimit, të cilat vende të tjera realisht tregun s'e kanë të rregulluar meqë në këto institucione çdo shtator, tetor ka universitete të reja, ku çdo shtëpi dykatëshe, trekatëshe në vendet e rajonit mund të shndërrohet në universitet. Prandaj, mendoj që në fushën e cilësisë ka pasur lëvizje pozitive, po edhe unë si ministër ndaj mendimin që duhet të përmirësohet edhe më shumë cilësia, e cila gjë nuk mund të arrihet me një fazë, por mund të arrihet në proces, meqë vetëm procesi si kornizë afatshkurtër, afatmesme mund ta përmirësojë cilësinë në shkollat tona fillore, shkollat e mesme dhe në arsimin e lartë. Nëse dëshiron ndonjë çështje më specifike, unë jam në dispozicionin e juaj që të marrë qëndrim goftë për nivelin fillor, nivelin e mesëm apo nivelin e lartë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën deputetes Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Vetëm shkurt, zoti kryetar.

Sa u përket çështjeve që i ndërlidhi ministri, domethënë ne jemi të njoftuar për të gjitha këto çështje. Mirëpo, unë e ceka çështjen e tregut të punës. Në qoftë se nisemi, po e marrë si shembull testin përfundimtar apo shtetëror të maturës, zoti ministër, kisha dashur të na njoftosh sa ka qenë i suksesshëm, duke u nisur nga fakti se nëse i marrin si shembull gjimnazet në Kosovë, ju e dini, zoti ministër, se aty në testin kombëtar ka shumë lëshime. Këto janë thënë nga vetë nxënësit dhe profesorët e shkollave ku, për shembull, në qoftë se i marrim drejtimet shkencore dhe të përgjithshme, nxënësit automatikisht aty janë të dëmtuar, sepse në qoftë se i marrim lëndët profesionale, lëndën e matematikës, për shembull, po e marrim, drejtimet shkencore kanë 8 orë, ndërsa drejtimet e përgjithshme 2 orë, ndërsa pyetjet në tekstin e maturës i kanë të njëjta, zoti ministër. Kjo është një nga çështjet të cilat mendoj është mirë të na i cekni tani apo me ekspertët tuaj që i posedoni tani, si ministri. Mendoj që në të ardhmen, në dobi të fëmijëve të atyre 11.500 fëmijëve apo nxënësve, të cilët nuk e kryejnë maturën me sukses, kishte për t'ju ndihmuar në të ardhmen në mënyrë që ata vërtet të vijojnë mësimet në universitetet më të mira të mundshme që i kemi në Kosovë, por edhe ato që i cekët të akredituara. Se si janë akredituar, na keni njoftuar. Shumë ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, përgjigje shtesë?

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit shumë që e ngritët çështjen e maturës. Matura nuk është vetëm vlerësim i jashtëm dhe matje e pjekurisë së nxënësve por është edhe përfillizim në karrierë. Me qëllim që ne të shohim kërkesat e tregut të punës, kemi bërë një studim me Bankën Botërore, i cili është 280 faqe tekst gjatë komplet vitit 2008 dhe 2009 dhe ju nëse keni dëshirë, mund t'ju dërgojmë këtë studim, i cili analizon tregun dhe analizon mënyrën e organizimit të provimit të maturës, mënyrën e hartimit të pyetjeve, teksti i matematikës është përmirësuar dukshëm për drejtimet që kanë më shumë matematikë dhe për drejtime që kanë më pakë matematikë. Prandaj, realisht gjatë vitit 2010 ka pasur përmirësim të tekstit të maturës për shkak të një studimi të detajshëm që e kemi pasur nga Banka Botërore.

Kur është fjala tek tregu i punës, më lejoni vetëm t'ju them që është në lirinë akademike dhe është punë e senateve të universiteteve që të vendosin se çfarë programe të studimit duhet të kenë. Por, procesi i akreditimit në vitin 2008, 2009 dhe 2010 përbën një analizë prej 3000 faqesh tekst, në të cilin janë kyçur 260 ekspertë eminentë ndërkombëtarë për secilën program veç e veç. Mund të ketë programe të studimit të cilat në titull janë të njëjta, por nuk janë të ngjashme meqë ofrojnë kualifikime të tjera dhe sillabuset dhe programet mësimore që ofrojnë këtë universitete nuk janë të barabarta. Mund të ketë dikush ndonjë program të ekonomiksit apo të financave, po jo patjetër ofrohet kualifikimi i njëjtë dhe jo pa tjetër çdo profesor është i obliguar ta afrojë përmbajtjen e njëjtë mësimore ose çdo fakultet ta afrojë përmbajtjen e njëjtë mësimore.

Procesi i akreditimit ndër të tjerash analizon atë çka thirret probono-publico, të mirën publike dhe të mirat publike i referohen analizës së tregut të punës ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Radhën e ka deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin ose ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit!

Zoti ministër, siç dihet, në vitin 2009 filloi fushata Kosovo dhe Young Europeans, tenderin e fitoi, siç dihet po ashtu, BBR Saatchi & Saatchi në nëntor pra të vitit 2008, shuma ishte 5.7 milionë euro, përkundër asaj se pati edhe tenderues për disa milionë më lirë. Pyetja është: Qeveria a ka krijuar ndonjë trup për ta monitoruar fushatën, a jeni duke monitoruar fushatën, si po ecin punët në këtë fushatë, sa herë sivjet është reklamuar Kosova në rrjetet televizive më të shikuara, si CNN, BBC, CNBC e të tjerë dhe cili ishte impakti, në realitet. Sa për t'ua rikujtuar juve, zoti ministër, por edhe qytetarëve të Kosovës, ju në këtë Kuvend më 18 dhjetor 2009 patët deklaruar, e keni në transkript, në faqe 5 dhe 6, kështu: Patët thënë se CNN i keni pas reklamuar 65 spote për vetëm 10 ditë, 26 tetor, 4 nëntor BBC Europë, 56 spote brenda 21 ditëve, EURO NEWS 82 spote, mos t'i lexoj të gjitha, ka shumë, dhe të gjithë në pik kohë, pra në orën 20:00 në mbrëmje deri në orë 22:00. Pyetja është: A keni vazhduar me të njëjtin temp, zoti ministër, prej janarit të sivjetmë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar deputet Tali,

Fushata për promovimin e Kosovës nuk është vetëm një fushatë reklamuese, por është një proces dhe gjatë zbatimit të tij nuk përdoret vetëm një media apo formë e komunikimit për të komunikuar me botën dhe shpalosur vlerat dhe të arriturat e Kosovës. Elementi i parë i kësaj fushate është hartimi dhe ka qenë në kuadër të grupit ndërministror. Në pyetjen tuaj se cili është trupi i cili monitoron, është formuar grupi ndërministror me vendim të Qeverisë në të cilin, përveç të tjerash, marrin pjesë edhe

Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Kulturës në nivel qendror dhe nivel ekspertësh, i cili ka pasur për qëllim hartimin e strategjisë së komunikimit, e cila do t'i shërbejë vendit në vitet e ardhshme dhe do t'iu përgjigjet me sukses sfidave të ndryshme me të cilat ballafaqohet vendi, qofshin ato përmirësimi i imazhit, njohjet ndërkombëtare, pranimi në organizatën ndërkombëtare, liberalizimi i vizave, zhvillimi ekonomik e të tjera.

Varësisht prej prioriteteve që i kemi pasur qysh nga viti 2009, grupi ndërmintor dhe dhënë propozimet se ku të fokusohen, në cilat media dhe cilat tema. Promovimi si fushatë, në fillim të procesit kemi konstatuar që Kosova ka nevojë për një fushatë për të bërë brendin e vet, për të përmirësuar imazhin e saj dhe për të konfirmuar se Kosova është pjesë e Evropës, pjesë si një shtet i barabartë, si një shoqëri e qytetëruar e Unionit Evropian.

Mirënjohja më domethënëse për këtë proces iu dha Kosovës javën e kaluar nga Young Europeans, në konkurrencën ndërkombëtare ku ishin .. 5 shtete, përkatësisht 5 brendinga dhe Kosova mori vendin e parë, që konsideroj se është një arritur e Kosovës dhe e gjithë juve.

Përveç kësaj, në hulumtimet e bëra janë dëshmuar edhe efektet e saj. Për t'ju dhënë më shumë detaje, më lejoni që t'ju tregoj se në fillim të kampanjës janë intervistuar rreth 900 qytetarë të moshës 18 deri 65 në Britani të Madhe, në Belgjikë, në Holandë, në Spanjë, në Gjermani, në Austri dhe në vende të tjera, ky studim është bërë nga AMR Research në Londër dhe kanë konstatuar se qëndrimet e të intervistuarve ndaj Kosovës, pasi që kanë parë reklamat, përkatësisht brendingun, kanë pësuar një ndryshim pozitiv dhe ka ndikuar që vendi të shihet si një shtet me popullatë të re, një shtet pozitiv dhe me një mentalitet evropian.

Për sa iu përket specifikave të reklamimit, për të cilat ju keni pyetur, ju informoj se janë prodhuar reklama të ndryshme, prej të cilave janë përzgjedhur sipas vlerësimeve të Komisionit dhe janë emituar në CNN, EURO NEWS, BLOOMBERG, CNBC...

KRYETARI: Regjia, edhe një minutë ia zgjatë fjalën ministrit!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit! Po përqendrohem vetëm në pjesën e fundit. Sa i përket vitit 2010, janë reklamuar 55 spote, në CNN janë 127 spote, në EURO NEWS janë tash 55, në CNN 127, në Al Jazeera 33 dhe në CNBC 12 spote. E kam përgjigjen më të detajizuar, por kampanja televizive po përdoret edhe për të përforcuar lidhjet e Kosovës me vendet e ndryshme të fokusuar për njohje, siç janë shtetet arabe, në qendrat vendimarrjes, siç është në Londër, Bruksel, Uashington e të tjera dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen, besoj, në qoftë se natyrisht mbështetemi me buxhet shtesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetur shtesë? Regjia, fjalën deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti ministër, unë po habitem, për vjet po na premtun. Vjet ke premtua se të gjitha informatat do të na i japësh, kurrë s'mi ke dhanë. E ke në transkript, lexoje veten në faqe 5 dhe 6. Këtu i kam të gjitha informatat që i kam marr prej BBC, CNN, e tjera e tjera. Sipas asaj që ke deklarua në nëntor, del se 6.400.000 euro janë investua vetëm në spote. A mos Saatchi & Saatchi po i ndihmon Kosovës për ato të bëra që i kemi bërë për Izraelin apo Hebrejntë gjatë Luftës së Dytë Botërore si kompensim që s'po na njeh dhe a mos ndoshta edhe këto 9 milionë që po do t'i japësh për së dyti është kompensim i fushatës. 6.400.000 euro po dalin sipas informatave që i ke dhënë, tash edhe kur t'i hyjë hesapi edhe kësaj që e thatë, do të dalë 10 milionë, ata i kanë marrë 5.7 milionë. Cila është ajo fjala

adekuate, mos ta përdori se zoti Jakup Krasniqi po tutna mos po më qet prej seancës. Po ta lë ty, cila është ajo fjala kryesore kur dikush s'e tregon të vërtetën, thuaje ti me atë gjentëllmenllëkun tënd.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.
Ke kujdes fjalorin parlamentar!

MINISTRI AHMET SHALA: Secili le ta zgjedh mënyrën e komunikimit të vetë sepse, tek e fundit, shpreh dhe karakterin e vet.

Unë gjithsesi dua t'ju konfirmoj se sa më kujtohet, ose sivjet në pranverë ose në një pyetje të caktuar, kabineti im ju ka ofruar të dhëna dhe, ju lutem, urdhëroni kur të duash prapë sot, Kabineti im do t'ju ofrojë të gjitha të dhënat për këtë, sepse është një grup teknik i cili udhëheq këtë. Çfarë dua t'ju them, është që kjo kampanjë nuk është vetëm e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, kjo është e Kosovës dhe unë jam krenar që kemi arritur që në nivelin botëror Kosova të rangohet në vendin e parë në garë tepër të rreptë për brendingun dhe shpalosjen e vlerës së vet. Të gjitha shifrat, informacionet teknike janë në dispozicion të kujtdo qoftë, jo vetëm të juaj. Le të vjen dush të dojë, auditori është ai përgjegjës, për të cilën ju, konsideroj, nuk do të duhej ta merrnit rolin, edhe pse është e drejtë e jotja, i cili do të monitorojë çdo shpenzim paraje dhe, si të tillë, unë jam absolutisht në rregull. Faleminderit, shumë!

(Driton Tali, reagime)

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Rita Hajzeraj - Beqaj, do ta marrësh fjalën, Rita? Regjia, fjalën deputetes Rita Hajzeraj - Beqaj.

RITA HAJZERAJ: Po e pres Dritonin, Driton a mundem?

Faleminderit, zoti kryetar!

Sot është Dita e Demokracisë, Dita Ndërkombëtare e Demokracisë edhe po tregohet transparenca e Qeverisë ndaj deputetëve të Parlamentit të Kosovës, do të thotë mungesa e shumicës së ministrave, kryesisht e kryeministrit në seancën e sotme, kur pyetjet parlamentare janë të drejtuara nga Qeveria dhe Qeveria nuk po jep sqarime dhe nuk po tregon as demokraci, as transparençë. Pyetja ime është për herën e dytë që i drejtohet kryeministrit, kryeministri nuk është në sallë, andaj kërkoj që pyetja ime të kalojë në seancën e ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit!

Kur kryeministri ishe në sallë, ju nuk ishit në sallë.

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Lutfi Haziri.

RIZA SMAKA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zotëri ministër Haziri,

Sikundër dihet dhe së pakut nuk mohohet nga qarqet shkencore relevante, këngët epike shqiptare përmbajnë dhe reflektojnë vlera kulturore me rëndësi, vlerë me peshë për trashëgiminë kulturore botërore. Se andejmi, në bazë do të mund të pritej që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratonte projektin për këngët epike shqiptare, të njëjtin në procedurë të caktuar të ndërmerre veprime të nevojshme e të mundshme, pra, për inkorporim dhe promovim në korpusin tematik të trashëgimisë kulturore botërore. Së andejmi, këngët e epikës shqiptare do të mund të renditeshin pa fije të dyshimit në listën e trashëgimisë kulturore botërore, Eposi i kreshnikëve për këngët epike shqiptare do të përfshihej në ruajtje dhe në mbrojtje të UNESCO-s dhe mbi të gjitha Eposi shqiptar i kreshnikëve do

të radhitej në renditjen e vlerave kulturore botërore, atje ku e ka pasur, atje ku e ka dhe medoemos duhet ta ketë vendin.

Zotëri ministër, çfarë janë opinionet e Ministrisë që ju e administroni aktualisht, edhe të tuajat, natyrisht. Faleminderit, për këtë temë!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Kolegë deputetë, ministra,

I nderuar deputet Smaka,

Duke u bazuar në kërkesën tuaj për përgjigje parlamentare konform nenit 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës, kam nderin që t'ju informoj dhe të ofroj të gjitha informacionet e duhura për projektin madhor - Eposi i kreshnikëve për këngët epike shqiptare, si njëri ndër trashëgimitë tona me vlera të veçanta.

Më duhet të njoftoj se projekti - Eposi i kreshnikëve për këngët epike shqiptare që radhiten ndër kryeveprat e trashëgimisë gojore të njerëzimit, është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më datën 14 janar 2010, numër 02/103, kur edhe është formuar Komisioni qeveritar i Republikës së Kosovës për kompletimin e dosjes dhe paraqitjen para UNESCO-s. Këtë komision e drejton njëri ndër ekspertët më të mirë të kësaj fushe, prof. dr. Zymer Neziraj. Madje, në pikën 5 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës është hartuar edhe plani financiar për vitin 2010, plan financiar i cili do të duhej të implementohej përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Bartës i projektit është Ministria e Kulturës. Realizimi i këtij plani është në procedurë dhe aprovim nga buxheti dhe Ministria e Financave tashmë ka konfirmuar në rishikimin buxhetor se kjo mbetet prioritet dhe vlerë e veçantë kombëtare që duhet të realizohet në tërësi. Me aprovimin e këtij buxheti, nga ana e dikastereve përkatës Qeverisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, të cilën e drejtoj, zotohet se do të realizojë sa më parë që të jetë e mundur këtë projekt të rëndësishëm në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Teknologjisë dhe në bashkëpunim me institucionet tona kulturore shkencore. Zaten, këtë vit edhe seminari për gjuhë dhe letërsi, që është mbajtur në Kosovë, ka pasur shtyllën kryesore shkencore për këtë temë.

Atëherë, konstatoj se Qeveria e Kosovës, sa i përket këtij projekti lidhur me eposin e këngëve kreshnike është në krye të listës së trashëgimisë nacionale të Kosovës dhe, si e tillë, për realizimin e këtij projekti për ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin e këtyre vlerave kombëtare dhe ndërkombëtare do të paraqitet për përfshirje, përkatësisht në mbrojtje nga ana e UNESCO-s si dhe do të radhitet në vlerat kulturore botërore. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet Smaka, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: E përshëndes ministrin për përgjigjen, për përkushtimin. Kam dëshirë ta shfrytëzoj këtë oportunitet të tij, të apeloj edhe në kryeministrin, zotëri Thaçin, edhe në ministrin për Ekonomi e Financa që ta mbështesin Ministrinë, në këtë rast, për Kulturë, që këtë projekt me të vërtetë ta bëjnë, me lutje që zotëri ministër, vetëm një fjali nëse do të kishit mund për ta programuar, kur thatë - sa më parë që është e mundur, kjo të zëvendësohet edhe me një farë date, a e di, sepse obligon ajo edhe e ke një ndjenje se na do ta bëjmë atë punë më së voni, se nëse themi kesi sojit, kjo i bien, grekët, helenët kanë thënë përpara - ad Kalendis Graecas, kjo shqip - "kur bën shëlbim rrush". Në këtë rast jo, vetëm se

mundësisht të programohet, jo sa më parë që është mundur, por më së voni, ky projekt është madhor, është shumë me rëndësi. Ju falënderohem!

KRYETARI: Ministër, këqyr se po ia marrim bukën Institutit Albanologjik.

MINISTRI LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Unë ju siguroj se Qeveria, me vendimin e saj në janar të këtij viti ka aprovuar edhe planin buxhetor, buxheti është ruajtur dhe është konsideruar si prioritet dhe interes nacional. E vetmja vështirësi që ka të bëjë me këtë projekt, është anëtarësimi i Kosovës në UNESCO, por Kosova përfaqësohet, tash përfaqësohet në mënyra tjera, në mënyra të ndryshme në këtë organizatë ndërkombëtare, por e rëndësishme është që edhe autoritetet e UNESCO-s e vlerësojnë dhe e pranojnë punën tonë. Sa i përket Komisionit ndërqeveritar, ku janë përfshirë institucionet kulturore dhe institucionet shkencore dhe bartës i këtij projekti është autoriteti kryesor në fushën e trashëgimisë dhe në fushën që po flasim, zoti Zymer Neziri. Natyrisht që është i lidhur shumë për buxhet, buxheti ekziston tashmë dhe do të bartet në vinë buxhetore të Ministrisë së Kulturës dhe do të funksionalizohet puna e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja që ka bërë pyetje dhe është e fundit për sot, është deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti ministër,

Si e konsideroni hapjen e 20, gjegjësisht 30 fakulteteve me programe të njëjta, sidomos të shkencave ekonomike dhe juridike, pa analizë reale në një hapësirë të vogël, siç është vendi ynë, Kosova. A mendoni se do të jetë sfidë dhe mashtrim i madh i rinisë kosovare? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuari zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Mendoj që ndoshta edhe më herët mora qëndrim për një pyetje të tillë, por po synoj që të jem më i qartë.

Çdo program i ri i studimit që ofrohet në çdo tetor në Republikën e Kosovës, para se të ofrohet, një vit paraprak, universiteti apo kolegji apo instituti aplikon në Agjencionin e Kosovës për Akreditimi, i cili Agjencion i Kosovës për Akreditim sipas ligjit është i pavarur dhe nuk është pjesë e Ministrisë. Agjencioni organizon ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët e analizojnë programin për nga numri i profesorëve që angazhohen, thirrjet akademike që i kanë këta profesorë, gradat shkencore që i kanë këta profesorë dhe se sa vetë punësohen nga këto programe akademike në tregun e Kosovës. Kjo është një procedurë e cila ndodhë çdo vit. Asnjë program në Republikën e Kosovës sot nuk mund të ekzistojë për pa e mbështet procesi i akreditimit.

Kuptohet që në fushën e shkencave të ekonomisë, të menaxhmentit, të teknologjisë së informacionit dhe të tjera, kohëve të fundit ka një trend. Por, më lejoni që ndoshta ta shtroj pyetjen në këtë formë: - Për çfarë ekonomie po bisedojmë ne në Kosovë? Nëse ne kemi të bëjmë me ekonomi të shërbimeve, që thirret si Service deist economy, në ekonomi të shërbimeve programet ekonomike, programet e menaxhmentit janë shumë kyçe meqë menaxhimi i resurseve natyrore, resurseve njerëzore dhe hartimi i politikave publike është shumë kyç. Prandaj, dikujt mund t'i duket i tepër, por nuk janë 20 programe

dhe këto programe nuk janë kompetencë direkte Ministrisë së Arsimit, por janë kompetencë direkte e Agjencionit për Akreditim. Ministria e Arsimit vetëm në Universitetin e Prishtinës në një farë forme dhe vetëm në Universitetin e Prizrenit mund të ndikojë përmes bordit. Programet akademike janë çështje e senateve dhe ju mos kërkoni nga Ministria që ta shkel autonominë dhe thotë - ky program duhet apo ai program duhet, kur kjo çështje është punë e procesit të akreditimit i cili saktësisht, saktësisht e analizon tregun e punës. Unë mund t'ju përmend vetëm një shembull. Ne marrim programin e etnologjisë dhe kemi vërejtur që programi i etnologjisë mund të jetë problem në Universitetin e Prishtinës, se ka pak muze në Kosovë, ka pak institucione kulturore, por për ekonomi, për menaxhment, për informatikë Republika e Kosovës ka nevojë edhe më shumë. Ndërsa fjala ime e fundit është kjo - vendet të cilat kanë pasur rritje ekonomike 30 vitet e fundit, janë ato vende që kanë pasur sa më shumë njerëz me grada universitare. Vetëm lexoni vendet kryesore dhe zhvillimin ekonomik dhe referenca e fundit është kualifikimi universitar dhe zhvillimi ekonomik.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, vetëm një koment shtesë e kam. Për shembull, ministrin e dëgjuam përgjigjen e tij dhe si pyetje shtesë them, a mos vallë jeni kah bëni edhe më tutje eksperimente, zoti ministër, sepse nuk kemi kohë që t'ju cekim çështjen e 20 universiteteve të hapura që ... nxënësit apo studentit tonë, domethënë hynë në provime dhe ju merren para të majme domethënë aty, kjo është një çështje shumë, shumë e ndjeshme. Mirëpo, si shembull konkret ju thatë, e cekët edhe Prizrenin, desha ta cek shkurtimisht Universitetin e Prizrenit. Unë mendoj, zoti ministër, se ju si Ministri bashkë me juve, si ministër, po e shkelni ligjin, sepse për të hapur universitete, jemi gjithmonë, kemi qenë dhe do jemi për hapjen e universiteteve, mirëpo unë mendoj se universitetet duhet të hapen përmes Kuvendit të Kosovës. Vetëm Kuvendi është i thirrur, ju lutem, dhe gjithmonë do të jemi për hapjen e universiteteve. Ju e dini, kam dëshirë të hapen në çdo vend apo në çdo cep të Kosovës, ku rinia dhe studentët tanë e kanë sa më afër shkollimin apo edukimin e tyre. Por ju, i nderuari zoti ministër, së bashku me Ministrinë tuaj po e shkelni ligjin.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Dy çështje: Së pari, dua t'ju informoj dhe po filloj nga Universiteti i Prizrenit. Universiteti i Prizrenit gjatë muajit shtator komplet projekti i Universitetit të Prizrenit sillet në Kuvend të Kosovës. Kuvendi i Kosovës nuk mund ta themelojë një universitet pa akreditim. Prandaj, tek pasi të përfundojë procesi i akreditimit, Kuvendi i Kosovës.... Jo, vetëm..., unë kam përcjell themelimin e disa universiteteve në Evropë, po pasi të kryhet procedura e akreditimit, pasi të jetë rektori, pasi të zgjidhet stafi, pasi të jenë programet e studimit, kur Universiteti i Prizrenit është i prekshëm, kur plani zhvillimor i Universitetit të Prizrenit është i prekshëm, atëherë Kuvendi i Kosovës mund ta themelojë. Nuk mund të themelohet një universitet me një vendim dhe kjo procedurë është në krejt shtetet e bashkimit evropian. Unë mund t'ju sjell, ligji është shumë preciz, ligji thotë që Kuvendi themelon universitet kur universiteti është i prekshëm, kur ka një dosje të detajshme dhe kur është konkret.

Sa u përket universiteteve private, më lejoni veç t'ju informoj. Kur unë e kam marrë Ministrinë e Arsimit, Republika e Kosovës në atë kohë vetëm si Kosovë i ka pasur 34 universitete private, ju e dini këtë punë. Sot Kosova i ka 9 kolegje, i ka 4 shkolla profesionale dhe i ka 4 institute. Më lejoni vetëm t'ju përmendi një krahasim. Shihni sa universitete private ka Maqedonia. 33 i ka vetëm qyteti i

Tiranës. Shihni se sa i ka Bosnja, nëse flasim për proces të akreditimit. Prandaj, unë çka ju lus, është mos kërkon qe ...

KRYETARI: Edhe një minutë, regjia, fjalën ministrit.

MINISTRI ENVER HOXHAI: ...prandaj, unë çka ju lus, zonja deputete, është qe të shihet saktësisht cili është roli i Agjencionit për Akreditim dhe të njihet detajshëm procesi i akreditimit për secilin program veç e veç. Ajo çka mund t'ju them, si deputete e Gjilanit, është se edhe e Gjilanit do ta ketë universitetin e tij. Jemi duke bërë një studim të fizibilitetit dhe besoj qe vitin e ardhshëm së bashku do të jemi në Gjilan qe ta përurojmë Universitetin e Gjilanit.

KRYETARI: Faleminderit, për këto informata, zoti ministër.

Të nderuar deputetë,

Pyetjet e deputetëve qe nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit. Kështu thuhet në nenin 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

3. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të Postë - Telekomit të Kosovës, sipas mocionit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë

Grupi parlamentar i LDD-së ka kërkuar debat parlamentar për procesin e privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetin Lulzim Zeneli qe në emër të Grupit Parlamentar ta marrë fjalën. Atëherë, në emër të grupit fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti kryetar,

Më vjen keq qe po hapim këtë debat për një çështje kaq të rëndësishme dhe nuk e gjen arsyen qe kryeministri i Kosovës të jetë këtu, njëkohësisht edhe shumica e ministrave, por ka edhe mungesë të deputetëve. Megjithatë, Lidhja Demokratike e Dardanisë me shumë shqetësim ngrit këtë çështje sot.

Të nderuar kolegë deputetë,

Procesi i privatizimit në përgjithësi është një proces i rëndësishëm së veçantë për ekonominë e një vendi. Prandaj, ky proces kërkon transparencë, korrektësi, profesionalizëm, e në veçanti legjislacion adekuat qe, në realitet, këto të gjitha i kanë munguar dhe po i mungojnë Kosovës, prandaj ne kemi dështuar në procesin e privatizimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

A mund të themi se ka transparencë, përgjegjësi, legjislacion qe të privatizojmë kompaninë më profitabile dhe strategjike në vend, siç është PTK, e cila ka vlerë mbi 1 miliard euro. Si mendon kjo Qeveri qe këtë pasuri kombëtare ta privatizojë përmes një dokumenti qe quajtur strategji, pa një ligj të veçantë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka kërkuar qe Kuvendi ta ketë një debat, ku do të debatohet shtruar, me argumente, kundër privatizimit të PTK-së në këtë formë jashtë ligjore dhe me kaq urgjencë.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i ofrojë Kuvendit argumente të fuqishme se me privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës Kosova fiton politikisht dhe ekonomikisht më shumë se aktualisht. A janë të mjaftueshme argumentet demagogjike të kësaj Qeverie se mjetet nga privatizimi i PTK-së janë të nevojshme për ndërtimin e auto-rrugës Vërmicë – Merdarë. Demagogjia tjetër është - shtyrja e këtij procesi do të zvogëlojë vlerën e PTK-së dhe që mjetet nga shitja e PTK-së do të mundësojnë zhvillim më të madh në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtyre argumenteve të cilat nuk qëndrojnë fare, Lidhja Demokratike e Dardanisë u përgjigjet shumë qartë dhe shkurt. Siç e dinë të gjithë, sot biznesi më profitabil në botë është në telekomunikacion, andaj kthimi i investimeve të projekteve të PTK-së është 20% minimumi. Ndërsa, ato në rrugë, kthimi i investimeve është 4% maksimumi. Dhe një argument tjetër. Shitja e PTK-së me këtë strategji, pra shitja e njësive të Valës dhe Telekomit, Qeveria e Kosovës për të mbajtur Postën duhet të ndajë minimum 10 milionë euro në vit, pra mjetet e Postës duhet t'i orientojë jo në zhvillim ekonomik, por në rastet sociale të cilat po i krijon vetë kjo Qeveri.

Ne e dimë që Qeveria ka angazhuar kompani konsulente në vlerën mbi 500 mijë euro për përgatitjen e opsionit të privatizimit të PTK-së. Fillimisht, ka angazhuar kompaninë konsulente austriake Telco AG dhe pastaj, pas një periudhe shumë të shkurtër, Qeveria angazhon edhe një kompani tjetër konsulente, që fare nuk dihet qëllimi i saj, pse, por që lë hapësirë për të dyshuar se vlerësimet e të dyja kompanive nuk janë reale. Shtrohet pyetja - pse? Në vitin 2008, Kompania konsulente Roland & Berger ka vlerësuar asetet e PTK-së në vlerë mbi 1 miliard euro. Pse ky vlerësim nuk është publikuar nga Qeveria për popullin e Kosovës dhe punëtorët e PTK-së. Mos vallë dikush planifikon të përfitojë nga pasuria e popullit, duke mbyllur sytë dhe çdo veprim që tenton ta sqarojë ... vetëm mbi këtë gjigant dhe këtë pasuri të shtetit të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Dardanisë në vija të trasha do të prezantojë se çka përfiton aktualisht Kosova nga Postë-Telekomi i Kosovës dhe çka mund të përfitojë.

Aktualisht, PTK është tatim paguesi më i madh në buxhetin e Kosovës. Vetëm për vitin 2009, 2010 Qeveria e Kosovës ka marrë 280 milionë euro nga dividendat e kësaj kompanie. Vetëm për vitin 2009 – 2010 janë investuar dhjetëra miliona euro si donacione për strehim të familjeve, shkollim, shërim, donacione, sport, kulturë e të tjera. Kjo kompani ka të punësuar mbi 3000 punëtorë, për afër 3000 familje në Kosovë përjashtohen nga rastet sociale sepse paga nga kjo kompani është e dinjitetshme në krahasim me standardin në Kosovë. Kjo kompani është e gatshme që të hapë Postë-Bankën, me të cilën automatikisht do të kishte thyer konkurrencën dhe do të kishte kontribuar që të ulen komatat e interesit, aq të larta aktuale, për kredi të cilat do të kishin ndihmuar zhvillimin ekonomik. Pse nuk është lejuar që të hapet Postë-Banka? Qeveria e Kosovës, duke qenë në anën e grupeve të interesit në Qeveri, me bankat komerciale dhe Bankën Qendrore të Kosovës nuk ka lejuar hapjen e Postë-Bankës. Çka humb Kosovë politikisht me privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

A duhet të jetë politikë e këtij vendi që prona kombëtare të tjetërsohet tërësisht dhe qeveritë në të ardhmen të jenë vetëm servis i bizneseve ose vërtet të shndërroheni qiraxhinj në shtëpinë tonë.

Pas krizës globale financiare, shumë shtete të BE-së dhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës po bëjnë analiza dhe kanë dhënë mendime se është paraqitur nevoja që ekonomia të jetë më e kontrolluar në kuptimin se qeveritë duhet të kenë në menaxhim pronën dhe ekonominë e vendit. E krejt kësaj kur

t'ia shtojmë praktikat politike në Ballkan, se ne jemi një shtet i vogël me problemet politike dhe ekonomike, ka shtete të cilat kanë pretendime që duke privatizuar pronën tonë, është më e interesuar të hyjë në Kosovë politikisht për qëllimet politike se sa për biznes. E kur kemi parasysh që kjo kompani është shtyllë strategjike e shtetit, me shitjen e saj do të shitet edhe siguria kombëtare, do të krijojë mundësi që blerësi në rrethana të caktuara të ketë në përgjim të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë - dy shtyllat e sigurisë së shtetit, Policinë e Kosovës dhe Ushtrinë e Kosovës. Por, shtrohet pyetja, cilat janë dëmet të cilat ia ka shkaktuar kjo Qeveria kësaj kompanie?

PTK udhëhiqet nga një bord tërësisht joprofesional. Qeveria e Kosovës ka interferim dhe ka penguar investimet kapitale në projektet kapitale të PTK-së, siç janë: Projektet në Telekom, automatizimin e sporteleve, ndërtimin dhe renovimin e zyrave postare, mos sigurimin e prefiksit kombëtar, mos lejinin e hapjes së Postë-Bankës, mos largimin e operatorëve ilegalë, presionin për të lidhur kontrata në dëm të PTK-së dhe zhvatja e kësaj kompanie, presioni për punësim të tepruar dhe duke shkaktuar debalanc e të tjera.

Qeveria e Republikës së Kosovës, për të gjitha këto dëme që i ka shkaktuar pronës publike duhet të përgjigjet penalisht, duhet të aktivizohet menjëherë Prokuroria e shtetit, aq më pak ka të drejtë kjo Qeveri që të hyjë në privatizim të kësaj prone.

Në bazë të këtyre argumenteve të cilat i paraqita në vija të trasha për shkak të minutazhit, del se kjo kompani nuk duhet të privatizohet, sidomos tash.

Në bazë të këtyre argumenteve, unë për fund pyes Qeverinë e Kosovës, me theks të veçantë, zotin Shala, pasi që edhe kryeministri nuk është i interesuar për pasurinë kombëtare dhe nuk është prezentë.

Zoti shala, ku e ke marrë këtë model, në cilin vend të botës që ta tjetërsosh pronën kombëtare me vlerë mbi një milion euro me strategji, pa ligj përkatës për pronën përkatëse?

Zoti Shala, Qeveria jote është në fund të mandatit, nuk bën të hyni në kontraktme të tilla me kaq urgjencë, pa transparencë, pa legjislacion, ky proces është i paligjshëm dhe i papranueshëm.

Zoti Shala, a keni ju të drejtë dhe kredibilitet, si një Qeveri e skandaleve korruptive, e krimit të organizuar, e pastrimit të parasë, që të tjetërsoni pronën kombëtare krejt jashtë normave ligjore dhe demokratike?

Kolegë deputetë, shumë të nderuar, të koalicionit qeverisës dhe të opozitës, ju lutem, i thërrisni ndërgjegjes dhe përgjegjësisë që keni ndaj vendit, qytetarëve dhe pasurisë kombëtare. Ky Kuvend sot duhet të marrë vendim që ky proces i privatizimit në këtë formë, jashtë normave ligjore dhe aq i dëmshëm për vendin, të ndërpritet menjëherë. Faleminderit, për vëmendje!

Drejtimin e seancës e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Eqrem Kryeziu

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Gaxherri!
Tani e ka fjalën zoti Ahmet Shala, ministër.

AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!
E nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,

Kam nderin që në emër të Grupit ndërmintor për privatizimin e Postë-Telekomunikacionit të Kosovës dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'i paraqes argumentet pse Qeveria e Republikës së Kosoves ka marrë vendim për privatizimin e Postës, përkatësisht privatizimin e pjesshëm të Postë-Telekomunikacionit të Kosovës.

Së pari, më lejoni që mbase disa nga elementet të cilat u ngritën nga zonja e nderuar deputete, sa i përket ligjshmërisë së saj, të cilën e kemi debatuar disa herë dhe sqaruar këtu, por për hir të opinionit të jap argumentet në vijim.

Sipas nenit 160 të Kushtetutës të Kosovës, shteti i Kosovës, përkatësisht Qeveria e tij mund t'i privatizojë ndërmarrjet publike si është përcaktuar me ligj, ndërsa neni 9 i Ligjit të ndërmarrjeve publike përcakton se privatizimi i ndërmarrjeve publike qendrore duhet të realizohet me shitjen e aksioneve dhe i përshkruan hapat të cilët duhet t'i marrë konform këtij ligji. Andaj, do t'ju kisha lutur shumë që një herë e përgjithmonë, për juve deputetë të nderuar dhe për qytetarët e Kosovës, të hiqet nga mëdyshja se ekziston apo nuk ekziston baza ligjore për këtë. Ekziston baza ligjore në Kushtetutë, ekziston baza ligjore në ligjin të cilin e keni aprovuar vetë.

Arsyeshmërinë për privatizimin e Postë-Telekomunikacionit të Kosovës e kemi paraqitur në strategjinë të cilën ju të gjithë e keni marrë dhe është debatuar edhe në grupet ministrore, në komisionin parlamentar. Më vjen keq që komisioni parlamentar nuk ka arritur të sjellë këtu konkluzione të sakta në bazë të kompetencave të cilat i ka dhe të sqarojë para opinionit dhe publikut, konform natyrisht të drejtës së vet dhe kompetencave demokratike. Gjithsesi, unë pres që komisioni parlamentar të sjellë një rekomandim të tillë konform shpjegimeve plotësuese që janë dhënë. Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Transportit dhe Komunikacionit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria për Kthimit dhe Ministria e Tregtisë, të tri këto ministri, në bashkëpunim me sektorët, me këshilltarët e transaksionit, atë strategjik dhe këshilltarin e transaksionit janë përgjigjur në secilën pyetje që është ngritur, të gjitha i keni të kompletuara në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze dhe, sa di unë, edhe në gjuhën serbe, bashkangjitur secilit deputetë. Çdo pyetje që është ngritur këtu, qoftë sa i përket përqindjes, qoftë sa i përket momentit, qoftë sa i përket transparencës, qoftë sa i përket metodologjisë, qoftë sa i përket analizës financiare, juridike, të gjitha përgjigjet i keni të shkruara, të argumentuara në detale dhe janë të përmbledhura në një material shitesë të strategjisë, ndërsa me lejoni sot që të jap disa nga elementet e rëndësishme të cilat janë të nevojshme për Qeverinë, për publikun dhe për juve, e nderuara deputete dhe të tjerët.

Vetëm një e dhënë e vogël e zhvillimit të sektorit që është ngritur këtu edhe nga ekspertë deputetë, me të drejtë, trendi i profatibilitetit të PTK-së, nga 2007, është në rënie, jo për fajin e menaxhmentit, jo për fajin e qeverisjes së keqe apo të mirë, por për fajin e konkurrencës që është e lejuar me të drejtë, me të drejtë dhe më lejoni t'i jap disa të dhëna. Në vitin 2007, ... që është këtu, e hyra para ndaljes së taksave dhe të amortizimit, ka qenë rreth 113 milionë euro, ndërsa në vitin 2009 është rreth 50 milionë euro. Në vitin 2010, do të jetë edhe më e ulët dhe me të gjitha përpjekjet e menaxhmentit dhe me të gjitha përpjekjet e bordit, me aq sa kanë kapacitet, nuk do të mund të shpëtojë rritja e konkurrencës një aset publik. Pajtohem që ka pasur, mbase edhe do të ketë edhe në të ardhmen, ka dhe në çdo vend ku ka ndërhyrje, qofshin ato të presioneve sociale, koceptualizimit të ndërmarrjes publike si vend në të cilin duhet të punësohen njerëzit në mënyrë masive për karakterin social, por mos harroni edhe në qeverisjen koroprative moderne ekziston përgjegjësia sociale. Nuk ka kompani ndërkombëtare serioze që nuk e ka social liability, pra përgjegjësinë publike dhe ajo është e përcaktuar edhe me kontratën që e ka. Megjithatë, ne kemi propozuar që një pjesë e aksioneve të shiten.

Arsyeshmërinë ekonomike e kam thënë edhe në fjalimin tim të parë, mbase është vështirë për të argumentuar pse duhet të mbahen 25% të aksioneve. Kemi marr zërin e arsyes, të momentit psikik, të momentit politik të Kosovës dhe jemi pajtuar që çdo aksion që është mbi 66%, pra mbi kontrollin e paketës, do të ishte në favor të rritjes së çmimit, por jo të ndonjë ndikimi të madh në vendimmarrje. Tek e fundit, investitorët vështirë që do të vijnë në qoftë se nuk e kanë paketën e kontrollit. Nuk do të kemi mundësi të zhvillojmë një sektor në qoftë se nuk e fusim sektorin privat sot në Kosovë, sot sepse në regjion ka mjaft konkurrencë për të futur sa më shpejtë edhe në regjionin edhe në rrethinën më të afërt.

Alternativa zgjedhëse, mund t'i dekurajojë investitorët, mos vendosmëria dhe qartësia jonë mund t'i dekurajojë investitorët. Ne kemi fat që tani për tani kemi të paktën 5-6 investitorë strategjik për të investuar dhe ata, operatorët më të fuqishëm evropian, të cilët janë prezentë në regjion. Nuk do të doja të lëshohem nëpër elemente teknike, sepse të gjitha janë me përgjigje, por edhe obligimet tona edhe ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar edhe ndaj donatorëve për të përmbushur edhe projekte tjera nacionale, qofshin ato zhvillimore, qofshin tjera sociale, të përcaktuara edhe me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, me dinamikë të caktuar, kanë bërë përkushtimi ynë që ne më 2 shtator të kemi në buxhetin e Kosovës ekstra 30 milionë euro nga Komisioni Evropian.

Në qoftë se e respektojmë me përpikëri implementimin e programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, pra në transformimin e sektorit publik, në sektorin privat, thithjen e investimeve dhe përmirësimin e menaxhmentit dhe thithjen e ... nëpër ndërmarrjet publike, qofshin ato energjetike, qofshin Postë-Telekom, qofshin ndërmarrje të tjera, ne ecim drejt plotësimit të programit në Fondin Monetar dhe sigurimit të parave nga donacionet. Edhe paratë e donacionit edhe paratë që do të hyjnë nga Postë- Telekomunikacioni i Kosovës, do të vijnë në qoftë se vërtet ne këtë proces e udhëheqim në mënyrën të cilën e kemi paraqitur edhe para donatorëve ndërkombëtarë edhe para Fondit Monetar Ndërkombëtar. Arsyshmëria teknike për privatizim është dhënë shumë mirë nga ekspertët teknik. Arsyshmëria politike dhe ekonomike është se duhet të transferojmë këtë ndërmarrje publike në ndërmarrje efektive. Është sektori privat ai i cili, nuk kemi koncept, që shteti të udhëheqë një ndërmarrje publike. Tek e fundit ai ka dështuar pothuaj se në të gjitha shtetet edhe në regjion.

Nuk mund të krahasohen, zotërinj të nderuar, nuk mund të krahasohen mollët dhe portokajtë, dakord. Dhe nuk mund të krahasohemi me një mentalitet çfarë ne do të dëshironim të ishim, fatkeqësisht që nuk jemi, por gjithsesi ne duhet të sillemi konform momenteve tona, qofshin zhvillimit ekonomik dhe politik dhe si të tillë Qeveria e Kosovës e ka marrë vendimin, Grupi ndërministror e ka analizuar këtë. Ne, jemi zotuar që këtë proces ta dërgojmë me transparencën më të madhe të mundshme, të gjitha sugjerimet e përsëris dhe dua që edhe për opinionin, të gjitha sugjerimet, kritikën dhe opsionet të cilat shkojnë në favor të rritjes së transparencës, në favor të sigurisë kombëtare se u tha më parë, cenohet edhe siguria kombëtare e vendit.

Më falni, atëherë si nuk po e cenuaka siguria kombëtare në shtetet të cilat mund t'i përmend me radhë këtu se i kanë privatizuar 100% të gjithë telekomunikacionin, hyj: në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; në Gjermani; në Gjermani, në Austri, si nuk e paskan cenuar ata sigurinë kombëtare? Prandaj, konsideroj që nuk është mirë këtu thjesht sa për një politikë populiste për t'u përpjekur për t'i hutuar njerëzit të cilët fatkeqësisht, mbase, qoftë për mungesë të informacioneve apo besimi dhe për të mbrojtur disa interesa të konsoliduar, qofshin të punëtorëve të caktuar, unë e di që në Postë-Telekomunikacion, duke përfshirë edhe vetë parafolësin, nuk ka interes për të zhvendosur rahatinë, nuk ka interes të disa punëtorëve, nuk ka interes edhe, mbase një pjesë e menaxhmentit, mbase edhe të parafolësit për të zhvendosur rahatinë e komoditetin që e kanë një pjesë e caktuar e njerëzve në

PTK, sepse kanë rroga të majme, performancën nuk e kanë në nivelin çfarë paguhet dhe sektori privat do t'ia zhvendosë ato privilegje.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Jepjani edhe një minutë ministrit!

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!...

Dhe, ky është roli, përgjegjësia kushtetuese, qytetare e Qeverisë, por edhe i këtij Parlamenti, nuk është për të ruajtur në interes të konsoliduar dhe mirë të lidhur të disa grupeve, qofshin brenda, qofshin jashtë në menaxhment, në sindikatë, në Qeveri apo diku tjetër, të dy- tre mijë punëtorëve dhe të degradojnë ardhjen e zhvillimit të atij sektori në dëm të qytetarëve të Kosovës. Unë konsideroj që momenti është tani dhe ne duhet të marrim guximin, mos të jemi popullistë dhe të ecim ta zhvillojmë këtë sektor

Në të gjitha parametrat e përcaktuar do të jetë parakusht zhvillimi i këtij sektori. Të gjitha projektet, qoftë për lidhjen e internetit nëpër shkolla, nëpër çdo element të zhvillimit të sektorit, do të jenë në kontratë të hartuara dhe vetëm

në bazë të kësaj neve, do të përzgjedhim fituesin strategjik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Zonja Selmani është paraqitur për replikë dhe do t'ia japim dy minuta.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se gjatë fjalimit, apo prezantimit të ministrit, u akuzua direkt Komisioni, për arsye se nuk i ka marrë vërejtjet të cilat janë bërë në seancë plenare, më vjen keq ministër që duhet ta them këtu prezent në këtë sallë, se së paku tri herë ke qenë në Komision parlamentar dhe në rast se mendon se një strategji për privatizimin e PTK-së, duhet të shkojë në mënyrë ad-hoc, atëherë është shumë i gabueshëm mendimi dhe vendimi yt. Ndërsa, mendimi i të gjithë deputetëve ka qenë që gjithë të përkrahin çështjen e privatizimit të PTK-së, ke qenë prezent aty dhe e dinë dhe ka qenë çështja se çka do të fitojë dhe çka do të humbë Kosova me privatizimin e PTK-së dhe mundësia që në momentin e fundit insiston që strategjia të shkojë pa rekomandime të Komisionit, më vjen shumë keq se prapë do të përballesh edhe me Komisionin Parlamentar dhe do të përballesh me të gjitha vërejtjet e të gjithë deputetëve, të cilat do të dalin në rekomandim nga Komisioni parlamentar. Pa të keqen e qeverisjes së keqe, në të mirën e qytetarëve, prapëseprapë ti do të jesh prezent me gjithë komisionin, të merren rekomandimet për atë strategji të privatizimit. Ju faleminderit, zotëri kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Selmani! Tani në radhë janë deklaratimet e grupeve parlamentare. Po fillojmë me PDK-në. Kush është paraqitur në emër të Grupit?
Zonja Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëendetje zotëri ministër Shala, edhe pse nuk më vjen mirë këtu momentalisht, sa i përket Kabinetit qeveritar, je i vetmuar, sepse për zbatimin e obligimit ligjor, në këtë rast, privatizimin e Postës, ka marrë vendim Komisioni ndërmintor i përbërë prej 5 ministrave të tjerë, të cilët është dashur të jenë këtu dhe të bëjnë, t'ua mbushin mendjen këtyre deputetëve, të cilët janë përcaktuar

vetë përmes miratimit të ligjeve t nxjerra nga ky Kuvend, që Kosova të përcaktohet për ekonomi të lirë të tregut, për privatizimin e pronës shoqërore dhe private e kështu me radhë.

Edhe një herë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, konfirmon se e mbështet procesin e privatizimit si proces, në këtë rast edhe privatizimin e PTK-së.

Kjo interpelancë, jemi shumë të bindur se nuk do të sjellë diçka të re. Me fjalë tjera, kjo temë është harxhuar madje është edhe post festum. Mirëpo, këto janë përpjekjet e fundit të një pjese të opozitës që të hedhin baltë mbi procesin dhe rrugën që e ka zgjedhur Kosova, që në njëfarë mënyre mundohen ta mashtrojnë dike nga elektorati, por do të dalin të humbur. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, jemi të vetëdijshëm, por edhe ju gjithë të tjerët, duhet ta dini se Kosova është në një proces edhe politik edhe ekonomik, në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare dhe miqtë tanë që kemi ardhur deri këtu së bashku me ta.

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, po ua përkujtojmë pse vendimi ynë si Parlament, por edhe si qytetarë të Kosovës për të bërë një shtet demokratik të ekonomisë së tregut të lirë në një shtet të mundësive të barabarta, në një shtet ligjor ua përkujtojmë se edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definon qartë orientimin për ekonomi të lirë të tregut, shihni nenin 160 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Pra, si Kuvend bashkërisht, të nderuar deputetë, jemi përcaktuar për koncept të ri ekonomik, përkatësisht për ekonomi të lirë të tregut, e vlen për ta përsëritur disa herë, për zhvillim të konkurrencës, për futjen e investimeve të huaja, për të gjitha këto e të tjera që do t'ju kursej në kohë e nuk do t'i përmend, më lejoni t'ua përkujtoj se i kemi nxjerrë këto ligje, bashkërisht këtu në Parlament, me shumicën e votave: Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për investime të huaja, Ligjin për konkurrencën, Ligjin për partneritetin publiko-privat dhe koncesione e tjera, e tjera ligje dhe kemi ndërtuar institucione me këto ligje, siç është për shembull: Agjencia për Promovimin e Investimeve të Huaja; Komisionin e Konkurrencës. Kemi ndërtuar edhe ministrinë edhe Qeverinë, të cilat ligje kuptohet se edhe Qeveria edhe këto institucione që u përmendëm, janë të obliguara t'i zbatojnë, kështu që Qeveria është duke e kryer vetëm një obligim të vetin karshi përcaktimit me ligj të objektivave, në këtë rast edhe procesin e privatizimit dhe privatizimin e Postës.

Qeveria e Kosovës, është përcaktuar pra për ekonomi të lirë të tregut, për krijimin e ambientit për zhvillim të kreativitetit përmes sektorit privat, ashtu siç është e përcaktuar edhe bota demokratike. Jemi të vetëdijshëm se Republika e Kosovës, si shtet i ri ka nevojë për investime të huaja, si njëri nga katalizatorët për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Kundërshtarëve të privatizimit ua përkujtojmë se privatizimi i Postës është vetëm njëri nga hapat në vazhdimësi të angazhimit institucional, si nga ana e Parlamentit, përmes nxjerrjes së ligjeve që i përmenda më herët dhe ato që nuk u përmendën, por edhe përmes zbatimit të tyre.

Ne si deputetë, jemi të obliguar që ky proces të jetë plotësisht i lirë dhe transparent, në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për transaksionet e tilla.

Jemi përcaktuar për një rend të ri që kërkon ndryshime rrënjësore në të gjitha fushat, në të gjitha segmentet, duke filluar nga miratimi i ligjeve e deri te zbatimi i tyre. Prandaj, unë nuk do ta zgjas më tepër, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, sepse siç e thashë edhe më herët, është një temë e harxhuar dhe unë do t'i bashkëngjitëm edhe opinionit të ministrit, se vërtet Komisioni parlamentar nuk e ka kryer punën e vet si duhet. Pavarësisht nga ajo është dashur nga seanca e 27 korrikut, del si obligim që Komisioni parlamentar të ulet edhe një herë t'i marrë sugjerimet nga transkripti i asaj seance në lidhje me strategjinë e privatizimit të Postës dhe t'i nxjerrë

rekomandimet, t'i sjellë në Parlament. Pra, unë shpresoj se Komisioni ende ka kohë që t'i nxjerrë ato rekomandime dhe një ditë së shpejti do t'i sjellim në Parlament edhe rekomandimet në lidhje me strategjinë e privatizimit të Postës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani nga Lidhja Demokratike e Kosovës, kush e do fjalën?

Zoti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që edhe debati apo interpelanca sot lidhur me privatizimin e ndërmarrjes publike të PTK-së, po na jap edhe një shans më shumë, po e shfrytëzojmë edhe një mundësi më shumë për t'i përkrahur në parim ato politika të cilat janë me interes pra për zhvillimin ekonomik të vendit, përkundër diverzitetëve ndoshta që i kemi si grupe të interesit. Të njëjtën kohë, unë mendoj se edhe debati sot, duhet të jetë po ashtu kompatibil me debatin që e kemi zhvilluar më herët lidhur me strategjinë që e ka ofruar Qeveria, vlerësimet dhe rekomandimet që ka nxjerrë po ashtu Kuvendi, grupet parlamentare, bazuar pra në debatet e mëhershme, që unë megjithatë duhet të falënderoj ministrin e Ekonomisë, profesor Shalën, që nuk ka munguar asnjëherë në asnjë debat, pavarësisht nëse i kemi ndarë si të themi vlerësimet apo mendimet e njëjta lidhur me variantin, metodën, arsyen ekonomike, dallimet e ndryshme e tjera e tjera. Por, unë mendoj që kjo i kontribuon vetë debatit, i kontribuon për të ardhur deri te rekomandimet, gjegjësisht zgjidhja më e mirë, më e favorshme për momentin aktual që mundemi ne si institucione, si Parlament si Qeveri, të ofrojmë në ditën kur do të na kthehet apo rikthehet edhe një herë strategjia lidhur me modalitetin e privatizimit dhe realisht të japim pra atë mendim politik ky Parlament dhe ato rekomandime që Qeveria, pra të punojë në drejtimin e realizimit të objektivave të cilat janë me interes dhe me benifit për shtetin dhe për qytetarët.

Prandaj, edhe roli ynë si parlamentarë sot është që t'i përmbushim këto detyrime kushtetuese dhe ligjore dhe në të njëjtën kohë, unë mendoj që asnjë parti politike nuk e ka në programin e vet ndryshe platformën politike. Pra edhe LKD-ja si pjesë e këtij Parlamenti e qeverisjes së vendit, në politikat e veta e ka pra forcimin e ekonomisë së tregut. Në të njëjtën kohë, besoj që të gjithë së bashku kemi qenë të interesuar që ndërmarrjet publike të menaxhohen sa më mirë, sado që ka defekte, që 10 vjet na ka përcjellë. Cilado Qeveri që ka qenë, nuk kemi mundur për të ardhur deri te një menaxhim i mirë i ndërmarrjeve publike. Unë po e përsëris si deputet, 10 vjet i kemi përcjellë, nga afër apo nga një distancë, në asnjë kohë, në asnjë moment, me asnjë menaxhment nuk e kemi dëshmuar. Merreni cilëndo kompani, ani pse është PTK-ja profitabile, nuk ka të bëjë ajo me menaxhim të mirë të PTK-së në perspektivë, merreni ndërmarrjen e KEK-ut, e tjera e tjera, tjetër që rrethanat kanë diktuar të kemi një afarizëm pozitiv. Por, kjo nuk garanton që qoftë se na nuk e transformojmë, në qoftë se na nuk bëjmë reformë, në qoftë se na nuk hyjmë në partneritet privat-publik, në qoftë se na nuk e hapim alternativën që të kemi, ashtu qysh tha edhe ministri, pra një qeverisje moderne... në mes të partneritetit, sektorit privat dhe sektorit publik, përfaqësimit... por i gjithë angazhimi ynë, përvoja, eksperiencia edhe mandati parlamentar... duhet të shkojë në atë në cilin ... në cilin modalitet, pra të shumë të do të jenë benifitet më të mëdha. Nëse i arrijmë këto, përndryshe unë mendoj që duhet t'i japim përkrahje procesit të privatizimit dhe partneritetit drejt realizimit, domethënë, garantimit të një perspektive më të mirë. Nuk garanton as menaxhmenti i tashëm, përkundër shkresave, përkundër lëvdatave, përkundër atyre që thonë në perspektivë që do të kemi pra diçka, në qoftë se nuk e marrim një reformë dhe nuk hyjmë pra që realisht të ndihmojmë që nesër të garantohet një menaxhim më i mirë i këtyre ndërmarrjeve edhe i kësaj ndërmarrje për të cilën për të cilin po flasim.

Prandaj, ne kemi pasur rast t'i dëgjojmë këtu edhe qëllimet edhe synimet e Qeverisë lidhur me përparësitë, benifitet, aksionet, asetet, lidhur me përqindjet që ka ofruar dhe këtu, ne nuk jemi pajtuar në një masë të caktuar për të cilën e kemi lënë çelur debatin kur është në pyetje strategjia, dhe mendoj që deri në seancën e radhës apo në seancën kur vjen në rend dite strategjia, është mirë, pra që së bashku me Ministrinë, së bashku me Komisionin, me grupet parlamentare të gjejmë pra atë modalitet i cili do të ishte më i mirë i mundshëm. Ende është pra dilema a duhet t'i shesim 51% të aksioneve, që sektori privat të jetë ai i cili do ta bartë pra, do ta marrë përsipër menaxhimin edhe të ruhen 49% apo kjo përqindje të jetë e ndryshme, por asnjë dilemë na nuk duhet të kemi për atë se a duhet të fillojë procesi i privatizimit. Pastaj duhet ndoshta të kemi arsyen... dinamikën në planin kohor, a duhet pra që gjithçka të përfundojë shpejt e shpejtë apo ndoshta në fazat e caktuara është me interes, në mënyrë që ta testojmë, ta shohim këtë menaxhim modern pasi të futet sektori privat, çfarë efekte do të sjellë në ekonomizimin e kësaj ndërmarrjeje, në rritjen e vlerës apo asetëve të kësaj ndërmarrjeje, të provojmë, pra të shohim dhe unë jam përkrahës i kësaj pra, që megjithatë të kemi pra fazën e parë dhe deri në fazën e dytë, mendoj që me një menaxhim të mirë, në këtë partneritet, mund të arrihet vlera, të shumëfishohet po ashtu dhe të valorizohen asetet e kësaj kompanie, ndoshta që sot i shesim dhe pas tri- katër vjetëve, ato të shumëfishohen dhe pjesa tjetër të ruhet për nevojat e tjera, për nevojat të cilat vlerësohen për të ardhmen se janë me interes për tërë vendin. Prandaj, përkundër asaj që ne kemi marrë shumë shkresa, kemi pasur shumë debate, qoftë nga Sindikata, qoftë nga grupet tjera të interesit, mendoj se ajo ka qenë pjesë e debateve, por duhet pra t'i japim përkrahje procesit të privatizimit, por edhe... atij modaliteti, realisht i cili mbron ato interesa, të cilat realisht duhet t'i përfaqësojë edhe Qeveria në projektin e saj që duhet të ndryshojë edhe ne si Parlament, gjegjësisht t'i japim shans të startojmë në procesin e privatizimit në këtë ndërmarrje, dhe në faza të caktuara, pra të shohim edhe variante të tjera, gjegjësisht t'i shohim efektet të cilat po i sjell ky proces i privatizimit.

Prandaj, si Grup Parlamentar i LKD-së, ne e përkrahim në parim, që të përgatitet një version i cili do t'i ofrohet në strategji dhe do ta debatojmë edhe një herë dhe do të përkrahim, pra atë opsion, atë variant i cili do të ruajë interesat e shtetit, interesat e përfaqësimit tonë, por të njëjtën kohë, pra edhe partneriteti i ri i cili do të mundësojë një menaxhim modern për kohën që i duhet të valorizohen, domethënë, të gjitha efektet ekonomike të kësaj ndërmarrjeje publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Rexhepi!

Në radhë është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zotëri Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se ishte një fjalë tepër interesat që u përmend këtu nga një parafolës, tha: "i gjithë debat është post festum", do të thotë, vendimet janë marrë, krejt është vendosur, proceset janë hapur, domethënë, krejt çka bëjmë ne është e kotë. Gjithçka që ndodh në Kuvendin e Kosovës është post festum duke pas parasysh se çfarë mënyre udhëhiqet Kosova, në çfarë mënyre udhëhiqet shteti i Kosovës. Vendimet merren nëpër qoshe të çuditshme, Kuvendi i Kosovës, duhet të shërbejë ekskluzivisht si një mekanizëm që i implementon vendimet që i merr diku krejt diku tjetër në emër tonin.

Tani është një fjalë në një gjuhë të huaj që thotë: "kur hyp në tren të gabueshëm, krejt stacionet janë të gabueshme", mos prit që do të dalë ndonjë stacion i mirë. Unë po ju them edhe me këtë farë udhëheqje të shtetit, mos pritni që do të dalë ndonjë send i mirë se është gabueshëm në esencë, nuk mundet të dalë diçka mirë pahiri, krejt janë të gabueshme.

Prapë po dëgjojmë këtu se Kushtetuta thotë kështu, ligji thotë kështu, ligji, nëse doni ta dini çka është mashtrimi, është të flasësh sot për ligje dhe për Kushtetutë dhe po ju tregoj pse. A ta shesim, a mos

ta shesim Postën, është vendim politik, është vullnet politik, nuk ka të bëjë me ligj? Ligjet mund ta rregullojnë eventualisht qysh ta shesim, jo a ta shesim a jo? Nuk ka ligj që thotë duhet ta shesim PTK-në, nuk ka nen të Kushtetutës që thotë duhet për ta shitur PTK-n. Ka vullnet politik për ta shitur të Qeverisë të Kosovës edhe kjo është për çka na duhet të diskutojmë sot këtu a ka vullnet politik përfaqësuesi i popullit, a ka vullnet politik populli i Kosovës, që agjenti i vet që është Qeveria ta shesë PTK-në, e jo të diskutojmë a thotë ligji, a nuk thotë ligji apo çka thotë ligji? Edhe punë po ju them me bindje të plotë që populli i Kosovës është kundër shitjes të PTK-së, me plotë të drejtë, mirëpo Qeveria e Kosovës, dëshiron të vendosë ta shesë se një agjent që nuk e pyet pronarin a ta shesë a jo? Edhe një herë po ju them pronar i Postës dhe Telekomit është populli i Kosovës, jo Qeveris dhe as punëtorët e Postës edhe agjenti ka vendosur ta shes.

Unë mund t'ju them juve këtu që diktatura brinjë nuk ka, kur Qeveria nuk e vetë Kuvendin ama bash hiq, atëherë çka po pritni ju prej kësaj pune? Një çështje tjetër që po më brengos kur po dëgjoj këtu edhe do të kaloj menjëherë të falas në emër të Aleancës, është, po thuhet në parim, ne jemi "për". Sot ne diskutojmë a ta shesim a mos ta shesim, nuk bën në parim të jemi "për" e pa parim të jemi "kundër", domethënë, është shumë çuditshëm kur i ndiej deputetët që thonë po a di qysh, na në parim jemi diqysh për ta shitur, por nuk po dimë bash. A besoni që duhet shitur a jo, dhe ky duhet të jetë diskutimi?

Po thuhet, kur të kthehet strategjia, cila strategji të kthehet bre, këta e kanë hapur procesin. Kompanitë e interesuara për ta blerë PTK-në ose atë pjesën profitabile të PTK-së, se atë pjesën humbëse nuk donë ta shesim, ne duhet subvencionuar, duhet dhënë para, pas shitjes? Ato i kanë marrë ofertat, i kanë marr kushtet dhe i bien ofertat shpejt, post festum është, e vetmja mënyrë për t'i ndalur këto, është që Kuvendi të votojë kundër, përndryshe krejt është post festum, kanë marr vendime, kanë ecur. Tani po na thonë duhet ta shesim PTK-n dhe po na japin arsye, arsyet ligjore vijnë poshtë, nuk ka arsye ligjore, vullnet politik është ta shesim a mos ta shesim, nuk ka të bëjë me ligjin, hiq.

Po thonë për ta ndalur korrupsionit, tash shihni ju çka po thotë vetë Qeveria. Ta shesim se na nuk po menaxhojmë e po e vjedhim, na duhet ta shesim. More a ka cinizëm më të madh, a ka ndie dikush ndonjëherë cinizëm më të madh se të thuhet nuk po mund ta menaxhojmë, e rropëm duke e vjedhur e më mirë po e shesim. Ju e dini që ndërmarrjet publike, mund të jepen edhe në menaxhim, është dhënë KEK-u, nëse na nuk po dimë të menaxhojë e marrim një kompani e cila dinë të menaxhojë dhe e japim në menaxhim, vendet i japin portet në menaxhim, i japin hekurudhat në menaxhim. Nëse është çështja bash te dija, mund ta gjejmë dike që **di**, mirëpo nëse është çështja të themi po dom ta ndalim korrupsionin, mund t'iu them, nëse dikush vjen prej Marsit edhe nuk e kupton fjalën cinizëm përmendja këtë që e thashë unë, po i vjedhim e më mirë po i shesim sa po vazhdojmë për t'i vjedhur.

Për të fituar diçka, është një arsye tjetër pse duhet shitur Postën. Qysh të fitojmë kur e shesim një kompani, kompaninë më profitabile edhe i marrim diku nga 300 milionë, po qashtu po kalkulojnë vetë këta, unë nuk po ua vë çmimin, Qeveria po ia vë, ekspertë, super ekspertët që i përmend shpesh Driton Tali. Po na thonë më mirë ta shesim Postën tash, PTK-në se Qeveria bankroton në vitin e ardhshëm. Qysh bankroton Qeveria nëse nuk e shet PTK-në sivjet? A e dini pse bankroton, se ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale pa i marrë vendimet e Kuvendit. Ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale për ta rrjepur për veti, për t'i mbushur xhepat duke thënë se hajt se e shitët edhe Posta, shiten krejt, shiten edhe në fund dalim ndoshta baras, por edhe nga 20 vjet tjera paguajmë kredi. Qe pse thonë duhet shitur Postën.

Tani, po shkoj pak të tregoj pse nuk duhet shitur Postën. E para, së parës, më kryesorja prej të gjithave, pa marrë parasysh financat, pa marrë parasysh kurrgjë tjetër se populli i Kosovës nuk po dëshiron ta shesë, as ju vetë që jeni në pushtet nuk keni votuar për ta shitur herën e kaluar, e keni lëshuar sallën jeni ikur fshehtas prej salle, 42 veta. Ne për ta marrë një kredi 2 milionë euro, po na vyejnë 80 vota në Kuvend, e për ta shitur një aset, që e vlerësojnë 1 miliardë euro, me 42 vota po i votoni, 42 vota bëjnë 1/3 e popullit të Kosovës edhe të fabrikuar. Domethënë, për t'i marrë 2 milionë, 80 veta duhet të jenë këtu se ndryshe nuk bën, e ta shesim asetin më të mirë nacional bën me 42 vota. Unë nuk e di kush do ta blejë, kur e dinë që 2/3 e popullit të Kosovës nuk po donë ta shesin edhe kjo është e para, s'e është demokraci në fund të fundit, populli nuk po e donë ta shesë.

Çështje tjetër është edhe çmimi, qysh bre shitet 300 milionë euro një kompani që derisa kanë ardhur këta në pushtet, i ka prodhuar diku 80 milionë euro në vit e këta po thonë, jo nuk është puna jonë, por prej vitit 2008 ka nisur të bjerë rapid profiti. A e dini pse, se edhe kur marrin vetë vendim që të mos punësuar njerëz, vetë qojnë letra për të punësuar, japin urdhër për të punësuar, domethënë, një ditë e marrin vendimin për të mos punësuar, ditën tjetër marrin tjetër marrin vendim për të punësuar. Këtu është njëfarë barsolote thotë kështu: "Dikush me dek o dek e unë nuk po di kush." Po mbrapsht është krejt.

Edhe e fundit, që mos ta zgjas shumë tepër unë, po flas për çështjen morale, thashë se është vendim politik, shitja e PTK-së, nuk ka të bëjë me ligje, nuk ka të bëjë me Kushtetutë. Kjo Qeveri e Kosovës sot që po merr vendim ta shesë, po them pjesën profitabile të Postës, se nuk po donë t'i shesë as linjat fikse as Postën, ne duhet t'ju japim para. Si ta shesin këta, duhet prej buxhetit dhënë para se ato duhet subvencionuar se nuk krijojnë të ardhura. Këta njerëz nuk kanë kredibilitet moral ta e shesin asetin më të madh nacional, nuk kanë kredibilitet moral se janë të zhytur në korrupsion deri në maje, deri në krye. Janë të hetuar të gjithë për korrupsion. E kanë rrjepur vendin, ku kanë këta kredibilitet moral ta shesin asetin më të madh nacional? Edhe në fund të fundit ku kanë këta kredibilitet demokratik që donë ta shesin asetin nacional me 42 vota të Kuvendit të fabrikuar po ju them, se nëse e nxjerrin listën kush ka qenë prezentë edhe qysh ka votuar edhe i pyesim edhe juve ju vesim a keni votuar ju për ta e shitur, të gjithë keni për të ikur e të thoni, jo unë nuk kam votuar se e dini që është punë e mbrapshtë.

Fundi i fundit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon që nuk duhet shitur në këtë fazë PTK-ja, edhe nuk po them të privatizohet, por të shitët se po do të shitët. Nuk duhet shitur sa të jetë kjo Qeveri në pushtet, me këtë çmim, me këtë mënyrë të degradimit total, se këta e kanë rrënuar biznesin e PTK-së, këta i kanë punësuar me mijëra njerëz politik për t'ia ulur vlerën PTK-së. Unë nuk e di qysh mund dikush të besojë që në Kosovë ne kemi mundur të vijmë deri në këtë ditë, që është njëfarë forme të themi ku ka katastrofë më të madhe, ku ka turp më të madh, ku ka degradim më të madh të sistemit, ku ka shkelje më të madhe të çdo norme të shtet formimit dhe çdo norme morale demokratike, çfarë të doni? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini.

Zonja Sala është paraqitur për replikë. 2 minuta, zonja Sala!

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do ta marrë fjalën për hir të sqarimit të opinionit e aspak për hir të fjalës dezinformuese që e tha parafolësi im.

Shprehja post festum, qëndroj pranë kësaj se është debatuar me dhjetëra e dhjetëra herë në lidhje me këtë temë dhe debati për këtë temë është post festum, ka përfunduar më 27 korrik kur e kemi pasur në rend dite procesin e privatizimit të Postës edhe tjetër, dua t'ia sqaroj opinionit se parafolësi e përdori një shprehje me: “ me vullnet politik” po privatizohet. Vullnet politik mendoj që janë ligjet, kurrkush nuk na shtinë me zor për t' i bërë ligjet, po bash me vullnet i bëjmë ligjet edhe ai është vullnet politik që duhet ta zbatojë Qeveria dhe institucionet. Dhe, krejt në fund arsyetimi i parafolësit pse nuk duhet privatizuar Posta, është shumë naiv dhe thotë se nuk duhet të privatizohet në mandatin e kësaj Qeverie se ai aludon në mandatin kur të vijë vetë, por me këtë qasje nuk kurrë nuk do të arrijë në Qeveri. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

E Dritonit, çka t' i bëjmë, pra? Por jo, njëherë Dritonit ani pse pas një kohe shumë të gjatë për të mirë e përmendi dikush. Okej. Zotit Gjini, pastaj Dritonit.

ARDIAN GJINI: Zoti kryesues, i di procedurat, nëse ia kishe dhënë fjalën para deputetes, zoti Tali, atëherë ai kishte pasur të drejtë të flasë para meje. Nuk pres kurrgjë më mirë prej deputetes që sa po foli, nuk di, më vjen shumë keq, nuk di kurrgjë, as nuk fyhem prej fjalëve kë saj. Ajo vetëm e di se e ka marrë një urdhër të Partisë për ta kryer këtë punë edhe përfundon me aq. Më vjen shumë keq që është shndërruar Kuvendi i Kosovës në këtë nivel që ka rënë, vetëm të marrë urdhra e të mos mendojë hiq. Po më vjen keq, nuk di, nuk kam çka t' i bëjë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Tali.

DRITON TALI: Unë desha vetëm një send ligjor këtu, jo parimore, ta sqaroj fjalën e Jakup Krasniqi, kryetar i Parlamentit, kur e mbyll debatin, e kam transkriptin, merreni lexojeni, thotë kështu: “Të gjitha këto farë vërejtje të inkorporohen në dokumentin e Strategjisë për privatizimin Postës”, (fjalinë e fundit jam kah e lexoj), në shtator i silltet Kuvendit, Komisioni dhe Qeveria i bëjnë rekomandimet dhe ne do ta votojmë strategjinë, me rekomandimet e Komisionit”, sot e votojmë në parim, Jakup Krasniqi, më 27 korrik 2010. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Tali!

E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Buja.

RAMË BUJA: Zoti kryesues,

E para gjë që po dua ta shpreh është që hiq nuk ndihem mirë që jam pjesë e këtij Parlamenti, për kulturën dhe nivelin komunikues që ka. E dyta është, po më vjen keq prej kolegëve të mi deputetë, po duhet për t'u risqaruar se kjo strategji është votuar ... në parim dhe përsëri i është kthyer Komisionit Parlamentar që ka për të bërë rekomandime dhe ne në Kryesë bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare e kemi pasur në trajtim dhe ajo strategji do vijë sërish në Kuvend, bashkë me rekomandimet dhe do të debatohet edhe një herë mbase, nëse dikush ka vullnet dhe dëshirë për të bërë tautologji, dhe pastaj do të votohet për të vepruar më tutje. Kjo është shumë e qartë. Andaj, zotëri Tali nuk tha gjë të re, e tha diçka që është e vërtetë lakuriqe, andaj po them një gjë, që nëse u tha pos- skriptum, është thënë në kuptimin besoj unë të asaj që është bërë aq shumë debat sa që është harxhuar dhe gjithçka tani është më përsëritje për këtë gjë, përndryshe akoma Qeveria nuk e ka marrë lejen katërçipërisht nga Parlamenti për të vepruar ashtu siç do të duhej vepruar për të hapur tenderin për privatizimin e Postës. Andaj, mos të kemi shqetësim paraprak, ju lutem, duke i banalizuar gjërat, sepse atëherë kur do të votohet mirëfilli me rekomandimet që do të vijnë nga Komisioni përgjegjës, atëherë Qeveria do marrë hapa që duhet ndërmarrë. Andaj, unë e kisha lutur

kolegët që të kursehen nga fyerjet e ndërsjella, sepse kjo nuk do të na bëjë i nder as institucionit as individit që mund të nxjerrë këto nga goja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Buja edhe për sqarimin. Kjo është vetëm një debat, kuptojeni këtë, ky është vetëm debat. Sot është vetëm debat. Pasonjë ato që tha zotëri Buja, është e vërtetë.

Zotëri Tali, ju lutem po ju jap 1 minutë replikë, por po ju lutem që të keni konsideratë edhe për ne!

DRITON TALI: Unë pajtohem plotësisht me deputetin shumë të nderuar, zotin Ramë Buja, por ajo që nuk e kam të qartë nga Qeveri është pse e ka shpallur tenderin për privatizimin e Postës, në gusht, kur ende nuk e ka marrë lejen nga ky Parlament? Ju faleminderit! Dhe, unë i kam emrat e atyre që kanë konkurruar. Shumë faleminderit!

KRYESUESI: Keni bërë në dilemë shumë delikate, zoti Shala, e ka fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Unë dua t'i informoj deputetët dhe publikun se procesi i privatizimit të një ndërmarrje publike, sidomos të një ndërmarrje kaq strategjike, është proces, nuk është akt i një momenti të vetëm. Në momentin kur Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 27 korrik, apo jo, ka aprovuar në parim strategjinë, pra në parim i ka thënë po privatizimit, detalet të cilat u ngritën këtu, do të debatohen dhe neve presim nga Grupi Parlamentar që t'i japë rekomandimet se cilat duhet të bëhen përmirësime dhe ky proces, ky Kuvend do t'i votojë. Ne, për të mos u vonuar në proces kemi shprehur interesin, përkatësisht thirrje për shprehje të interesit si proces paralel me këtë që të mos vonohemi në proces. Pa e marrë vendimin ky Parlament, nuk shpallet tenderi. Unë, natyrisht që thërras që të aprovohet strategjia e Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, të gjitha sugjerimet të cilat i kemi thënë, do të ndikojnë ose do të ngrenë sigurinë nacionale, atë që tha strategjike, operatorin strategjik që të ketë disa projekte nacionale në zhvillimin e sektorit, ruajtjen e interesave strategjike të Kosovës, do t'i inkorporojmë në kontratë, çështjen e ruajtjes së pjesës së aksioneve të Kosovës dhe rritjen e transparencës.

Kështu i kemi kuptuar sugjerimet që janë dhënë këtu, nuk kemi vendosur dhe me tender pasi që ju ta vendosni, besoj në javën e ardhshme, kurdo, lusim që ta vendosni sa më shpejtë, ne të gjitha sugjerimet dhe ndryshimet pozitive, të cilat Komisioni parlamentar, natyrisht në qoftë se Kuvendi i aprovon, do t'i reflektojmë së bashku me ekspertët, t'i analizojmë dhe t'i futim në rregullat e tenderit dhe në të gjitha kushtet për privatizim. Nuk do të ketë përmbyllje të këtij procesi pa e pasur ne dritën e gjelbër prej juve. Kështu e kemi thënë edhe para një viti edhe para gjashtë muajve dhe nuk ka, si të them, ndonjë ngritje të frikës se ne do t'veprojmë diçka pa e marrë konform ligjit, si të them, bekimin nga ju. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! Në radhë është AKR-ja. Fjalën e ka zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë që janë prezentë,

Duke marrë parasysh se sot është debat për çështjen e privatizimit të PTK-së, kur dihet se në shtator ka kaluar strategjia për privatizimin e PTK-së, në lexim të parë, atëherë më e rrugës kishte qenë që ky debat të ishte bërë para fillimit të miratimit të strategjisë së privatizimit të PTK-së.

Mirëpo, duke marrë parasysh se u cek edhe nga shumë parafolës këtu, që në të gjitha rekomandimet apo në të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve që janë dhënë në seancën e shtatorit, do të

implementohen brenda strategjisë, është shumë e kotë të debatohet mbasi vendimet e Qeverisë do të kalojnë prapëseprapë brenda këtij Kuvendi, kur dihet se kjo Qeveri ka numër të madh të votave. Sa është e rrugës të shitet PTK-ja, në rast se vlerësohet ana pozitive e qytetarëve dhe ana pozitive e Qeverisë në favor të qytetarëve, atëherë do të mbetet përgjegjësi morale e kësaj Qeverie që të marrë vendime të duhura, në kohën e duhur për futjen e investitorëve direkt në PTK.

Grupi Parlamentar i AKR-së, duke marrë parasysh se debati është dashur të zhvillohet para ardhjes së strategjisë në Kuvendin e Kosovës edhe të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e veta do t'i transferojë në Komisionin parlamentar, i cili do t'i marrë rekomandimet për privatizimin e PTK-së, kur dihet se në bazë të Ligjit të ndërmarrjeve publike, vendimi për privatizimin e një ndërmarrje publike, duhet të merret brenda Kuvendit të Kosovës. Para, shtrohet çështja se AKR-ja nuk e sheh shumë të ngutshëm çështjen e privatizimit të PTK-së, me 75% të aksioneve, shitjes së investitorit të huaj, mirëpo të bëhet një analizë e mirëfilltë se sa fiton dhe sa humb Kosova, pavarësisht nga ky privatizim, kur dihet mjaft mirë se aset i PTK-së, është aset i cili i ka sjellë edhe shumë të mira buxhetit të Kosovës dhe kur dihet se në privatizimin e PTK-së do të kemi një numër të madh të punonjësve të cilët do të mbesin jashtë këtij procesi, për arsye se teknologjia informative ka arritur aq lart, sa që mundësia e aksionarit të ri apo investitorit të ri, nuk do të jetë i mundur që t'i mbajë gjithë këta punëtorë, kur dihet se në Kosovë, çdo vit në treg nga dalin 30.000 të papunë dhe mundësia për punësim të rinjve është shumë e vogël.

Edhe një herë shpreh qëndrimi e AKR-së, se vendimi për privatizimin e PTK-së nuk duhet të merret në kohë shumë të shkurtër, ad-hoc, pa një realizim të mirëfilltë, ministër, pa një strategji të mirëfilltë çka fiton dhe çka humb Kosova nga ky privatizim kur dihet se akoma Kosova funksionon me kodet telefonike të shteteve të huaja dhe akoma ne paguajmë para të majme për kode telefonike të huaja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Selmani! Në radhë është LDD-ja, zoti Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt procesi i privatizimit të Postës, jo vetëm që ka zgjuar debat këtu te ne që padyshim se është obligim dhe përgjegjësi e këtij Kuvendi, në mënyrë që një herë e përgjithmonë të debatojë për asetin më të rëndësishëm të vendit.

Ju e dini se edhe në legjislaturat e kaluara, kur kemi biseduar dhe është shfaqur tema se kemi të bëjmë me një privatizim të dështuar në Kosovë, me një privatizim i cili nuk ka sjellë asnjë risi për ekonominë e Kosovës, në fakt qytetarët e Kosovës nuk kanë përfituar asgjë nga ajo, përkundrazi janë varfëruar edhe më shumë, por ka sjellë një rezultat, por janë pasuruar individët, individët sot udhëheqin me procesin e privatizimit, udhëheqin me shtetin e Kosovës dhe me institucionet e vendit. Prandaj, kjo duhet të shtrohet një herë e përgjithmonë. A e dini pse sot insistohet më së shumti në privatizimin e Postës? Pse zotëri Shala nuk del para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës t'u thotë një gjë sa është vlera e Postë-Telekomit të Kosovës, a e din dikush? Pse sot insistohet kur të gjitha tregjet ndërkombëtare manipulohen dhe po ballafaqohen me rënie. A është insistim i vazhdueshëm i kësaj Qeverie të ulet një herë vlera e këtij asetit të rëndësishëm dhe deri në falimentim, apo po e them para falimentim dhe pastaj të shkohet në privatizim? Kush do të jenë ata blerësit potencial të cilët do t'i dhurojnë Kosovës atë ekonominë e vet, ato të hyra buxhetit të Kosovës në këtë formë?

Unë besoj se këto janë disa pyetje për të cilat Kuvendi i Kosovës duhet të marrë përgjigje. Nuk mund të marrë përgjigje në këtë formë. Kuvendi i Kosovës është si organ politik, duhet japë përgjigje pse s' duhet të privatizohet dhe pse në këtë kohë nuk kemi asnjë benifit derisa vendet e rajonit i kanë rritur

çmimet e telefonisë mobile, derisa vendet e rajonit edhe ashtu kanë privatizuar me asete shumë të kufizuara, ne shkojmë të parët 75%, ne do t'i privatizojmë edhe ato askete të cilat i kemi, të resursit nacional dhe çka do të përfitojë Kosova? Ato çka i tha zonja Besë, unë nuk do t'i përsëris, mirëpo vetëm një gjë duhet ta kemi parasysh. U paraqit këtu post festum, Kuvendi të mos sillet në pozitë se tash të debatohet post mortum. Kjo ka vdekur, nëse kjo ka vdekur kështu çështja e privatizimit, atëherë është fatkeqësia më e madhe e Kuvendit, mirëpo është përgjegjësi e Kuvendit, se Kuvendi është sjellë në lajthitje vazhdimisht, e ka humbur autoritetin e vet. Sot Kuvendin nuk e pyet kurrkush për asgjë. Prandaj, të gjitha këto letra që na kanë ardhur prej qytetarëve të Kosovës, ata me plot të drejtë kërkojnë një përgjigje nga Kuvendi. Mirëpo, duhet ata dinë, Kuvendi nuk ka autoritet, Kuvendi nuk ka fuqi, Kuvendi nuk mund ta orientojë Qeverinë në kahun e duhur në këtë proces, për arsye se Kuvendi ka humbur autoritetin dhe rolin që e ka kushtetues.

Nëse disa deputetë të grupeve parlamentare mendojnë se do të ndryshohet procesi i privatizimit ndërkohë, nuk mund të ndryshohet. Nuk mund të ndryshohet ky proces i privatizimit derisa udhëhiqet nga njerëzit e kanë dështuar procesin e privatizimit që nga fillimi. Këto janë akuza shumë të mëdha. Nëse dikush mund të thotë ky zotëri a është normal, këto akuza si i drejton, le të merret. A u sqarua ndonjëherë marrëveshja fantome PTK- Dardafon, e cila e kanë ulur vlerën e PTK-së për 70%? Me këtë duhet të merret Prokuroria e shtetit, duhet të merret Njësia Speciale e Hetimit. Prandaj, a është duke u marrë ndokush, a ndoshta paska qenë skenari i përgatitur që njëherë të ulet vlera e PTK-së, pastaj të shkohet në shitje dhe do të përfitojnë prapë individët të cilët kanë përfutur vazhdimisht. Këtu populli i Kosovës duhet ta ketë një përgjigje, dhe përgjigja duhet të jepet, por nuk mund ta japë ky Kuvend. Prandaj, të nderuar deputetë, nëse ekziston të paktën një moral politik, një moral njerëzor tek secili kuvend, tek secili deputet, atëherë le t'i thotë jo privatizimit në këtë kohë në dëm të Kosovës dhe në dëm të popullit, jo privatizimit, jo faljes së aseteve shtetërore dhe jo tjetërsimit të pronës së shtetit. Në këtë formë, çfarë është duke shkuar, ne vazhdimisht kemi thënë do të jemi qiraxhi në tokën tonë, por jo në këtë formë.

Së pari, nëse influenca politike në Kosovë nuk po mundet të shtetet tjera të influencojnë për shkak se në Kosovë ka një dinamikë, të paktën, po influencojnë në forma tjera, e kanë gjetur rrugën përmes tjetërsimit të aseteve dhe përmes, fundi i fundit Kosova do të udhëhiqet nga 3-4 individë, ekonominë e Kosovës në të ardhmen. Kjo do të bëhet transparente dikur, mirëpo do të merr kohë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në radhë është Grupi Parlamentar “7+”, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Dozvolite mi da pozdravim i malobrojne predstavnike Vlade, kao i kolege poslanike!

Proces privatizacije PTK, kao što vidimo u današnjoj debati, poprima posljednjih meseci izuzetnu pažnju javnosti Kosova. Ja mislim da to nije ni malo iznenađujuće obzirom na, pre svega, ekonomsku vrednost ove institucije, dakle PTK. (ja bih molio malo pažnje, ako možete...!)

KRYESUESI: Unë besoj, zonja e zotërinj, që kemi interes të madh për ta dëgjuar deputetin Xhezair Muratin çka po thotë.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

Kažem, smatramo da je trebalo, kao i što su i mnoge kolege naveli, da još više treba da radimo ili da se radilo na pojašnjenjima - šta ustvari građani Kosova dobijaju privatizacijom, a što su dobijali dok je ona, jer je još u državnom vlasništvu. Mi predstavnici manjinskih zajednica, normalno, moramo govoriti iz ugla građana koje predstavljaju i mi svakako smo samim tim u sasvim specifičnoj

situaciji jer nam nisu dovoljno poznati kriterijumi a ni status naših predstavnika, uopšte nije poznato kakva će biti kvota zaposlenih. Enigma je šta će biti sa eventualnim viškom radnika ili novo primljenih, postoji li neki kriterijumi, brožčani ili bilo kakvoj drugi, kako bi smo mogli bliže da govorimo o ovoj problematici. Kada ovo govorim, navešću da imamo negativna iskustva sa dosadašnjom privatizacijom. Kao primer ću navesti privatizaciju jedne male hidro- elektrane u opštini Dragaš, koja se zove Dikance, koja je privatizovana i gde su na udaru viška radnika prvo došli predstavnici manjinskih zajednica. Dakle, ovo je već jedno negativno iskustvo i mi, zaista, kada o svemu ovome govorimo, imamo svoj ugao gledanja, svoji interes, kao i svi građani Kosova, naravno, i zašto kažem mi smo privatizacijom najveći gubitnici, a samim tim ova naša rezervisanost i skepsa o kojoj govorimo mora da bude shvaćena. Mi želimo da sve bude transparentno, mi zaista očekujemo da će se, pre nego se krene sa privatizacijom, potpuno razjasniti uloga, kriterijumi, dobit izražena u procentima, finansijski i tako dalje, pa tek onda da se oko ovoga odredimo. Hvala vam na pažnji, gospodine predsedavajući i kolege!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!

Në radhë është SLS. Nuk ka të paraqitur. Nga Grupi për Integritet, kush e do fjalën?

Zonja Vezira e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo danas pred Skupštinom, na inicijativu Grupe LDD, imamo pred sobom jako značajnu pojavu ovde u Skupštini, kada je privatizacija Pošte, Telekom Kosova.

Ja bih rekla u prvoj predstavi, kada nam je predstavljena privatizacija pred ovom Skupštinom, mi smo bili jako neozbiljni kao Skupština. Pojedine grupe su bojkotovale i napustile, što je bilo prilog za glasanje, gde bi mogli da se dogovorimo i možda i da nadglasamo, bez obzira što smo mi deo vlade. Kada je privatizacija u pitanju Pošte i poštanskih usluga, mi kao grupa razmatrali smo pažljivo. Jako smo pristupili ozbiljno ovoj temi, jer znamo da se radi o jako velikom nacionalnom interesu Kosova, da je to jedna profitabilna organizacija koja praktično donosi dobit. U svakoj analizi strategije Vlade, jako se trudila ova među ministarska komisija da nam prikaže da ustvari pada dobit Pošte i telekomunikacija. Međutim, ja moram da kažem do znanja, iz same analize, ne možemo da zaboravimo da smo mi dali da jedan od operatora, kao što je IPKO, 91% operator je PTK, 9% je operator IPKO, što znači da su se prihodi prelili kod privatnog operatora, što smo to učinili svesno i zato što je to obaveza Zakona o slobodnom tržištu i mi smo kao Skupština, kao Vlada, normalno dozvolili da jedan od operatora dođe na ovo tržište, ali zato ne možemo sada da kritikujemo dobiti Pošte zato što je IPKO preuzeo jedan deo zarade.

Jedno jako veliko pitanje jeste to što smo mi imali jako, posle rata znamo svi da smo dobili mobilnu telefoniju, da ona ima kod Monaka, i na ime izjave direktora i analize koje su se dešavale u regiji zadnjih 6-7 godina, mi znamo da je Telekom svake godine gubio po 50 miliona na ime ugovora koji je imao sa Monakom, gde je plaćao za kod i ostalo, znači gubio. Ovo je izjava direktora Telekoma, gde sam se potrudila da analiziram kakva je bila situacija posle rata kada je bila Vala 900 u pitanju. Jako bitno je da nam je ovde premijer, meni je žao što nije tu, da je ovako doslovce rekao, to što sam zapisala, da nije u pitanju prodaja, nego da je u pitanju razvoj ekonomije na Kosovu kada je u pitanju prodaja pošte.

Međutim, ja moram da kažem da je sadašnja Vlada jako vešti stručnjak za destrukciju ekonomije i to radi nacionalnog dobra, destrukcija. Zašto ovo kažem? Kada je u pitanju prodaja, prodaja se vrši, svi znamo kada je u pitanju prodaja da mora da postoje kriterijumi za prodaju i ponudu. Prvi kriterijum je biznis plan sa socijalnim programom i, normalno, finansijska ponuda koja se sastoji od

kupoprodajne cene, znači nema početnu cenu, ima neku okvirnu cenu od 300 do 600 miliona, kao da je to neka tezga i gotovo, i ima, mora da ima investicioni program, nema znači predgovor i predmet investicionog programa gde će biti ulaganja.

Jedno što je opet jako važno, mi kao grupa što smo razmatrali, jeste da su političari sa ovom prodajom i Vlada, normalno, na čelu, omogućili da se jedan uži sloj ljudi, da kažem, zainteresuje, kao što su kompanije koje su nam bile sada u pitanju i gde iz javnosti čujemo da je produžen rok za tender, za prijavljivanje, znači te kompanije i država, zajedno sa analizom trebala bi da zna, ako je u pitanju ekonomija, koliko dobija državna kasa, ako jedno radno mesto... Šta je ekonomija? Ekonomija je unapređivanje rada, tržišta radnih mesta. Ako jedno radno mesto znamo da u regiji košta negde oko 5 hiljada eura, koliko radnih mesta može da se obezbedi prodajom PTK-a? Koliko radnih mesta smo obezbedili prodajom Aerodroma, koliko radnih mesta možemo obezbediti u posebnim fondovima prodajom Elektroprivrede, jer vidimo da je ovo, kaže, presedan za dalju privatizaciju, što će se sigurno desiti.

Procenom tržišne vrednosti znamo da se bave posebne agencije i ko ne bi kupio kompaniju za upola manju cenu. Neću da opterećujem kolege. Jedna kompanija koja kažu da košta milijardu, ja kažem, po našoj proceni da je to milijardu i po, ko ne bi kupio ovu kompaniju za upola manju cenu ili za sniženu cenu. Jako je vidno na tržištu, Evropskom tržištu to što se dešava, kada su u pitanju nevešti prodavci i kupci, prvi kupac bi sigurno preprodao ovu kompaniju, možda i drugi. Ko bi se sve ugradio u ovom lancu procene vrednosti i ko bi sve dobio proviziju na muke i našu socijalnu bedu i na našu nezaposlenost. Samo ja kažem ovo, samo 1% provizije na 300 miliona ili 600 miliona je 3 ili 6 miliona, 10% je 30 i 60 miliona. A imamo plan i razvoj koliko bi trebali mi da ovo investiramo za Poštu, verujte mi samo ta provizija. Sakupite stranice strategije od 52 do 58, ukupna investicija koja bi trebala za našu bežičnu telefoniju za sliku, za ton i za sve, to je negde oko 60 miliona. To je samo jedna provizija, jedna pošta, jedna organizacija koja radi sa dobitkom od 70 miliona u šestomesečnom izveštaju sa 210 miliona ostatka, mi je nudimo na popust. Ne obavezuje nas na ime toga, ni MMF banka, MMF banka ne kaže prodajte Poštu da bi imali pare. MMF banka kaže da mi moramo da imamo ostatak nacionalnog dohotka, da moramo da imamo jednu trećinu nacionalnog dohotka slobodnog u novcu. Mi to možemo i radom, ne prodajom. Mi možemo isto nacionalne infrastrukturne objekte da gradimo isto radom. Mi možemo da smanjimo sivu ekonomiju, mi možemo da malo više imamo međuministarske komisije i kontrole kada su u pitanju javna preduzeća, kada je u pitanju javna potrošnja, kada je u pitanju broj zaposlenih. Verujte mi ja moram kao poslanica da kažem, mi u Skupštini dobro znamo da danas zapošljavaju i u javnim preduzećima ministri, predsednici partija i to više mora da prestane. Mi moramo da napravimo analizu ljudi koji stvarno vrede, ljudi koji su stručnjaci, koji trebaju od menadmenta do rada. Mi samo tako možemo da pospešimo našu situaciju, kada su u pitanju javna preduzeća. Znamo dobro da ne postoji poseban Zakon za privatizaciju, što bi mi kao Skupština mogli da tražimo sa potpisima, da vidimo kakav je fizibilitet, šta je sve urađeno. Ja sam sve ovo napomenula i kao Grupa za integraciju mi ne podržavamo, i u prošlom izjašnjavanju rekli smo da ne podržavamo i ja apelujem na sve kolege poslanike da ne budu danas poslušnici svojih lidera, da pogledaju pozadi svoje građane, da pogledaju koliko ljudi radi u svim ovim javnim preduzećima, a sa trudom i sa dobrim menadmentom, organizacijom, koordinacijom i da kažem velikom pažnjom i odgovornošću mogu da se srede situacije u ovim javnim kompanijama, one su naše nacionalno blago. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Vezira!

Po, sipas kësaj po del që liderët nuk kanë lidhje me popull shumë. Pra, një gjë të tillë ende nuk guxojmë të konkludojmë.

Sidoqoftë, tani e kemi një çështje për ta zgjidhur, a do të bëjmë pauzë a do të vazhdojmë? Po ju lajmëroj se janë edhe 19 veta në radhë, në qoftë se ngutemi për një orë e gjysmë e kryejmë. Çka po thoni?

(Konsultime)

Ky është debat. Besa, mirë e ka ministri ma përkujtoj, po dy orë u bën debat, pse të mos shkojmë në shtëpi ne krejt tash? Nejse, sido qoftë deri në orën 14,30 ju lutem ejani që të kemi kënaqësinë për të dëgjuar vazhdimin e debatit.

Vazhdimi i mbledhjes pas pauze

KRYESUESI: Zonja e zotërinj, po vazhdojë debatin rreth privatizimit të PTK-së. Unë do të dëshiroja të merremi vesh që fjala e deputetëve të jetë 5 minuta. A po pajtoheni? Okej. Ju faleminderit!

Regjia, 5 minuta fjalën dhe në radhë është zoti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është ky një debat që ka një peshë gjithmonë të rëndësishme dhe shumë interesante, sepse bëhet fjalë për një kompani publike, e cila pas luftës e këndej ka pasur kapitalin më të madh të menaxhimit kësaj. Është një kompani e cila në këto 10 vjet ka provokuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm menaxherët dhe njerëzit që kanë punuar brenda kompanisë, por gjithë klasën politike të Kosovës dhe e cila, realisht shikuar në asnjë fazë nuk ka treguar nivelin e duhur për ta siguruar pavarësimin e një ndërmarrje publike.

Sidoqoftë PTK, ka disa pozicione shumë të rëndësishme dhe elemente se atë e bëjmë të mirë. Gjatë këtij viti mund të përmendim shtimin e numrit të konsumatorëve nga 800 milionë në 1.1 milionë. Pra, kur një gjë duhet të privatizohet, atëherë kujtojmë që ajo duhet të bëhet në kushtet dhe në arritjet e saj më të mëdha. Si rezultat tjetër i mirë është edhe shpërndarja e mbulesa e saj, shtrirja anë gjithë territorin nga 92.7 në 99.7%. PTK, gjithashtu, ka shtuar dhe numrin e shërbimeve deri te premtimi i hapjes së televizionit kabllor. Mirëpo, ne shpeshherë kemi harruar se duke u marrë me një kompani, e cila është shumë fitimprurëse në Kosovë, kemi bërë pa dashje edhe dëme, një qasje shumë nihiliste ndaj Postës, për mendimin tim është e shumë e dëmshme dhe ajo ka dëmtuar imazhin e saj.

Në këtë drejtim, në mënyrë të veçantë PTK është dëmtuar nga operatorët ilegalë të cilët realisht nuk kanë mundur të shkyçen dhe ky është një problem shumë real për kompanitë të cilat dëshirojnë të konkurrojnë që do ta ulë vlerën e këtij aset kombëtar. Gjithashtu është edhe mos kultura dhe papërgjegjshmëria e menaxhmentit të kësaj, në kuadër ndërmarrjeje publike si dhe interferimet. Mirëpo dua të shtoj se në kohën e fundit, ndërhyrja e EULEX-it në Postë, ndoshta është bërë në kohën më të gabuar, sepse realisht e ka ulur vlerën e kompanisë. Kjo çështje ka mund të shtyhet, ka mund të menaxhohet, konsideroj se ... ka pasur elementet e nevojshme për ta menaxhuar atë dhe ka qenë një ndërhyrje shumë e gabuar, sepse ka humbë vlerën e saj, madje ka edhe zëra të ndryshëm që flasin se kjo çështje është bërë në mënyrë të qëllimshme për t'ia humbur vlerën asaj.

Megjithatë, dua të them se PTK gjithnjë e më shumë do të mbetet në duart e grupacioneve të ndryshme, të interesave dhe ata do ta përdorin në formë shumë të egër. Duke ditur se kjo çështje është kështu dhe duke ditur se institucionet tash e 10 vjet nuk kanë qenë korrekt në raport me PTK-

në, është koha e fundit që PTK-ja të privatizohet dhe ta shpëtojmë nga kthetrat e gjithë asaj mësymje të grupeve të interesit, të cilët realisht edhe kanë bërë pasuri. Mos harroni, se opozita edhe deputetët duhet të mendojnë, në qoftë se e shtyjme PTK-në, ajo nesër do të blihet edhe prej grupacioneve prej të cilave vërtet do të jetë shumë rrezik t'i lejohet një kapital kaq i tillë i menaxhimit. Kjo do të thotë se ata nuk kanë dëshmuar ndonjëherë se dinë t'i respektojnë rregullat dhe ligjin. Prandaj, PTK-ja duhet sa më parë të dalë në privatizim dhe t'u jepet hapësirë e gjithanshme opozitës dhe të gjithë të tjerëve që janë të interesuar për ta shpalosur maksimalisht transparencën e saj dhe procedurat që duhet t'i ofrohen. Më vjen shumë keq që kam dëgjuar këtu deputetë, të cilët kanë filluar në Kuvendin e Kosovës të ankohen për Kuvendin e Kosovës. Ky është një minimum i mos kulturës parlamentare. Në qoftë se deputetët, çdo deputet këtu është sovran dhe ai duhet ta ruajë sovranitetin e vet për të përfaqësuar ata që e kanë sjellë këtu, e jo të ankohet se ky Kuvend vlen apo nuk vlen. Në qoftë se opozita e ka shantazhuar vetveten në kohën kur ajo ka qeverisur, nuk është faji ynë, dhe ata tash për ikës arsye nuk guxojnë realisht t'i thonë problemet që mund të janë.

Prandaj, kisha këshilluar që në Parlamentin e Kosovës të ndalet tendenca për ta njollosur edhe Parlamentin, sepse ...

KRYESUESI: Edhe një minutë, zotëri Hotit, meqë është i pari.

REXHEP HOTI... Desha të them se Parlamenti është vendi ku ne duhet të ballafaqohemi. Le të urdhërojnë opozita le të sjellin faktet këtu. Ky debat është për shkak të opozitës dhe ne nuk guxojmë debatin parlamentar ta njollosim dhe t'ia humbim karakterin atij. Është kënaqësi dhe është e shëndetshme që ne nuk pajtohemi në shumë gjëra, megjithatë janë rregullat që janë vendosur tashmë dhe ato ne duhet t'i respektojmë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hoti!
Fjalën e ka zonja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë!

Për anëtarët e Qeverisë mungojnë dhe nuk kemi se si t'i përshëndesim nga shtëpitë e tyre, por një përshëndetje e veçantë për nxënësit e shkollave të mesme e të qyteteve të ndryshme të Kosovës, që sot në Ditën e Demokracisë janë këtu te ne dhe po e përcjellin këtë debat.

Kosova ka nevojë për investime në infrastrukturë dhe për zhvillim ekonomik, hapje të vendeve të raja të punës dhe perspektivë evropiane, por a do t'i kontribuojë privatizimi i PTK-së këtij procesi zhvillimit ekonomik të vendit? Po t'i bëhet një analizë e mirëfilltë këtij procesi, privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, del se ky proces ka rezultuar si shumë i pasuksesshëm në Kosovë, me shuarje të ndërmarrjeve, largim të vetë të punësuarave nga vendet e tyre të punës, varfërim të skajshëm. Por edhe nga ato që janë shitur edhe më tej paratë e mbledhura nga Fondi i privatizimit mbi 500 milionë euro, mbesin jashtë vendit dhe mbeten të pa investuara në Kosovë. Thjesht privatizimi në Kosovë është histori dështimi, janë shumë pak ndërmarrje të suksesshme nga ky proces. Privatizimi i PTK-së, është një detyrë shumë e vështirë dhe e komplikuar, mandej kundërshtimet nga të gjithë duke pasur parasysh se kemi vërejtje të mëdha nga qytetarët se ky proces duhet të ndalet, mos transparenca gjatë procesit të privatizimit, janë disa nga problemet që po e përcjellin këtë proces.

Mungesa e infrastrukturës ligjore të domosdoshme, ka dilema se ky proces mund të kryhet në mënyrë të rregullt dhe pa përfitime të pushtetarëve. Duke pasur parasysh faktin se PTK-ja është kompani

profitabile dhe afaron me sukses, kërkojmë që ky proces të ndalet dhe Qeveria edhe më tej të vazhdon ta mbikëqyrë PTK-në dhe të përfitojë nga ajo si nga dividenda, nga tatimet dhe taksat e ndryshme.

Vlerësojmë se privatizimi i PTK-së në këto momente, është hap i ngutshëm dhe jo i vlerësuar mirë nga ana e Qeverisë. I sugjerojmë Qeverisë në këto momente të angazhohet për rritjen e vlerës së PTK-së, jo të vazhdojë t'ia zvogëlojë vlerën siç po ndodhë tani, madje këtë e pohoi edhe vetë ministri i Ekonomisë dhe i Financave, gjatë deklarimit të tij sot se nga viti 2007 e deri me tani ka kanë ulur vlerën e PTK-së dhe vazhdimisht PTK-ja është në rënie të afarizmit të saj, e dihet me qëllim për ta blerë vetë dhe atë sipas çmimit që ata dëshirojnë, për këtë harroi ta pohojë vetë ministri. Në vend të kësaj, të nderuar qeveritar angazhohuni dhe krijoni kushte më të favorshme për t'i hyrë procesit të privatizimit të PTK-së, me qëllim që ky proces të jetë më i lehtë dhe më favorshëm apo më profitabil për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Rysha!
Tani e ka fjalën zoti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit për fjalën e dhënë!

Unë do të filloj nga përfundimet e mbledhjes plenare që i kemi pasur në këtë Kuvend, të datës 27 korrik, ku me një paragraf përfundohet se Kuvendi ka votuar në parim strategjinë për privatizimin e PTK-së. Dhe unë kisha dëshirë t'u lutem të gjithë atyre që e udhëheqin seancat plenare që të na shpjegojnë çka do të thotë votim në parim i strategjisë. Unë kam menduar se vetëm ligjet votohen në parim. Nuk ka mundësi që të votohet strategjia në parim. Po sido që të jetë, kjo është edhe shumë shpjeguese, sepse, gjithsesi është tentuar me kaluar disi si nëpër mjegull edhe pas shumë aferave korruptive nëpër PTK, ku më aty nuk ka pasur rëndësi se a po shkohet në privatizim, aty është kërkuar që të futet dora e ligjit aty, që Prokuroria e Shtetit, po edhe Prokuroria Speciale ashtu siç kanë thënë, janë nën hetime që të pasurohet PTK-ja.

Vetë vendimi që të votohet në parim strategjia dhe pa asnjë mëdyshje, pa asnjë hezitim, pa asnjë pikë ndershmërie shkohet në tenderin për shitjen e "Valës" dhe kjo bëhet gjithashtu me tendencë shumë të ngjashme, njëjtë siç ka ndodhur me telefoninë e dytë mobile në Kosovë. Juve të nderuar, ju kujtohet shumë mirë rastin i 16 milionë e 200.000 euro. Në shikim të parë, thuhet se veç 16.200.000 euro, por keni parasysh se po i vejmë në siklet shtetet mike që e kanë ndihmuar Kosovën si në këtë rast është Sllovenia që e ka fituar tenderin ashtu siç e ka fituar mbas shumë përfaljeve dhe tash mund të ndodhë, që procedurat tenderues të telefonisë së dytë mobile nuk janë të rregullta, dhe çka ndodhë? Aleatët tanë, që ne na ndihmojnë, ne i refuzojmë, ne i bëjmë kundërshtarë. Ngjashëm me atë rast, më falni, por ka mundësi që tenderi i dytë i telefonisë mobile të ngre dyshime të bazuara se nuk ka qenë i rregullt, me vetë faktin se 16 milionë e 200 mijë euro, kurrë nuk janë deponuar në buxhetin e Kosovës. E tash çka ndodhë, tentohet për t'u dhënë një shpjegim shumë banal, shprehja e interesit nuk është tender. Të gjithë ata që mund të thonë se çka është shprehja e interesit nëse nuk është tender, le ta thënë publikisht. Nuk është e ndershme për të manipuluar opinionin publik të thuhet se nuk është tender shprehja e interesit. Por, shprehja e interesit paraqitet edhe konkurrojnë kompani prej Rusie e deri në Amerikë, konkurrojnë kompani që të blejnë operatorin mobil në Kosovë. Konkurrojnë, shprehin interesin dhe nga ata që shprehin interes bëhet lista e ngushtë dhe nuk ka mundësi që të konkurrohet më pastaj, sepse bëhet lista e ngushtë prej tyre, është fazë para kualifikuese, është fazë para kualifikuese, me fjalë të tjera është procedurë se tek e fundit edhe shteti është procedurë sipas disa botëkuptimeve teorike mbi shtetin. Edhe e kemi rastin, paraqitet situata, tentohet jo nuk është tender, shprehja e interesit është veç jemi dalë në pazar, por ndoshta me zhargonin e juaj mund t'i thoni pazar, ndoshta aksham pazar po. Por, në procedurat edhe të

partneritetit publiko-privat, por edhe sipas Ligjit të prokurimit publik është fazë në procedurën e tenderimit.

Dhe tash paraqitet një situatë shumë e çuditshme. Çka do të ndodhë nëse ky Kuvend jep fjalën negative ndaj procesit të privatizimit të “Valës”? Do të kemi situata shumë të ngjashme që ndoshta kompani me renome, ndoshta kompani që janë edhe të shteteve shumë të fuqishme, shtete mike ndaj Kosovës, paraqiten edhe ne të bëjmë lojë me ta. Me fjalë të tjerë t’i kthejmë mbrapsht. Çka do të bëhet me marrëveshjet ndërkombëtare që e ka lidhur Qeveria e Kosovës për sigurimin e investimeve.?

Të nderuar, unë të gjithëve edhe opinionit publik ia them se shprehja e interesit është pjesë procedurale e shitjes së operatorit. Të gjitha fjalët e tjera, miratimi në parim mund të lindin nga njerëzit që janë doktorë të përshpejtuar, sepse nuk ka pasur në Kuvend të sillet edhe të votohet strategjia në parim. Strategjia vetëm një herë votohet. Pra, biem në një situatë kur edhe procesi i shitjes, procesi i tenderimit të PTK-së, mund të ngritën dyshimet e bazuara në të ardhmen, ashtu njësoj siç po ngritën tani dyshimet e bazuara për operatorin e dytë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Rustemi, tani në radhë është zonja Hadri.

TEUTA HADRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kosova sot është shteti më i iri në botë dhe ky shtet duhet të zhvillohet, të ecën përpara për t’i përballuar sfidave të ekzistencës së vet të qenurit shtet. Prandaj, sot nga gjithë ne deputetët kërkohet mençuri, dije më shumë se kurrë për të vepruar dhe ndihmuar në procesin e privatizimit. Duke hyrë në një fazë të re, ku duhen të bëhet privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore për të kokrruar tregjeve ekonomike botërore, të jemi më afër shteteve tjera, edhe unë si ju, të nderuar deputetë, ndiej dhimbje si ju, por dhimbjen time të nderuar deputetë ia lë kohës dhe zhvillimit të shtetit tim ndaj konkurrencës dhe tregut të lirë.

Të kthehemi prapa të shikojmë dhjetëvjetëshin e kaluar, me një ecje dhe zhvillim të vendit tonë, ku jemi tani dhe sa kemi mundur me ecë përpara. Qe 10 vjet, Kosova po përballet me procesin e privatizimit dhe ka ngecur në këtë aspekt. Me ngecjen e privatizimit kanë ngecur edhe shumë zhvillime tjera ekonomike të vendit. Ne sot po shohim krizën globale në botë, rënien dhe shkatërrimin e shumë kompanive të mëdha, bankave të fuqishme botërore, kur kjo ndodh edhe në shtetet më të zhvilluar dhe në zhvillim ekonomik të madh. Po shiten kompani, po shiten banka, prandaj dua të rezistojmë dhe të punojmë që kriza globale të jetë më larg Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ne jemi duke miratuar një numër të madh të ligjeve që kërkojnë buxhet për miratim. Kemi në shqyrtim Ligjin e punës dhe kemi ngritur zërin edhe ne si deputetë për nenin 48, ku përfshihet pushimi i lehonave. Dihet se kostoja e këtij ligji sa kushton dhe sa shtesë duhet të ketë kosto buxhetit të Kosovës për ta miratuar këtë amendament. Kemi pastaj Ligjin e dëshmorëve, veteranëve pjesëtarëve dhe kategorive tjera të Luftës së UÇK-së dhe Ligjin e sigurimeve shëndetësore, atë të pensionistëve, kur dihet çfarë buxheti kërkohet, ku do t’i marrim këto para të buxhetit për të miratuar këto ligje? A do të na pikë nga qielli, sigurisht se jo? Më pëlqen slogani “ec me kohën” prandaj edhe kosovarët duhet të ecim me kohën për të gjetur vendin që i takon në Evropë. Lindja nuk është vetëm e dikujt në këtë Parlament, një individ apo i një grupi parlamentar, por të gjithë ne deputetët që kemi

përgjegjësi të deputetit. Kemi pasur dhimbje edhe më të mëdha, por si popull i kemi tejkaluar, po duhet të jemi në Evropë dhe pjesë e saj, por të ecim jo me varfëri e me gjendje të mjerë, por me dinjitet se kemi pasuri tokësore, kemi pasurinë më të madhe rininë e fuqishme dhe të shkëlqyer që shumëkush po na ka lakmi e që po shkollohen në universitete më të njohura botërore sot. Prandaj, t'ia mundësojmë rinisë besimin, drejtimin, ecjen përpara krahas shteteve të zhvilluara, të menaxhojnë ekonomikisht duke organizuar, menaxhuar edhe projekte më vitale të Kosovës, siç është ky privatizimi i PTK-së. Prandaj, privatizimi i PTK-së, mendoj se do të jetë interes i të gjithë qytetarëve të Kosovës, duke ecur përpara në tregun e lirë e jo me ngecje si 10 vjet deri me sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hadri!
Fjalën e ka zoti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet çështja e privatizimit të PTK-së, sot është bërë sfidë për momentin. Në fakt ka shumë argumente të cilat na bindin se privatizimi duhet të ndodhë, por ka edhe shumë kundër argumente, të cilat në njëfarë forme arsyetojnë mos privatizimin e PTK-së. Ajo çka unë dua ta them, është se në krejt këtë proces duhet ta ndajmë në ato përparësitë që i ka për privatizimin e një kompanie të tillë siç është PTK-ja, dhe dobësitë, gjegjësisht të metat që dalin nga ky proces.

Në mesin e përparësive, ajo çka është më kryesorja është transformimi i pronës publike e cila pronë publike është sot baza kryesore e të gjitha të këqijave mos të them edhe korrupsionit edhe nepotizmit edhe të gjitha formave të keqpërdorimeve që sot ndodhin nga grupet e caktuara të interesit, nga njerëz qoftë në Qeveri, qoftë jashtë Qeverisë, e në mesin e këtyre burimeve të këtyre gjërave të këqija është edhe PTK-ja. Andaj privatizimi i PTK-së është imanente për momentin. Kjo është ndoshta argumenti më qenësor në kuptimin e sjelljes tonë si mjedis kosovar. Ajo çka më arsyeton tjetër që është përparësi e privatizimit, është edhe ikja apo financimi i buxhetit me kapital të freskët, gjë që e pret buxhetin e Kosovës 2011, 2012, apo 2013 e presin ditë të vështira nga aspekti i deficitit buxhetor, duke marrë parasysh se shumë projekte janë të planifikuara të natyrës kapitale, që mundësitë buxhetore për to, në aspektin e të hyrave publike janë shumë të vogla, andaj ne na duhet, në qoftë se dëshirojmë të mendojmë racionalisht, duhet të sigurojmë minimumin për një vit buxhetor për 2011-shin apo 2012-shin duhet të sigurojmë edhe 1 miliardë euro plotësues për buxhetin e Kosovës, në qoftë se dëshirojmë t'i realizojmë këto projekte. Dhe, ajo çka mua më shtyn ndoshta më së tepërmi është edhe si përparësi është edhe keq menaxhimi. Përvoja na ka treguar prej luftës që ka ndodhur deri sot se kjo kompani nuk është menaxhuar si duhet mu për atë transformimi pronësor apo privatizimi, ka kuptimin edhe transformimit menaxheria.

Në mesin e dobësive janë humbja nga pronësia publike e një krijuesit të fitimeve të mëdha që ishte për një periudhë relativisht të gjatë PTK-ja, burim i mirë i të hyrave publike dhe një dobësi tjetër del nga politika sociale, punësimi i një numri të caktuar të punonjësve në PTK, të cilët padyshim nuk do të jenë pjesë e PTK-së, në qoftë se privatizohet. Mirëpo, unë mendoj, duke u nisur nga këto përparësi dhe dobësi duhet të mendojmë pak racionalisht, pa marrë parasysh në çfarë baza politike jemi.

Një, duhet të heqim konceptin nga koka pasuri kombëtare. Kjo është një shprehje shumë populiste, pasuria kombëtare është e të gjithë qytetarëve, a në fakt sikur ekzistojnë sot ndërmarrjet publike nuk janë pasuri kombëtare, janë në fakt pasuri në duar të grupeve apo klaneve të caktuara. Ta heqim një herë e përgjithmonë konceptin e pasurisë kombëtare.

Së dyti, në qoftë se dëshirojmë të mendojmë racionalisht, unë mendoj se duhet t'i themi po privatizimit edhe të PTK-së edhe të gjithë kompanive tjera publike, por për modalitete duhet të sqarohemi më qartë. Kur është fjala te PTK-ja duhet të mendohet qartë, në mënyrë shumë profesionale, në cilën shkallë do të shkojmë kah privatizimi, sa do të ketë përqindje publike, sa do të ketë private, cilat janë efektet pozitive nga ato përqindje, cilat janë sukseset, në cilin vit kalendarik na nevojitet financim më i lartë, në cilin vit më i ulët, kështu që kjo mund të realizohet me një ekspertizë të lartë teknike në kuptimin e vlerësimit të saktë të gjitha modaliteteve? Pra, unë kisha thënë në fund të këtij mocioni të nxjerrim një përfundim, po privatizimit, por për varantet, format, mënyrat duhet të sqarohen, së pari ekspertiza që duhet të kalojë në komisionin përkatës dhe ajo të na vijë këtu dhe në një farë forme Parlamenti i Kosovës apo Kuvendi i Kosovës në fakt të japë pëlqim për modalitetet të caktuara, të cilat do t'i bindim qytetarët e Kosovës dhe ...

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasaniqu

KRYTARI: Hajde, edhe një minutë, profesorit.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit!

Faktikisht, duke u nisur nga kjo qasje racionale, i kishim dhënë fund të gjitha qasjeve shumë emocionale që ishin këtu, disa si patriotë të rremë që po luftojmë për pasurinë kombëtare dhe disa tjerë të cilët në njëfarë forme po manipulojnë opinionin publik bile, bile edhe këtë Kuvend, duke mashtruar me shënime, duke treguar në fakt jo fytyrën e vërtetë të qytetarit, por të një politikani që më tepër është i natyrës së mashtruar. Dhe, u kisha bërë apel të gjithë atyre deputetëve të cilët në një farë forme janë të lidhur me PTK-në, mos të flasin për PTK-n. Konflikti më i madh i interesit qëndron në qoftë se ne jemi, nuk e kam fjalën pse janë ose pse nuk janë aty, por çdo fjali e thënë për institucionin ku punon, merret si konflikt interesi...

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

KRYETARI: Më fal, replikë. Deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXERRI: Mua më vjen shumë keq që, po është e vërtetë që këtu ka deputetë në mandatin e parë dhe ju falet mosdija e tyre, por është prapë e papranueshme deputeti të hyjë në debat e t'i bëjë 3-4 orë dhe mos ta di kuptimin për çka bëhet debati.

Debati sot nuk bëhet për PTK-n, por bëhet për pronën e këtij vendi dhe për Qeverinë e këtij vendi dhe për rolin e Kuvendit. Për këtë bëhet debati sot. Mua më vjen shumë keq që njerëzit nuk e dinë as pse janë këtu, unë nuk ju kam faj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Edhe kjo është në kuadër të demokracisë. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Besoj që nuk është e tepërt për ta përmendur se në këtë debat nuk është asnjë përfaqësues i Qeverisë. Kjo tregon për vetë interesimin që ka Qeveria ose grupi ministror që është i ngarkuar të merret me çështjen e shitjes të PTK-së apo privatizimit.

Më lejoni të them se janë dy-tri arsye të cilat krejt këtë proces e mbështjellin dashur e pa dashur me një vello të dyshimit. E para, vlerësimi 300 deri 600 milionë euro që është bërë nga kompanitë të cilat janë angazhuar për të vlerësuar asetet e PTK-së, jep shumë për të dyshuar se diçka nuk është në rregull, nuk mundet të jetë diferenca 300 milionë euro, pavarësisht që shumë prej nesh e dinë se vlera reale e PTK-së, mund të jetë edhe më e madhe.

E dyta, absolutisht as ne si Kuvend, as qytetarët e Kosovës nuk janë të njoftuar në mënyrë transparente se në bazë të cilave vlerësime, në bazë të cilave fakte është marrë ky vlerësim se asetet e PTK-së, mund të vlerësohen 300 deri 600 milionë euro. Ku është libri i të gjitha pasurive të tundshme dhe të patundshme dhe vlerat e tyre që i posedon PTK-ja. Po pa këto dhe pa e ditur se kah janë marr këto shifra në bazë të cilave fakte, është kjo, ajo që neve na bën për të dyshuar se diçka nuk është në rregull.

Desha të ndalem se shumë deputetë përmendën ligjet për privatizimin, Kushtetutën, ekonominë e tregut. Asnjë ligj nuk ka as Kushtetuta që jep të drejtë ta falim një pasuri ose ta japim nën çmim ose mos të jemi transparent kur vlerësohet. Si është e mundur të jepen vlerësime të tilla pra në diferenca 300 milionë euro?

Tjetër, nuk jemi të informuar se punësimet e qindra punëtorëve në dy vjetët e fundit pa kurrfarë kriteri, sa ka ndikuar në uljen e vlerës së PTK-së, a mundet dikush të kërkojë nga bordi i PTK-së, komplet regjistrin e të gjithë të punësuarve, kur janë punësuar, prej nga janë, në cilin vit janë punësuar, çfarë përgatitje profesionale kanë dhe ku është vendi i tyre i punës? Janë qindra punëtorë të punësuar që janë pa vende pune dhe fare, dhe vetëm sillen dhe marrin paga. Sa ka ndikuar kjo në uljen e vlerës së PTK-së dhe, tjetra, i sugjeroj Qeverisë që të përpiqet dhe grupi ndërministror, që merret, është i ngarkuar të merret me procesin e privatizimit të PTK-së, t'i bëjë transparente të gjitha këto vlerësime, pasurinë e patundshme dhe të tundshme të PTK-së, vlerën e tyre dhe të mundohet të marrë shumicën absolute të votave në Kuvend.

U tha dhe po e përsëris, nuk mund të jetë serioz privatizimi i PTK-së me 42 vota të këtij Kuvendi, me 1/3 e deputetëve. Këtu duhet ta ketë fuqishëm mbështetjen, mbështetja merret kur procesi është transparent, kur procesi është i tillë që nuk jep për të dyshuar se këtu bëhen lojëra e makinacione. 300 milionëshi, 300 deri 600 milionë jep shumë për të dyshuar se mund të bëhen marrëveshje edhe jashtë Kosovës dhe mund të merren...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Sot është Dita Ndërkombëtare e Demokracisë dhe besoj se do të duhej të jepni një shembull të mirë të demokracisë, nëse jo për neve, së paku për këta të rinj që sot po na përcjellin në punën tonë.

Çdo shtet i cili ka një demokraci të zhvilluar, madje edhe vetëm të proklamuar, kuvendi si organ përfaqësues është vendi ku debatohen shumë çështje, sidomos ato që kanë rëndësi jetike për qytetarët e atij vendi.

Edhe pse kësaj çështjeje tashmë i dihet përfundimi dhe fjala jonë nuk do të ndryshojë asgjë, megjithatë për shkak të rëndësisë që ka privatizimi i këtij aseti, do të shpreh qëndrimin tim.

Shteti i Kosovës është në përfundim të procesit të privatizimit. Me qindra ndërmarrje që ishin në pronësi shoqërore gjatë këtij viti, gjatë këtij procesi, kanë kaluar në pronësi private. Me këtë rast janë mbledhur rreth gjysmë miliardi euro, që janë shumë më pak se sa janë shitur dhe po shiten asetet e vendeve të rajonit, të cilat po përfitojnë miliarda euro nga ky proces. Por, ky proces i cili në vazhdimësi është kritikuar se është i korruptuar, sikurse nga opozita e dikurshme, ashtu edhe nga kjo e sotmja, kjo nuk është e keqja më e madhe. Nuk është sepse mjetet e grumbulluara nga ky proces kanë ngelur të bllokuara për shkak të mungesës së legjislacionit konkret me të cilin do të rregullohej shfrytëzimi i tyre dhe paqartësive të tjera pronësore.

Pavarësisht kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës po vazhdon me privatizimin e aseteve të fundit që i kanë mbetur shtetit të Kosovës. Madje këtë po e bën me një nguti të pashpjegueshme.

Parimisht, nuk jam kundër privatizimit, por privatizimi në këtë fazë dhe në këtë formë është plotësisht i gabueshëm, prandaj nuk do të duhej ta gëzojë mbështetjen. Jemi kundër formës, metodës dhe kohën në të cilën po bëhet ky privatizim. Një ndërmarrje publike kaq profitabile dhe kaq e rëndësishme për ekonominë e vendit, siç është Posta dhe Telekomit i Kosovës nuk mund të privatizohet pa u bërë së pari një analizë se cilat janë përfitimet më të mëdha për ekonominë kosovare, privatizimi apo mos privatizimi i saj në këtë kohë. Jo domosdoshmërisht çdo aset i këtij vendi duhet të privatizohet për të hequr dorë nga e kaluara e ekonomisë centraliste dhe e prapambetur apo për të luftuar korrupsionin sikur para disa ditësh, deklaroi kryeministri, sepse ka shumë shtete që edhe përkundër faktit që kanë dal nga sistemi i pronës shoqërore, megjithëse sektorë të caktuar që janë vlerësuar të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të tyre, vazhdojnë t'i mbajnë në pronësi publike. Kjo nuk nënkupton se ata kanë ekonomi centraliste, përkundrazi, kanë ekonomi shumë të zhvilluar të bazuar në tregun e lirë.

Sikur e thashë, privatizimi i PTK-së nuk do të duhej të bëhet pa u bërë së pari një vlerësim i saktë i aseteve të saj. As ne sot e aq më pak qytetarët e Kosovës nuk e dinë se cila është vlera e saktë e PTK-së, sepse asnjëherë nuk është bërë një vlerësim profesional i aseteve të saj.

Para disa ditësh kemi pasur një deklaratë se pasuria e PTK-së vlerësohet nga 300 deri në 600 milionë euro, çka nuk e besoj se do të duhej të kishte kaq hapësirë të madhe nga 300 e 600, por për këtë ndoshta ministri do të japë një përgjigje.

Janë edhe dy faktorë tjerë të cilët mendoj se mund të ndikojnë shumë në çmimin e këtij aseti nëse privatizohet në këtë kohë. I pari është kriza globale, e cila, edhe nëse jepen vlerësime se ka kaluar, shumica e kompanive ende nuk janë këndellur nga humbjet që i kanë pësuar si rezultat i saj. Dhe, nëse shfaqin interesim për blerjen e aseteve të PTK-së çmimi që mund të ofrojnë mund të jetë shumë më i ulët.

Dhe, së dyti, faktori i dytë, por jo më pak i rëndësishëm në këtë mes, është edhe hetimi dhe bastisja e kësaj kompanie nga zyrtarët e EULEX-it, e shoqëruar me një fushatë të madhe mediave, gjë e cila, sigurisht se ndikon në uljen e vlerës së saj.

Krejt në fund, edhe pse dyshoj se nga ky debat do të ndryshojë diçka për të ardhmen e këtij aseti kaq të rëndësishëm për ekonominë kosovare, shpresoj se vendimet e Qeverisë të mos merren vetëm me votat e pozitës sikurse ndodhi para disa ditësh por së paku kësaj herë të dëgjohen edhe qëndrimet e opozitës, sepse po aq sa ju edhe ne jemi të interesuar për këtë aset. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë nuk do të doja të përsëris shumë çka u tha deri tash, edhe për shkak të kohës së limituar, prandaj ajo që duhet theksuar që në fillim është se privatizimi i drejtuar nga ndërkombëtarët në Kosovë këto vite ka çuar në humbjen e vendeve të punës, mosfunksionimin e fabrikave, dështimin ekonomik të vendit, izolimin e fondeve të privatizimit nga ekonomia duke e lënë shoqërinë pa sigurime shoqërore dhe natyrisht me pak mundësi për fuqizim politik ose ekonomik dhe krejt kjo është arritur duke u liru nga përgjegjësia nga këto rezultate rrënuese për vendin tonë.

Fatkeqësisht, pavarësisht këtyre dështimeve, sot Qeveria e Kosovës pa rezervë, po edhe zyrtarët ndërkombëtarë, nuk po heqin dorë nga thirrjet për privatizim të shpejtë dhe total, duke këmbëngulur se ekonomia e Kosovës ka nevojë të çlirohet nga shteti për ta luftuar korrupsionin, për të siguruar investime të huaja si dhe për t'u integruar në Bashkësinë Evropiane.

Natyrisht tani, me të qenit shtet, vendimet dhe përgjegjësinë për privatizimin e ndërmarrjeve publike po e merr Qeveria e vendit, edhe pse ky proces do t'i prekë interesat e çdo qytetari, ajo nuk po tregohet e aftë të dëgjojë zërin e qytetarit, shoqërisë civile e profesionistëve që të mos të hyjë në një privatizim pa kokë. Arsyetimet që po jepen, pa dyshim, nuk janë të qëndrueshme fare.

Përse po kryhet privatizimi me kaq pa durim, me shpejtësi pa asnjë diskutim të qasjes ekonomike alternative, zoti ministër?

Përse procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike, duke pasur parasysh dështimin e plotë të atyre shoqërore, s'po vihet asnjëherë në dyshim, zoti ministër?

Dhe, përse asnjëherë nuk është marrë asnjë vlerësim gjithëpërfshirës ndaj privatizimit në vendin tonë nga Qeveria, zoti ministër?

Gjithashtu, arsyetimi se privatizimi ndihmon luftën kundër korrupsionit, është më se paradoksale, deputetë të nderuar, nga se akuzat në rritje për korrupsion lidhen mu me procesin e privatizimit.

Kështu, zoti ministër, kur po përmendet privatizimi i Postë-Telekomit, po lindin mosbindje, shqetësime, dyshime dhe paqartësi të mëdha se si do të ecën procesi, sa do të jetë ashtu i pa kokë, siç ishte ai i ndërmarrjeve shoqërore.

Megjithatë, ne të gjithë sot e dimë se privatizimi do e merr rrugën e vet dhe është proces iversibil, por ajo që është shqetësuese për qytetarët e Kosovës janë rrethanat, kushtet dhe koha kur po synohet të realizohet ky privatizim. PTK-ja nuk është në gjendje të mirë nga se tash e një kohë të gjatë keqmenaxhohet. Kjo ndërmarrje publike qëllimisht është futur në marrëveshje të dëmshme me qëllim që t'i humbë vlera e saj.

Shtrohet pyetje, nëse kjo Qeveri e ka sjell Postë-Telekomin në këtë situatë, si mundemi ne të njëjtës Qeveri me ia besuar privatizimin?

Pastaj, është naivitet me lejuar privatizimin e Postë-Telekomit kur Ministria që menaxhon PTK-në hetohet për keqpërdorim të detyrës. Nëse është shqyrtuar..., nuk shqyrtuar asnjëherë mundësia që çështja e menaxhimit apo keqmenaxhimit në PTK të zgjidhet me alternativa tjera. Shqetësim tjetër mbetet edhe mënyra e përdorimit dhe dedikimi i fondeve të grumbulluara nga privatizimi.

Çështje tjetër është se gjatë privatizimit nuk është bërë ndarja në mes Telekomit dhe Postës, që kërkon kohë të bëhet në mënyrë rregullative. Nga përvojat e shumë vendeve, postat dhe shërbimet postare nuk janë profitabile. Në bazë të strategjisë, të hyrat e postës së përgjithshme janë 1.5% kurse 17.5% të punësuarve dhe kjo mund të jetë mundësi që Posta të mbetet barrë për buxhetin e Kosovës në të ardhmen.

Për në fund, jo transparenca dhe bisedimet prapa dyerve të mbyllura, që po e karakterizojnë shumë projekte të mëdha, si “Kosova e re”, ndërtimi i autostradës Vërmicë – Merdar, tani i devijuar, koncensionimi i Aeroportit kanë krijuar dyshimin e madh në shoqëri se asnjë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, nuk është këtu! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, nuk është. Regjia, ia mundësoni të marrë fjalën deputeti Ismajl Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë diskutimin tim do ta bazoj në një vlerësim të një instituti, besoj, të pavarur për të mos rënë nën ndikimin e atyre që janë pro ose të atyre që janë kundër privatizimit.

Në Raportin e Institutit Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare, i angazhuar në projektin ndërkombëtar 1999-2008 për privatizimin në Kosovë, thuhet, ndër të tjera: Privatizimi nuk është bërë për të mirën e ekonomisë së Kosovës. Është një konstatim i përgjithshëm, dhe mandej vazhdon: Pas 9 vjet të privatizimit, të udhëhequr nga ndërkombëtarët, ekonomia nuk duket të jetë përmirësuar, gati gjysma e vendit vazhdon të jetë e pa punë, gjysma vazhdon të jetë në varfëri, infrastruktura, bujqësia dhe prodhimet vendore janë në gjendje shumë të vështirë, ndërkohë që arsimi dhe mbrojtja sociale mbesin shumë të dobëta.

Në të njëjtin raport, thuhet se 451 milionë euro mbahen peng dhe nuk mund të shfrytëzohen për shkak se ato mund të shkojnë te kreditorët dhe pronarët që kryesisht gjenden në Serbi.

Bazuar në këtë raport, thuhet se privatizimi i ka larguar nga puna mbi 70.000 punëtorë në Kosovë.

Pra, bazuar në përvojën e gjertanishme të privatizimit, del se efektet e privatizimit janë në s’përputhje të plotë me pritjet nga privatizimi. Është pritur rritje e prodhimit në vend dhe ka ndodhur e kundërta. Është pritur rritje e investimeve në vend dhe ka ndodhur e kundërta. Është pritur rritje e numrit të të punësuarve dhe ka ndodhur e kundërta. Është pritur rritje e të hyrave në buxhetin e shtetit nga privatizimi dhe as kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, privatizimi mendoj se duhet të ndërpritet deri sa të krijohen kushte të favorshme që privatizimi të bëhet për të mirën e ekonomisë së këtij vendi.

PTK-ja nuk duhet të privatizohet për arsye se është resurs i rëndësishëm strategjik për vendin. Me privatizimin e PTK-së pamundësohet kontrolli mbi fushën e telekomunikacionit, që është një fushë shumë e rëndësishme dhe strategjike. Me privatizimin e PTK-së investimet orientohen kah nevojat e kapitalit privat dhe jo kah nevojat e qytetarëve të Kosovës. Privatizimi i PTK-së do të thotë monopolizim i tregut, kurse telekomunikacioni është një lloj monopoli i natyrshëm i shtetit dhe jo i

pronarëve privatë. Privatizimi i PTK-së nënkupton edhe kontrollin privat mbi të gjitha bisedat telefonike në vend. Dhe natyrisht, me privatizimin e PTK-së, numri i të papunëve në këtë vend gjithashtu vetëm sa do të rritet. Privatizimi i PTK-së pa e pas të rregulluar infrastrukturën ligjore, që do të siguronte konkurrencën e mirëfilltë ekonomike, paraqet parandalim të përpjekjeve të rregullimit ligjor sipas vullnetit, interesit dhe nevojave tona si qytetarë të Kosovës. Privatizimi i PTK-së në këtë moment kur bota ndodhet në krizë financiare nënkupton shitjen e lirë të këtij resursi shumë të rëndësishëm të vendit. Privatizimi i PTK-së është privatizim i një profiti të madh vjetor që në arkën e shtetit sjell të ardhura të mëdha. Vetëm në periudhën 2006-2009 PTK ka gjeneruar profit neto prej 178 milionë euro dhe besoj se me një menaxhim më të mirë të hyrat do të ishin shumë më të mëdha. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Po debatojmë për një çështje mjaft të rëndësishme dhe më befaso! Fakti që sot në Kuvend dikujt nuk po i intereson baza ligjore dhe ishte shumë e parëndësishme baza ligjore që e kanë kërkuar shumë me ngulm këtë bazë ligjore për privatizim, por sot u përqendruan te vullneti politik. Dhe nëse do të matemi me vullnetin politik, atëherë vullneti politik ka ekzistuar për privatizim. Ekziston edhe sot. Nuk ka filluar me këtë Qeveri. Nuk ka filluar as kur Kosova ka qenë shtet dhe kemi privatizuar shumëçka edhe më të dhembshme se PTK-në.

Çka dhe si duhet të veprojmë? Aktualisht, po e shohim, të gjithë po pajtohem se nuk ka menaxhim çfarë i duhet Kosovës në PTK. Kjo është çështje që po shihet. Edhe punësimet po ndodhin, kanë ndodhur për dhjetë vite e më shumë dhe nuk e dimë kush dhe me çfarë kriterë janë punësuar, nuk e dimë sa kanë qenë pagat dhe si i kanë ndarë. Posta s'ka filluar me funksionuar para 2-3 viteve por funksionon prej pas luftës e deri më tash. Ka pasur ndërhyrje të operatorëve ilegalë, edhe sot ka ndërhyrje. Ka pasur edhe humbje të tjera, të cilat ne nuk dimë dhe meqë jemi përcaktuar të kemi ekonomi të tregut të lirë, jemi përcaktuar që mos të kemi pikërisht monopolizim, siç diskutoi një kolegë përpara, unë konsideroj që duhet t'i hymë rrugës, rrugës ku duhet të fillojnë procedurat e privatizimit.

Unë e di që do të jetë vështirë për shumë njerëz të cilët aktualisht punojnë, por besoj se edhe ne si Kuvend, edhe Qeveria, edhe Grupi ndërmintoror duhet të krijojnë kushte apo të kërkojnë kushte që të ruhen ata njerëz në punë, të kërkojnë përfitimet të cilat duhet t'i ketë Kosova dhe qytetarët e saj dhe natyrisht të mos humbim shumë kohë.

Nëse dikush mendon që Posta dhe asetet t'i ruajë Qeveria mbi 50%, nuk e di a do të kishte interes dikush, i cili jep shumë para e nuk mund të menaxhojë me PTK-në e me hy në këtë privatizim.

Dhe, krejt në fund, konsideroj se ne e kemi aprovuar një strategji. Do të presim rekomandimet përfundimtare dhe ato rekomandime janë pikërisht nga deputetët, nga njerëzit, nga ekspertët të cilët i kanë dhënë dhe natyrisht interes më i madh është që të vendoset proces i rregullt në këtë ndërmarrje publike se sa të shkohet kështu siç jemi duke vepruar tash.

Unë konsideroj se kurrëgjë nuk është duke shkuar në rregull atje. Ka keqmenaxhime, ka keqpërdorime. Ka pasur prej fillimit dhe deri tash nuk janë ndalë, prandaj konsideroj se do të votoj, me rekomandimet që janë bërë për strategjinë, që kjo ndërmarrje publike të privatizohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina. Regjia, fjalën deputetit Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Diskutimi, të cilin po e bëjmë sot, mendoj që nuk ka për qëllim të votojmë për ose kundër privatizimit të PTK-së, por thjeshtë të ofrojmë modele, këshilla ose opsione se si të jetë vërtet sa më i suksesshëm dhe sa më transparent. Ne në korrik e kemi miratuar në parim strategjinë, e cila sigurisht se duhet të rishqyrtohet nga Qeveria, pastaj të sillet në komision dhe me rekomandime t'i ofrohet Parlamentit për ta miratuar.

Këtu, duke pasur parasysh edhe strategjinë të cilën e kemi miratuar, parashihet që Posta të mos jetë pjesë e privatizimit dhe atëherë këtu nuk bëhet fjalë për privatizimin e PTK-së, por mendoj se bëhet fjalë për privatizimin e Telekomit, përfshirë Valën dhe pjesët e saj, siç janë Dardaneti dhe Telefonja mobile.

Meqenëse u cek edhe vlera, të cilën e kemi dëgjuar edhe në media dhe sigurisht edhe ministri e ka cekur disa herë, është një vlerë rreth 600 milionë euro, ajo nënkupton se asetet të cilat kanë ekzistuar të Postës nuk do të jenë pjesë e privatizimit, gjë që mund të jetë edhe reale. Por, mendoj se për të ardhur deri te një vendim i tillë, sigurisht se ekspertët dhe ne deputetët, bashkërisht, do të nxjerrim një kriter ose një formulë e cila do të jetë vërtet e pranueshme. Nuk bëhet fjalë a duhet a s'duhet me u privatizuar.

Mendimi im është që privatizimi është i domosdoshëm, sepse tani nuk jemi në kohën e një ekonomie centraliste por të një ekonomie të lirë dhe në kuadër të kësaj, duke dëgjuar deputetët, qoftë të pozitës qoftë të opozitës, qytetarët do të bien në dilema: Vërtet, nëse privatizohet, çka po ndodhka me Kosovën dhe nëse s'privatizohet a vërtet duhet me ngel me një ekonomi çfarë e kemi pasur deri më tani?

Unë mendoj që këtë duhet shtjelluar pak më qartë dhe mos të lëmë dilema tek qytetarët, sepse vërtet interesi ynë është që të ecim përpara me ekonomi të zhvilluar drejt Bashkimit Evropian.

Ajo që dua të theksoj, është: të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe një strategji se si duhet të bëhet privatizimi. Konsideroj që Qeveria tani e ka një detyrë përpara se me marrë vendim për privatizimin – sigurimin e kodit shtetëror. Tashmë, edhe në Asamblenë e Përgjithshme ne, në njëfarë mënyre, kemi fituar një mbështetje shumë të madhe dhe ndoshta shumë shpejt do të jemi edhe anëtare e OKB-së, ka mundësi që ta sigurojë kodin. Sigurimi i kodit të Telefonisë mobile, nëse Qeveria do të angazhohet vërtet ashtu si duhet, ka mundësi brenda këtij viti të bëhet dhe vlera e Telekomit do të rritej me siguri shumë më tepër. Besoj se këtë Qeveria e ka parasysh.

Unë rri prapë pranë mendimit që e kam dhënë edhe në debat rreth strategjisë. Nuk është mirë të privatizohet më shumë se 51%. 51% ia jep komoditetin kompanisë e cila do ta privatizojë, që të jetë menaxheri kryesor i kompanisë që blen.

Unë jam për privatizimin, por natyrisht duke analizuar dhe duke nxjerrë një konkluzë shumë të qartë, bashkërisht, në mënyrë që të mos lëmë dilema tek qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Debati i iniciuar nga kolegët tanë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë lidhur me procesin e privatizimit të PTK-së, për mendimin tim, është një vazhdimësi apo një riciklim i debatit të seancës së 27 korrikut dhe që do të vazhdohet prapë në një seancë të ardhshme brenda harkut kohor prej një muaj e gjysmë, apo dy muaj.

E thash këtë për t'iu përgjigjur disa kolegëve tanë deputetë, të cilët po thonë: nuk ka transparencë, nuk po ndiqen procedurat. Dalin dhe flasin domethënë me një iracionalitet, mbase edhe të paparë dhe synojnë të shkojnë në ekonomi të tregut me mendime apo me insistime që të rrimë në një ekonomi të centralizuar.

Të nderuar deputetë, ekonomia jonë duhet t'i adaptohet rrjedhave globale. Them, ekonomia jonë nuk është në këtë formë kompotitive. Është i domosdoshëm dhe të gjitha grupet parlamentare janë deklaruar se ne do të duhej të shkojmë drejt privatizimit përfshirë edhe privatizimin e ndërmarrjeve publike. Dhe tash, edhe pse ka një varg analizash që janë bërë, edhe pse ato analiza prezantohen para Kuvendit, para opinionit të gjerë publik, bëhemi të shurdhër.

Unë nuk do të hyj... Po ne nuk mund t'i bëjmë 120 analiza për 120 deputetë, domethënë. Përfaqësuesi i Qeverisë, zoti ministër Ahmet Shala, foli në emër të Grupit ndërministror. Domethënë janë disa ministra të cilët kanë punuar përfshirë edhe kompani konsulente, përfshirë edhe ekspertë vendorë dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe tani bëhemi të shurdhur apo përpiqemi që të manipulojmë, jo me Kuvendin, por me opinionin publik më shumë, se nuk ka analiza paraprake.

Për ta ilustruar këtë, unë vetëm shtroj një, si pyetje: Sikur Posta, PTK-ja, apo pjesa e PTK-së apo një numër i aksioneve të PTK-së të ishin shitur në vitin 2007, sigurisht se do të ishin shitur me një çmim më të lartë se sa sot. Por, dua të them që unë e shoh shumë të qartë dhe shumë të qëndrueshëm konstatimin e ekspertëve të cilët thonë se PTK-së është duke i rënë vlera, sepse nuk po mund t'i përballojë konkurrencën në regjion dhe nuk do të mund t'i përballojë. Prandaj, ose futja e një operatori të tretë të funksionimit në vendin tonë, nesër ndoshta do t'i lusim operatorit që PTK-në t'ia japim falë dhe nuk do ta marrin.

Prandaj, duhet të jemi racionalë, ne si deputetë dhe të flasim e të mbështesim iniciativat që janë të qëndrueshme, të drejta dhe që i kërkon koha, por jo të jemi hysterikë dhe të përpiqemi dhe të përpiqemi t'ia lëmë kile dikujt, ta stigmatizojmë dikë, ta denigrojmë qoftë institucionin e Qeverisë, qoftë institucionin e Kuvendit, sepse del një kolegë yni deputet pa fije turpi dhe thotë: nuk kanë kredibilitet që të bëhet privatizimi, qoftë ky institucion ose qoftë iks apo ipsilon individi, kurse tjetri thotë: nuk ka autoritet Kuvendi që të merr vendim për këtë punë, e në anën tjetër një tjetër thotë: ju lutem do të duhet të marrim vendim. Prandaj, kërkoj që të jemi racionalë, të jemi të arsyeshëm dhe të mendojmë racionalisht për interesin e këtij vendi dhe të qytetarëve të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Demokraci është edhe të kemi durim, të dëgjojmë mendimin e kundërt! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk ka dilemë se nuk jemi kundër procesit të privatizimit në vendin tonë dhe as kundër ekonomisë së tregut. Këtë e kemi dëshmuar deri më tani në këtë periudhën njëmbëdhjetë vjeçare, periudhën e pasluftës. Prandaj, nuk jemi as kundër privatizimit të PTK-së. Mirëpo, a duhet të ndodhë privatizimi me çdo kusht dhe pa bërë ndonjë analizë të mirë dhe a është dëmi apo përfitimi më i madh nga ky privatizim?

Lidhur me këtë çështje unë do t'i paraqes disa argumente, të cilat janë për dhe kundër privatizimit.

Do të filloj së pari me argumentet që kanë të bëjnë me atë se a po arsyetohet procesi i privatizimit të PTK-së. Ndër arsyet e para, pse duhet PTK-ja të privatizohet është keqmenaxhimi, që konsiderohet pra ndër faktorët kryesorë të cilët e shtysin ose e paraqesin nevojën e privatizimit të PTK-së. Ndërsa, keqmenaxhimi në PTK lidhet me mosrealizimin e projekteve kapitale, sikur që është projekti në fijet optike, për shkak të mos implementimit të cilit është lëshuar mundësia e realizimit të përfitimeve më të mëdha nga ky projekt. Element tjetër, që konsiderohet si keqmenaxhim, është projekti i Z-mobile i cili i ka kushtuar shumë në pikëpamje financiare PTK-së, kur dihet se Z-mobile ka pjesëmarrje të madhe të fitimit nga të ardhurat, kurse Vala merr vetëm një përqindje të vogël dhe raporti është 75 me 25%, nga ai profit, që do të thotë se nga aspekti ekonomik Vala dëmtohet shumë, qoftë në pikëpamje të konkurrencës apo të shfrytëzimit të infrastrukturës së teknologjisë apo qoftë me të ardhura më të vogla.

Fusha e telekomunikacionit është një fushë që kërkon investime të vazhdueshme, gjë që mund të sigurohet me anë të privatizimit. Domethënë edhe këtu parashihet nevoja për privatizim. PTK-ja një kohë të gjatë ka qenë monopol në tregun tonë, mirëpo niveli i shërbimeve dhe kostoja e tyre nuk ishin në favor të qytetarëve dhe futja e konkurrencës ndikoi edhe në uljen e kostos dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Prandaj, privatizimi i PTK-së do të duhej të sjellë efikasitet më të madh në këtë kompani. Të gjitha këto janë faktorë që flasin për nevojën e privatizimit të PTK-së. Por, a është momenti për ta bërë këtë? Apo, pse nuk duhet të privatizohet PTK-ja, ose çka duhet të kemi parasysh gjatë privatizimit të PTK-së në mënyrë që të rritet vlera e saj gjatë procesit të privatizimit. Tash do t'i paraqes disa argumente lidhur me këtë.

Duhet cekur se PTK-ja, me forcat vetjake ka arritur që nga një ndërmarrje e shkatërruar gjatë luftës së fundit ta kthejë atë në një ndërmarrje publike të suksesshme në Kosovë dhe të jetë profitabile, që ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në buxhetin e Kosovës. Vetëm gjatë periudhës korrik 2009 – janar 2010 është shënuar rritje e numrit të konsumatorëve të Telefonisë mobile për 23%. Po ashtu është shënuar rritje e shërbimeve të ofruara teknologjike me mbi 40%, zbritje të çmimeve të shërbimeve për 50%. Këto të dhëna tregojnë se PTK-ja është e gatshme të zhvillojë garën në treg.

Në vitin 2008 është vlerësuar se asetet e PTK-së janë vlerësuar me mbi 1 miliardë euro, ndërsa tani vlera e tyre konsiderohet diku rreth 300 deri 600 milionë. Parashtrahet pyetja: si ndodhi një zhvlerësim kaq i madh i këtyre asteteve? Kompania konsulente Telco AG parasheh shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së, ndërsa 25% t'i mbetin Qeverisë. Por, Qeverisë i mbetet Posta, e cila edhe më shumë do të ngarkojë buxhetin e Kosovës sepse Posta edhe me numrin aktual të punëtorëve krijon vetëm humbje. Pra, nuk është e aftë ta mbajë veten....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve!

Privatizimi është një obligim për ne, është edhe standard i cili na paraqitet si kusht për inkudrimin në këto procese integruuese euro-atlantike. Ne jemi për privatizim, kuptohet dhe e pranojmë këtë sugjerim ose këtë kusht që edhe ne ta privatizojmë ekonominë tonë këtu. Mirëpo, në këtë situatë, ne nuk mund të imitojmë shtetet që janë disa shekuj shtet. Jemi në krijim të shtetit, në fazën e krijimit, të konsolidimit të tij. Prandaj, nuk mund të bëjmë gara me privatizimin tonë me shtetet e Evropës ose të Amerikës. Madje, edhe në Amerikë, siç u tha një herë këtu në Kuvend, shteti i ka ndërmarrjet më të mëdha në duar të veta ende. Këtu u përmendën disa ndërmarrje, më duket ju kujtohet se kush?

Prandaj, ne duhet ta shesim atë që mund ta shesim e mos të shesim atë që të mbesim pastaj si peshku në zallë, pa asgjë. E tillë është edhe tregtia ose shtija e Postë-Telekomit të Kosovës, i cili është burimi më i madh i mjeteve financiare për buxhetin e Kosovës. Këtu Kosova mund ta ketë ndoshta një fitim momental, por për pak kohë ai fitim do të zhduket, do të shpenzohen ato të holla dhe ne do të mbesim duarthatë, pa një ndërmarrje shumë të madhe dhe shumë profitabile.

Më duket se këtu u diskutua, ose jo më duket, por jam i bindur se argumentet që i thanë këtu deputetët e opozitës, janë shumë të fuqishme, shumë të arsyeshme, prandaj edhe nuk duhet të hedhim, mos të them, në shportë atje veç pse janë të opozitës. Çdo gjë që është në interesin e Kosovës, duhet të jetë e përkrahur prej opozitës dhe prej pozitës. Mirëpo, kështu nuk po ndodhë! Gjithmonë po këqyret se si përfitoi ky krah ose ai krah, ose ai krah tjetër. Madje, edhe interesi personal ose partiak po vjen këtu në shprehje shpeshherë. Çdo gjë duhet të matim me peshën e interesit kombëtar, mos të them kombëtar, se këtë dikush po thotë se është folklorizëm, por shtetëror. Kështu që çdo gjë që nuk është në interesin shtetëror, duhet të hedhet në shportën e mbeturinave. Këtu, në qoftë se dikush e sheh interesin e vet personal ose partiak, ai me këmbëngulje edhe ajo që është kundër shtetit e përkrah, le të kalojë sepse ka dikush përfitim prej tyre. Duhet të jemi para se gjithash njerëz, e pastaj duhet ta këqyrim, me gjithë fuqitë tona që i kemi momentale, edhe interesin e shtetit. Ne këtu populli nuk na ka zgjedhur që t'i mbrojmë interesat vetjake ose partiake. Nuk jemi këtu deputetë të partisë ose të vetvetes. Jemi deputetë të popullit dhe ne duhet ta dëgjojmë edhe zërin e popullit.

Këtu u tha se në qoftë se bëhet një referendum për shitjen ose mos shitjen e PTK-së, shumica dërmuese e popullit të Kosovës do të jetë kundër kësaj shtije, bashkë me opozitën që sot u përcaktua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj, që në fillim, përsëri t'ju falënderoj për të gjitha këto debate që janë në shërbim të zhvillimit, të mendimit të lirë, të shprehjes së lirë.

Pas miratimit në parim të Strategjisë për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, Qeveria e Kosovës, përmes Komisionit qeveritar për privatizimin e PTK-së ka inkorporuar të gjitha komentet, sugjerimet, do të inkorporohen edhe mendimet që i shërbejnë privatizimit nga diskutimi i sotëm, do të thotë të mendimeve tuaja, për strategjinë përfundimtare për privatizimin e PTK-së.

Kam qenë shumë i vetëdijshëm që nga fillimi se projektet të cilët ndërlidhen drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik të vendit, projekte të cilat janë dhe që po ndodhin për herë të parë në Republikën e Kosovës, do të përcillen me ide dhe debate interesante për çka edhe ju kam ftuar dhe mendoj se i kam kontribuar kësaj klime të hapjes së debatit jo vetëm me Parlamentin e Kosovës por edhe me shoqërinë civile, edhe me mediat, edhe me qytetarët, me opinionbërësit dhe me të gjithë njerëzit të cilët kanë dëshiruar dhe kanë mundësi për të kontribuar në këtë proces.

Këtë vit, Qeveria e Kosovës ka marrë vendime të rëndësishme për projekte të rëndësishme zhvillimore, për krijimin e vendeve të reja të punës, por edhe për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. E di se ndoshta për ndokënd ndonjëherë është dukur i pa imagjinueshëm fillimi i projekteve të cilët kanë filluar dhe po shihet puna kudo, anekënd Republikës së Kosovës. Ka pasur hezitime e dilema edhe për atë a do të fillojë, apo janë vetëm fjalë të thata, sa i përket projektit të ëndrrave të qytetarëve të Kosovës, autostrada Vërmicë-Prizren-Prishtinë-Merdar. Por, sot, është shndërruar në një kantier ndërtimi gjithë ajo zonë, nga Vërmica deri përtej Prizrenit, pastaj në drejtim të Therandës e më tutje. Dhe pikërisht ky projekt po ka sukses të plotë sepse ka pasur dhe ka ndodhur një proces plotësisht i ligjshëm, transparent, i përgjegjshëm dhe e kemi siguruar, e kemi krijuar një klimë atraktive të besimit për investitorët ndërkombëtarë, për konzorciumet ndërkombëtare, kompanitë ndërkombëtare prej më të fuqishmëve në botë për të ardhur dhe për të investuar, të punuar, e për të pasur sukses në Kosovë. Dhe kjo ka ndodhur me autostradën dhe sjelljen e konzorciumit Behtel&Enka që është duke bërë një punë të mrekullueshme.

Dëshiroj të ju siguroj dhe garantoj se i gjithë ai projekt do të vazhdojë së punuari dhe ky projekt nuk do të ndalet për asnjë ditë së punuari sepse mjetet janë të siguruara pikërisht nga qeverisja e mirë, e përgjegjshme dhe transparente.

Në anën tjetër, kemi pasur projektin e Aeroportit, një projekt ky i cili e di se është përcjell gjithashtu me diskutime dhe i kam inkurajuar ato diskutime, por ka ndodhur një mrekulli e transparencës së paparë në rajonin tonë me rastin e konsensionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Dhe tash, në fakt, nga një barakë që a e ka lënë sistemi i kaluar do të jetë prej aeroporteve më moderne në rajon, me të cilin do të ndihen mirë dhe krenarë çdo qytetar i Kosovës e aty do të investohen rreth 100 milionë euro, të nderuar.

Dalim te privatizimi i PTK-së. Dëshiroj të theksoj se është fare lehtë të jepen apo vetëm të diskutohet pa pasur ndonjë përgjegjësi por po ritheksoj edhe sot para jush, të nderuar deputetë, para qytetarëve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë, por para se gjithash para jush dhe qytetarëve të Kosovës sepse ne jemi sovranë dhe vendimet për asetet tona, për të ardhmen e vendit tonë, i marrim ne dhe duhet të mësohemi të funksionojmë si shtet i pavarur, kështu që programi i Qeverisë që e udhëheq unë është program i djathtë, është program të cilin e kam prezantuar para qytetarit dhe e kanë besuar qytetarët dhe është një koordinim, një harmonizim i plotë i koalicionit të cilin e kemi, por në këtë drejtim dëshiroj të theksoj se disa ide, të ju them shumë hapur, janë shqetësuese për opinionin kur dëgjohen, por janë shqetësuese edhe për të ardhmen e vendit tonë. Jo që mund të ngadhënjëjnë ndonjëherë, por pse ende ka mbetur një mentalitet i tillë. Pra, kemi një ballafaqim të koncepteve dhe ideve të shkollës së vjetër, të mentalitetit të vjetër dhe ideve për të ardhmen. Kemi një ballafaqim në mes shkollës së vetëqeverisjes socialiste dhe planeve pesëvjeçare dhe ekonomisë së lirë të tregut të cilin e prezantoj. Kemi një ballafaqim në mes ideve, koncepteve centraliste e monopoliste dhe sistemit monist, do të thotë, me ekonominë e lirë të tregut. Gjithashtu kemi një ndeshje në mes konceptit monopolist dhe të konkurrencës së lirë, të botës së lirë, të kombeve të lira, të botës moderne. Por, në të njëjtën kohë kemi edhe konceptin... apo përpjekjet tona maksimalit për largimin e politikës dhe qeverisë nga ndikimi në ndërmarrjet publike që kanë ndodhur në këto 7-8 vitet e kaluara dhe hapjen e perspektivës për sektorin

privat. Prandaj, në këtë drejtim ne do të vazhdojmë me këmbëngulësinë më të madhe, me zotimet më të mëdha, duke siguruar dhe garantuar gjithmonë transparencën e plotë dhe suksesin e plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër për sqarimet! Fjalën e ka deputeti Gani Geci!

GANI GECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk po kërkon ndalimin e privatizimit ë Kosovë. Dhe këtë ta kemi të qartë! Ne nuk do të jemi pengesë e privatizimit. Edhe për këtë duhet të jemi të qartë!

Çka po kërkojmë ne? Ne po kërkojmë, e pyesim ministrin, po i pyesim edhe ata që kanë bërë vlerësime, sa e ka vlerën reale Posta? Ndryshimi prej 300 në 600 janë rrafsh 300 milionë, gjysma. Dhe nuk mundemi të themi prej 300 – 600 sepse në qoftë se themi prej 300 – 600 është si të nisemi prej zero deri në 300 dhe si të nisemi prej 300 deri në 600. Dhe, kjo nuk ka kurrfarë kuptimi.

Nën një, dikush po thotë, e ka 1 miliardë. Dhe në qoftë se Postë-Telekomi e ka 1 miliardë vlerën e aseteve, atëherë janë në pyetje 800 milionë. 1 miliardë – 1 miliardë e 100 milionë. Janë në pyetje 800 milionë! Dhe nëse janë në pyetje 800 milionë, kush dhe pse i humbi Posta dhe Telekomi i Kosovës... Unë pajtohem me dikë që tha këtu se në vitin 2007 ka pasur vlerë më të madhe. Pse i humbi? Ju e keni bërë drejtorin! Pse ju nuk e bëtë një njeri që di të menaxhojë më mirë këtë ndërmarrje publike, që posta mos t'i humb 800 milionë ose 300, ose 100, ose 10.

Prandaj, unë pajtohem këtu se ministrat më nuk po llogaritin me euro, as me dhjetëra mijëra euro. Ata veç me miliona! Gjysma e ministrave janë bërë milionerë. Bile edhe një ministër i ri që na ka ardhur këtu, i kishte 3 milionë euro pasuri. Më i riu! Shtrohet pyetja, ku i morën? Ku i morën këta miliona euro këta gjatë kësaj kohe të qeverisjes? Qe shkuan bre, 3 vjet! Hala s'janë bërë.

Për shembull, qysh ka mundësi që bija e Valës, ajo Dardafoni a Dardafoneti të jetë më e lirë se nëna? Dhe tash, t'i zvogëlohet vlера për shkak se bija u dalë më e fortë dhe nënën e ka....! Qysh ka mundësi kjo? Se, po më duket fort interesant kjo! Dhe, në të njëjtën valë, ajo i merr valët prej antenave të Valës. Dhe tash, këtë e ka bërë dikush me qëllim që t'i ulet vlера e Valës dhe kur t'i ulet vlера, ai që e ka vë në Pazar, t'i marrë paratë, t'i shtijë në xhep.

Mandej, janë punëtorët në PTK. Ju e dini që gjatë dy viteve të fundit i keni shti gati 1.000 punëtorë. Gjysma e tyre, ose jo gjysma, por një pjesë e madhe kanë qenë punëtorë të SHIK-ut. E dini mirë këtë punë, dhe një pjesë e shoferëve, bodigardave, shkojnë për t'i marrë rrogat atje për shkak se atje janë rrogat më të mëdha, e këtu me 200 euro s'po vjen kurrkush për të punuar. Dhe atyre ka me u dalë punë, pas 3 vjetëve, se ai operatori që e merr, ai ka për t'ua hequr prej pune këta. Ka për t'ua hequr, se disa s'dinë as të shkruajnë.

A e dini more ju se, pasha një zot, në Postë-Telekomin e Skenderajt 10 vetë presin për t'u ulur në një karrige! 10 vetë presin në rend për t'ua lëshuar pak të ulen e të pushojnë. Hej, kjo është për t'u çuditur! Po ju them sinqerisht. Atje shkoj unë shpesh dhe e paguaj telefonin tim dhe i shoh.

Unë nuk kam qare pa i sjell disa paralele, e ju e keni diskutuar edhe në Grupin Parlamentar të PDK-së. Është diskutuar dhe ka pasur diskutantë aty që ka thënë: mua po më vjen keq që aty është fol që okupatori i Serbisë e ka ruajt më shumë pasurinë e Kosovës se vetë ne, se vetë Qeveria. Nuk e di pse?

Unë, nëse doni kryetar, ua tregoj emrin kush më ka thënë, po s'po dua. Është i drupit të juaj parlamentar.

Dhe, qysh ka mundësi që okupatori ta ruaj pasurinë për dhjetë vjet si okupator më shumë se ne. Dhe, ne pasurinë tonë, t'ua japim ose t'ua falim "luftëtarëve patriotë" që i kemi kështu.

Unë e përgëzoj kryeministrin e Republikës së Kosovës. Sinqerisht e përgëzoj për kontrollin që e ka mbi deputetët e LDK-së. Ishalla nuk kërkon...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Gani, e ke humb të drejtën për të qenë kryetar i Komisionit të AIK-ut. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ju përshëndes, i nderuar zoti ministër,

Dhe ju përshëndes të gjithë juve, që jeni këtu të pranishëm,

Na paskan shkuar mysafirët e demokracisë!

Me të vërtetë nuk e di a ia vlen me diskutuar tash pas diskutimit të kryeministrit dhe të kolegut, parafolësit mirëpo megjithatë po mundohem t'i them disa fjalë.

Procesi i privatizimit nuk është proces emocional as nuk është proces patriotik, siç mund të paraqiten eksponentët e opozitës para opinionit publik. Njeriu shet, atëherë kur ka çka shet edhe e shet një send me vlerë. Për arsye se me qenë me vlerë ai mund të sigurojë një shumë parash me të cilat mund të kryejë ndonjë punë. Dhe qëndrimet se po e shesim asetin më të rëndësishëm, më dobiprurës, do të thotë në aspektin ekonomik, janë krejt naive dhe dilitanteske. Ne duhet të shesim atë gjë që ka vlerë dhe që bie para, bie para në Kosovë. Gjithmonë shitet kështu.

Dhe, unë me ju thënë të drejtën, ju kisha lutur që të jeni shumë racionalë dhe të jeni në nivel të përgjegjësisë së përfaqësuesit të popullit, si deputetë që jemi dhe të marrim vendime të guximshme dhe vendime që janë në interes të këtij brezi dhe brezit që vjen e jo vendime që ndoshta i cenojnë interesat tona personale, qofshin individuale, qofshin partiake.

Unë mendoj se ne nuk duhet të kemi asnjë frenim moral, asnjë frenim emocional për të thelluar dhe për të përshpejtuar procesin e privatizimit, në të gjitha nivelet, sepse ky proces është i domosdoshëm për të hapur tregun, për të rritur performancën si shtet, për të transformuar pronën ashtu qysh e kemi transformuar politikën nga monopoli partiak i një partie kemi krijuar pluralizëm politik, ashtu do ta inkurajojmë edhe pluralizmin e pronës – të kemi pronë private, pronë publike dhe partneritetin, do të them, publiko-privat ose pronën mikste.

Transformimet ekonomike, shoqërore, pronësore në Kosovë janë të pashmangshme dhe janë në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Unë mendoj se diskutimet që të shikohet sa duhet të jetë përqindja e privatizimit kanë qenë reale, rationale dhe kanë qenë qëllimmira. Mirëpo, ata kolegë që mendojnë se vetëm 51% duhet të

privatizohet, mendoj se e bëjnë më shumë për shkak të ndjenjave, qofshin të emocioneve ose qofshin të dhimbjes që kanë, për arsye se asnjë investitor serioz nuk do të vjen në Kosovë të japë para për me qenë vendimet menaxheriale, me qenë pa fuqi me marrë vendime menaxheriale, nuk jap askush para në Kosovë. Kështu, këtu besoj, me partnerin e koalicionit dhe me partnerë tjerë të koalicionit Grupi ndërmintor duhet të gjejë një kompromis që të rritet norma e privatizimit në mënyrë që ky proces të jetë i suksesshëm dhe ta shesim sa më lartë.

Në rast se ne e shesim vetëm 51% të pronës atëherë ne duhet të llogarisim që do t'i marrim diku nga 300 – 400 milionë. Se nëse 1 miliardë është vlere, dhe e shesim 50% do të thotë vlere do të jetë shumë e ulët dhe shtrohet pyetja a ia vlen që ne ta shesim një aset, e të mos kemi mundësi ta krijojmë një aset të ri.

Tani kur erdha te aset i ri krijues... Nëse ne e shesim postën sot, e cila do të bëhet ngarkesë për Qeverinë e Kosovës, se Posta ka qenë e suksesshme, kolegë të nderuar, për shkak të monopolit dhe çmimet e larta. I ka zhvatë qytetarët e Kosovës që 10 vjet. Liberalizimi i tregut nuk do t'i krijojë këtë komoditet Postës me këtë menaxhim që të ketë kaq profite. I ka zhvatë qytetarët dhe që 10 vjet na ka zhvatë posta. Për këtë arsye ka qenë e suksesshme. Jo për shkak të vendimeve menaxheriale.

Ne duke e transformuar pra këtë aset, po krijojmë një aset të ri, po krijojmë autostradën e cila do të prodhojë buxhet për Kosovën, do të prodhojë vlere për Kosovën dhe do të krijojë kushtet e mundësitë reale për mirëmbajtjen ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryetar,
Zotëri kryeministër, se tash ju pashë,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Deputetë të respektuar,

Meqenëse një kolegë i nderuar më parë e theksoi konstatimin e Institutit Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare, unë s'do të ndalem aty, por do të ndalem te diçka tjetër, që vërtet tanimë është bërë modë që të thuhet ekspert, por ekspert i mirënjohur në dimensionet ndërkombëtare Joli Dickson, sepse apriori vlerësimet analitike shkencore kanë qenë dhe kanë mbetur se spini dhe spin-off-i dështime janë dhe janë prodhuar vetëm dështime në Kosovë. Ju lutem, që 9 vjet dështime, 70.000 kanë mbetur pa punë, pa kurrfarë gjasash për t'u punësuar e tjera, e tjera. Kontratat nuk përfillen dot, nuk përfillen dot! E pse janë bërë kontrata korruptive? Kjo është kryesorja.

Më pastaj, meqenëse shumë kolegë kanë theksuar. Aksentimet s'do t'i përsëris, por do të them këtë, përfundimisht.

Jam për transformim pronësor, jo edhe privatizim, me kusht që të bëhet vërtet një vlerësim, një evaluim, një estimim real, objektiv i Postës. Se një fshatar kur e qet një gomar për ta shitur, shumë mediton se sa duhet, do të duhej të ishte minimumi dhe eventualisht maksimumi. Dhe pothuaj se përafërsisht e di sa e ka çmimin. A këtu, është oscilimi tepër i pajustificueshëm, gjysmë për gjysmë, apo jo. Nuk është i logjikshëm. Dhe do të duhej të bëhej një kontratë preliminare, kushtet e një kontrate preliminare dhe ato të miratohen. Dhe, më pastaj, të diheshin kontratat. Dhe ajo kontratë do të duhej t'i kishte instrumentet juridike të cilat do ta kishin përforcuar, mos të them siguruar, realizimin e asaj kontrate. Ndryshe, kontratat t'i marrim ne... Kemi shumë numër enorm të rasteve në odën, që

quhet, bile ajo nuk është në kuadrin e gjykatës, por quhet asisoj – odën e veçantë të Gjykatës Supreme. Janë me mijëra e mijëra lëndë të cilat nuk kryhen për dy-tri vite e fare, e tjera, e tjera. Është një numër i madh i ankuesve. Konsiderohet se janë 160.000 ankesa të cilat pothuaj se nuk kanë gjasa për t'u zgjidhur, së paku jo për një kohë të gjatë.

Prandaj, t'i marrim këto eksperiencat të këqija e t'i eliminojmë nëpërmjet një përgatitje serioze e ta kryejmë këtë transaksion sepse fundi i fundit është një aset me vlerë kombëtare. Falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputetja Melihate Tërmkolli.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Kosova nuk mund t'u ikë trendëve ekonomikë të shteteve të rajonit dhe të konkurrencës. Edhe sikur opozitarët, që sot po ngritin pluhur aq shumë në këtë debat kundër privatizimit, të ishin në pushtet do ta bënë privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës, ashtu siç e kanë bërë privatizimin e shumë ndërmarrjeve publike gjatë mandatit të tyre, me rëndësi jo më pak vitale se Postë-Telekomi i Kosovës.

Prandaj, arsyetimi që për të mirën e popullit dhe në emër të pasurive shtetërore, nuk bënë të privatizohet Posta, nuk pi ujë para opinionit publik sepse nuk janë të larta eksperiencat e mëparshme të punëtorëve dhe të popullatës nga privatizimi gjatë mandatit të qeverisjes së kaluar.

Populli ia ka dhënë mandatin kësaj Qeverie që me votën e vet ta qeverisë vendin e me të ta bëjë edhe privatizimin si segment i shoqërisë dhe qeverisjes sonë. Çështja është që të nxirret maksimumi i mundshëm në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën, le të përgatitet Driton Tali.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë,

Ne edhe sot po bisedojmë fatkeqësisht si edhe shumë herë tjera më tepër sa për të biseduar, ndoshta, se sa për të nxjerrë përfundime të rëndësishme. Shumë herë, edhe sot, gjatë trajtimit të kësaj teme, po edhe gjatë ditëve më herët, vazhdimisht kur trajtohen tema të rëndësishme thuhet që opozita po e shantazhon Qeverinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë, ju e dini shumë mirë që kjo opozitë kurrë me asnjë veprim të vetin nuk ka bërë shantazh. Ka sjellë argumente. Është kjo Qeveri e cila dje ishte opozitë, e cila vetëm para pak kohe, jo vetëm që e shantazhonte Parlamentin e Kosovës, por e shantazhonte vendin, i shantazhonte interesat e vendit. Dhe këtë nuk e kanë jashtë kujtesës qytetarët e Kosovës. Nuk ka ndodhë para 300 vjet, as 30, janë vetëm 2-3 vite më herët. Dhe kjo po ndodh edhe sot. Edhe sot po shantazhohet ky Parlament i Kosovës nga po kjo Qeveri, që e bënte të njëjtën gjë dje dhe pardje.

Opozita ka ofruar dhe po ofron argumente, të cilat Qeveria, për fat të keq, nuk i ka ofruar – pse dhe çka përfiton Kosova me privatizimin e PTK-së. Dhe opozita ofron argumente, ndërsa, madje edhe deputetë të pozitës lypin tulla. Argumentet nuk janë tulla, zotëri e zonja. Argumentet janë argumente. Ka dhjetëra-qindra argumente pse nuk përfiton Kosova me privatizimin në mënyrën qysh e parashihet Qeveria e Kosovës.

U tha, madje edhe nga kryeministri, që PTK-ja ka qenë dhe është në duar të grupeve dhe klaneve. PTK-ja është mirë, deputetë të pozitës, sepse opozita e dimë në duar të kujt është. Të përmenden ato

grupe dhe ato klane, jemi plotësisht dakord dhe kjo është fatkeqësi e madhe. Por kjo nuk e bën më pak pasuri kombëtare PTK-në, sikur edhe pasuritë e tjera. Madje, edhe Qeveria është në duar, ndoshta, të grupeve dhe klaneve. Fatkeqësisht, edhe Kosova ka mbetur në duar të klaneve dhe grupeve qeveritare, por kjo nuk e bën Kosovën më pak Kosovë.

(Ndërhyrje)

Ndoshta, duhet privatizuar Qeverinë! Tha, kryeministër, që në shtatë vite është ndikuar udhëheqja e PTK-së. Jam shumë dakord. Po, por është ndikuar pikërisht nga kryeministri, sepse merreni drejtorin që nga i pari e deri te tash ky i fundit, të gjithë janë njerëz të kryeministrit Thaçi, kryeministrit aktual. Të gjithë janë njerëz të PDK-së që në një mënyrë apo tjetër kanë qenë në forma të ndryshme të lidhur me PDK-në dhe me kryeministrin. Apo, ndoshta, edhe me dikë tjetër!

Dhe, opozita, s'dua të marr rolin e krejt opozitës, flas edhe për vete, po flas edhe nga ajo çka janë thënë si argumente, nuk është se jemi kundër privatizimit. Mos të na qet përralla neve kryeministri këtu duke menduar se është para adoleshentëve duke iu mbajtur ligjëratat nëpër shkolla të mesme a fakultete. Jemi deputetë të Parlamentit të Kosovës.

Nuk po bëhet fjalë për privatizim as të PTK-së, as të pasurive tjera kombëtare. Zonja, e zotërinj, po plaçkitet pasuria kombëtare. Prandaj, ne jemi dhe do të jemi gjithmonë kundër plaçkitjes së pasurisë kombëtare dhe kjo nuk do të ndryshojë asnjëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali. Ku po i çon gjithë ato letra?

DRITON TALI: Këto letra janë transkriptet, për t'i thënë, për ta demantuar zotin Ahmet Shala, se tha që është përgjigjur në të gjitha pyetjet që ia kemi bërë për PTK. Nuk qëndron ajo se zotni Shala është përgjigjur në të gjitha pyetjet. S'kam kohë, se të gjitha do t'ia lexoj dhe do ta shoh se në asnjë s'është përgjigjur. Krejt janë në transkripte këto!

Po ashtu, do ta demantoj edhe kryeministrin, që s'është këtu, edhe ministrin që thanë se nuk e kanë hapur tenderin dhe nuk do ta hapin tenderin pa e marrë vizën prej Kuvendit. Sepse e kanë hapur tenderin pa e marrë vizën nga Kuvendi. Hapja e shprehjes së interesit, është hapje e procesit të tenderit, sepse nga aty nxirren kandidatët, bëhet lista e ngushtë e atyre më interesantëve. Pra, është hapje e procedurës, dhe këtë e keni bërë pa e marrë vizën e Kuvendit. Zotëri, Ahmet Shala, lexojë ligjin mirë!

Pastaj, edhe një diçka desha ta them, mos ta harroj. Zoti Naim Rrustemi, i ngatërroi disa gjëra në fjalimin e tij. Ma merr mendja se i qartëson ai më vonë. Çështjen tjetër që do të doja ta pyetja zotin Ahmet Shala, po edhe kryeministrin, është: pse e kanë zgjatur afatin për dy javë të shprehjes së interesit, kë po presin me tenderuar. Mos i kanë premtuar dikujt diçka, apo...?

Sidoqoftë, unë po deklarohej publikisht se nuk e përkrah këtë proces të privatizimit të Postës, sepse nuk e kanë nisur mbarë. Ja pse: më 30 tetor 2008, eksperti i ekonomisë, doktor profesor Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave, në këtë tempull të demokracisë ja se çka deklaroi – thotë: Kriza globale nuk do ta prekë, nuk do të ketë ndikim në uljen e çmimit të shitjes së PTK-së. Dy-tre muaj më parë, Roland & Berger një kompani konsulente shumë e çmuar gjermane, madje ma me nam se sa Telco AG, PTK-në e pati vlerësuar mbi 1 miliardë euro. Sidoqoftë, pas dy –tre muajve, zoti Ahmet Shala, eksperti i ekonomisë, profesori, doktori i ekonomisë thotë, kapeni, lexojeni kornizën afatmesme, në qershor na e patën dorëzuar, e kemi diskutuar këtu, të vitit 2009 se: vlera e PTK-së

është 500 milionë euro; dhe atë me vlerësim konservativ. Shumë herë e kam pyetur çka mendon me atë, kurrë s'më ka treguar eksperti i ekonomisë, doktor profesor Ahmet Shala.

Disa muaj më vonë, po i njëjti ekspert i ekonomisë, PTK-në me këshillat e Telco AG– konsulentit të transaksionit, ia jep vlerën PTK-së nga 300 në 600 milionë. Domethënë, 300 milionë. Shtrohet pyetja: pse kjo kështu dhe kush është Telco AG.

Të nderuar qytetarë të Kosovës, drejtoreshë menaxhuese e Telco AG është Tatjana Kuher. Kush është Tatjana Kuher, shtrohet pyetja? Tatjana Kuher ka qenë drejtoreshë menaxhuese e Reiffeissen Investment. Shtrohet pyetja, çka është Reiffeissen Investment? Reiffeissen Investment është kompani që ka konkurruar për ta blerë PTK-në dhe thoni tash se këtu s'ka konflikt të interesave! Dhe, më thoni që EULEX-i seriozisht e ka marrë për ta luftuar korrupsionin. Pra, EULEX-i, ata që na premtinin verë të nxehtë, e ne u mërdhimë. Bile, një mik i imi, ndërkombëtar, tha – mos ia mbaj gajlen se me 500.000 euro krejt EULEX-in e blenë, këta ekspertët që kanë ardhur këtu për ta luftuar korrupsionin. Unë i thashë, 500.000!? Po, këta tanët ua japin nga 1 milionë, 2 milionë euro për të mos e luftuar korrupsionin.

Unë po them, jam kundër këtij privatizimi dhe, për të mos e zgjatur shumë, se nuk kemi edhe kohë për shkak se është nisur prapë (prapësht). Unë jam i bindur që blerësi dihet. Do të jetë një investues i ngjashëm sikur me ata të Ferronikelit që prej 2 miliardë e 400 milionëve sa kushtonte – vlente Ferronikeli atëherë – dollarë po mendoj, e shitën për 40 milionë dollarë, apo ngjashëm siç ishte edhe me Limak ndërmarrjen, menaxherët e të cilëve nëpër gjykata, drejtorët e Limakut ende janë nëpër gjykata duke u marrë në Turqi për shkak të korrupsionit. Unë po habitem, zotëri Ahmet Shala, ku po i gjen bre këta investues, a mos keni ndonjë klub që rrini bashkë aty, a çka është... Secili më biografi të keqe prej këtyre investuesve që vjen për të na i blerë asetet tona.

Pastaj....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, Driton Talit!

DRITON TALI: Pastaj... të thuash se po e shet Postën për shkak të korrupsionit, kjo është çmenduri. Dhe, apeloj tek qytetarët – mos e merrni seriozisht këtë Qeveri. Po kjo Qeveri është që ka ardhur në pushtet me kushtin se do ta luftojnë korrupsionin. U shpallën “komandanta të luftës” kundër korrupsionit. Qeverinë e shpallën “shtabin e përgjithshëm të luftës kundër korrupsionit”. E, tash e shesin Postën, sepse s'po mund ta luftojnë korrupsionin! Bile, na premtinin: kur të vijmë ne në pushtet, nuk ka për të pasur kriminelë që ecin këmbë. Aty, e kanë mbajtur atë farë premtimi, sepse kriminelët s'po ecin këmbë, po ecin me xhipa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Naim Rustemi, replikë, edhe pse jeni marrë vesh ju dy!

NAIM RRUSTEMI: Si do që të jetë, është procedurale. Veç desha t'ia përkujtoj deputetit Tali se nuk isha konfuz, por nuk desha me u lëshua më shumë në detale sepse e di që Ministria e Ekonomisë dhe Financave e di çka është procedura para përzgjedhjes, e dinë Ligjin e prokurimit publik, po kjo i bie si me i thënë hajnit hajn. Hajni e di çka është vet, më mirë se ti me i thënë. Kështu që nuk desha me u lëshua në detale, saktë se e di që e di Ministria e Financave dhe Ekonomisë që është duke e shkelur ligjin me të dy këmbët dhe është mirë me dal publikisht me thënë – cilat kompani ju shtyen që ta shtyni tenderin për dy javë? Cilat? Keni thënë, disa. Deklaratë publike e Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë. Cilat? Me fjalët “disa”, “të tjerë”, “të tillë”, “çfarë”, këto janë një fjalor romantik që mund me iu qit hi syve dikujt tjetër, por në Kuvend të Kosovës flitet me tema konkret. Kush? Me emër, unë po flas me emër.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe 3 diskutues, por para tyre, do ta marr fjalën unë.

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Mendoj, e shoh të nevojshme t’i them pak fjalë rreth kësaj çështjeje.

Nën një, dua të arsyetoj pse më 27 korrik ne kemi bërë votimin, në parim. Ai ka ardhur si pasojë se puna e gjithë Kuvendit bëhet në komisionet parlamentare. Komisioni përkatës parlamentar nuk ka bërë raport me rekomandime për strategjinë që ka qenë e ofruar nga Qeveria dhe konsideroj se ka qenë përgjegjësi e të gjitha grupeve parlamentare që i kanë anëtarët e vet në këtë komision. Dhe, ai votim në parim ka qenë i imponuar nga mospuna e deputetëve përgjegjës për të bërë raportin me rekomandime për seancën plenare.

Sa i përket çështjes së privatizimit, unë jam krejt dakord që të shikohet në një seancë të ardhshme, nëse ju deputetët jeni bash të interesuar, për të rishikuar gjithë procesin e privatizimit në Kosovë, si është bërë ai dhe vërtet a ka qenë i bazuar në ligje.

Ju e dini që, dhe unë po e them këtu, pasuri më kombëtare, nëse shkojmë me këtë fjalor që mund të mos i pëlqejë dikujt, se Ferronikeli dhe Trepça, por edhe shumë miniera tjera, unë mendoj që nuk ka dhe ne e dimë që Ferronikeli si një pasuri më e madhe është privatizuar jashtë çdo logjike të ligjeve në fuqi të asaj kohe. Mendoj se këtë e dini. Dhe, pastaj, për t’i ndihmuar edhe më shumë blerësit, që edhe aty ka pasur shumë konflikte të interesit, edhe rryma elektrike është falë dhe ajo ka shkuar jo në të mirë të buxhetit të Kosovës, por në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Të vijmë te procesi i privatizimit të Telekomit ose të Telefonisë mobile. Ju e dini se në mandatin e kaluar është privatizuar, është një pjesë, një tender ka marrë një kompani tjetër dhe janë bërë dy për Telefoninë mobile. Dhe, gjithashtu e dini se edhe aty ka pasur shumë parregullsi, jo vetëm në procedurat e përgatitjes së atij tenderi, por edhe në procedurat e nënshkrimit të atij tenderi dhe pastaj njerëzit që kanë qenë përgjegjës për Telekomin, si ART-ja e pastaj edhe janë avancuar në detyra të zyrtarëve të lartë për diplomacinë e Republikës së Kosovës. Mendoj se edhe kjo është e ditur.

Një çështje tjetër, që dua ta them dhe unë në një mënyrë i kuptoj disa logjika të privatizimit. Por, dua të them se nga operatori i dytë i Telefonisë mobile, njerëzit brenda Postë-Telekomit të Kosovës i kanë krijuar hapësirë të madhe operatorit të dytë dhe në këtë mënyrë është ulur vlera e çmimit të Valës, si operator kryesor në Kosovë. Edhe këtu, realisht, kjo ka shkuar në dëm të Valës. (ndërprerje e shkurtër e incizimit)menaxhimi që është bërë mund të them, jo vetëm në këtë pjesë, por në të gjitha pjesët e ka ulur çmimin e tregut të këtij operatori mobil në Kosovë.

Ne sot mund të themi se nuk do ta privatizojmë. Kush na garanton se pas një viti ose pas dy vitesh përsëri nuk do ta privatizojmë dhe cili do të jetë çmimi. A do të ketë ngritje a do të ketë rënie? Unë si laik në ekonomi, e kam shumë vështirë ta arsyetoj se vërtet a do të jetë më profitabile ta privatizojmë pas dy vitesh. Megjithatë, nëse e shikojmë tregun dhe mundësitë e shitjeve që do të bëhen në rajon dhe janë ndoshta në perspektivë të bëhen, vende që numerikisht kanë disa herë banorë më shumë se ne dhe

që do të jenë më kërkues për ofertues, siç është Serbia, Bullgaria apo edhe ndonjë vend tjetër, Kosova nuk paraqet ndonjë treg shumë interesant, kur dihet edhe numri i kufizuar i banorëve të saj.

Prandaj, mendoj se ne nga ky debat duhet të kërkojmë edhe një herë nga komisioni përkatës, me ministrinë përkatëse, ose komisionin përkatës ndërmintor t'i analizojnë dhe të na bien një raport me rekomandime dhe ne të marrim një vendim që është konform interesit të qytetarëve të Kosovës, konform interesit të Kosovës.

Unë mendoj se kjo do të ishte zgjidhja më e mirë dhe po kërkoj edhe një herë, nga të gjithë anëtarët që janë në komision dhe nga ministria dhe komisionit ndërmintor, që të na hartojnë një raport me rekomandime dhe të na arsyetojnë arsyen pse duhet të privatizohet Vala dhe ne si Kuvend duhet ta respektojmë atë raport me rekomandime.

Unë mendoj se kjo do të ishte zgjidhja më e mirë në këto momente. Megjithatë, unë dëshiroj të them se jemi përpjekur si Kuvend ta ruajmë rolin dhe përgjegjësinë tonë që e kemi, prandaj edhe një herë thërras që komisionet përkatëse, të gjithë materialin që e marrin nga Qeveria, qoftë atë legjislativ dhe tjera, ta përpunojnë mirë, të bëjnë raporte e rekomandime me kohë dhe ne si Kuvend dhe si Kosovë të kryejmë përgjegjësitë tona që i kemi në rend të parë para qytetarëve tanë. Ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, kryetar! Zoti Naser Rugova është në radhë të marrë fjalën!

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

NASER RUGOVA: Ju faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që ta përgëzoj fjalën e kryeparlamentarit zotit Krasniqi, i cili ishte shumë i qartë, shumë konkret, shumë pragmatik dhe logjikoi për interesin nacional.

Definitivisht, kur flasim për asete nacionale strategjike, duhet të logjikohet kështu dhe duhet të konceptohet në mënyrë të përgjegjësisë, të aktualitetit, trendeve ekonomike, politike dhe sociale.

Zoti ministër, Shala, definitivisht, Parlamenti i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i këtij shteti. Ne jemi Republikë parlamentare dhe e kemi zgjedhur edhe presidentin edhe Qeverinë, edhe juve si ministër. Qeveria harton, formulon, dizajnon politika, por vendimet e rëndësishme nacionale i marrin të zgjedhurit e popullit – deputetët.

Definitivisht, zoti kryeparlamentar, ka ardhur momenti që te asetet strategjike nacionale të ndalemi e të mendojmë, të mos ndodh si me Feronikelin, ku ministri Shala ishte në atë kohë zëvendësudrejtor i AKM-së. Po ka këtu edhe njerëz të tjerë që e kanë një dozë përgjegjësie, janë këtu në këtë Parlament dhe ju e thatë mirë – kur flasim për operatorin e Telefonisë mobile, operatorin e dytë, 20 herë kanë bërë pyetje deputetët e këtij Kuvendi për 16.2 milionë euro dhe njerëz që kanë mbi 6 lëndë në prokurori çohen ambasadorë në një vend prej nga e ka bërthamën operatori – pronari që i ka asetet kryesore të operatorit të dytë të Telefonisë mobile. Kjo i bie thjeshtë: ti ma ke dhënë mua tenderin e Telefonisë mobile, unë e kam marrë qysh kam dashtë dhe ty nja 3-4 njerëz të kanë zgjedhur ambasador në vendin prej të cilit e ka gjenezën ai operator i Telefonisë së dytë mobile.

Ju lutem këto janë fakte dhe ju bëftë mirë atyre që e kanë bërë këtë, që i kanë propozuar, sepse EULEX-i është duke hetuar, dhe dikujt ka me i dhimbte koka për ato vendime që e ka fye këtë Parlament, këtë Qeveri dhe këto institucione të këtij shteti të ri.

Nuk po flas si deputet i pozitës as i opozitës, po flas si qytetar dhe po flas si njeri i zgjedhur: t'ia ngrisim vlerën këtij institucioni sepse e kemi humbur besimin para qytetarëve dhe të logjikojmë një herë e përgjithmonë, mirë e tha kryetari Krasniqi. Dikujt po i pengon fjala nacionale! Jo, jo! Ne po flasim për interes nacional dhe shtetëror dhe mbaroi çështja. Këtu, dofarë biodiversiteteve të teknologjisë, të astrologjisë dhe të galaktikave nuk janë. Jemi Parlament nacional dhe e rrethim telin e zhvillimit kombëtar. Mbaroi çështja! Andaj, unë kërkoj nga ndërgjegja e të zgjedhurve të popullit, të ju thonë stop këtyre shakave me pasuritë strategjike nacionale.

Po të vjen ai operatori apo ai që do ta privatizojë telekomin e një shteti, çka do të ndodhë me linjat e rëndësishme të Ushtrisë, të Policisë së Kosovës, të Agjencionit Kosovar të Inteligjencës po edhe të Presidencës, të Qeverisë dhe të Parlamentit? Dy vjet gjermanët dhe Bundestagu diskutojnë për privatizimin e Deutsche-telekomit. Dhe dikush hap atje procedurë të shpalljes së interesit, ia ulë vlerën – herë 500 milionë e herë 600, herë 300. Mos po do dikush me ble vetë me dikë, me do adresa të çuditshme, që na i kanë privatizuar asetet më të rëndësishme nacionale.

Unë kërkoj një seancë të veçantë, zoti kryetar me rekomandime të komisionit profesional, a – komisioneve edhe politike edhe profesionale, po komisioni funksional na tregon çka të bëjmë. Dhe kjo punë të ndalet, të analizohet dhe të shohim momentumin e caktuar politik, social, ekonomik se si do ta privatizojmë: pse 75:25? Pse me të parën 75? Të ndalemi, ta analizojmë. Dhe në këtë trend të krizës ekonomike globale, duhet ta vlerësojmë interesin e qytetarëve dhe të Kosovës – çka do të ndodhë me ata 4.000 njerëz. S'ka rëndësi kush i ka punësuar, kur janë punësuar. Janë punëtorë, janë pranuar në punë, janë qytetarë të Kosovës dhe kemi obligim që të mendojmë dhe për të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Emrush Xhemajli e ka fjalën! Emrush, mundësisht, shkurtoje pak!

EMRUSH XHEMAJLI: Përhëndetje! Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër i Ekonomisë dhe Financave,

Unë për veti, pas mbledhjes që u mbajt më 27 korrik, vendimin e kam kuptuar si një mundësi përsëri për t'u diskutuar këtu dhe për t'u marrë vendim lidhur me Postën.

Kam qenë plotësisht i shokuar kur unë në gazetë e kam parë atë shpalljen e interesit për shitjen e PTK-së. Jam çuditur, kam mbetur pa mend! Singerisht!

Edhe, nuk jam çuditur fare që Sindikata e PTK-së këtë çështje e ka çuar në Gjykatën Supreme dhe do ta çojë edhe më tutje, sigurisht.

Këtu, shpeshherë po flitet sikur të ishim vitet '80 ose '70, kur gjithë ekonomia ka qenë shoqërore. Edhe kur flitet për Postën, kështu po flitet. Po ne e dimë që ka sektorë privatë dhe sektorë publikë në Postë. Nuk e di çka po flitet këtu për privatizimin. Privatizimi ka ndodhur. Ne jemi duke folur për këto asetet publike që i ka çdo vend kapitalist në botë.

Prandaj, thjeshtë, po çuditëm pse po tentohet të devijohet plotësisht tema për të cilën po flitet. Këtu po flitet për një propozim për ta shitur PTK-në dhe propozimi është 300 deri 600 milionë. Unë nuk po e shoh këtu arsyen pse ta shesim kur kjo është duke punuar me profit. Një, i ka dhënë buxhetit të Kosovës rreth 300 milionë brenda një kohe të shkurtër, 3 – 4 vjet, ju lutem, dhe pritet që brenda kësaj kohe që po mendohet të privatizohet t'i japë po aq, domethënë ta jep këtë çmimin 300 milionë, se këtu po thuhet 300 është për t'u shitur e 600 është për të na thënë ne deputetëve, a po kuptoni, po edhe

popullit, kjo është e qartë. Dhe, është fjala për 300! Këto 300 milionë do të vijnë në ndërkohë prej Postës dhe në rastin kur po e shpjegon ministri i Financave se do të shkojë duke rënë vlera e këtyre aseteve. Domethënë, gjithsesi buxheti i Kosovës në të gjitha variantet po fiton nëse nuk e privatizon Postën sot. E për mendimin tim, qëndron plotësisht ajo çka u tha prej deputetëve dhe prej kryeparlamentarit, edhe prej zotit Rugova që duhet menduar seriozisht për ato vijat që u folën këtu të shtetit që gjithmonë mbeten në pronësi të shtetit.

Tash unë, për fund, për mos t'ju mërzitur, kisha dashur ta tërheq vëmendjen edhe në diçka. Këtu një shqetësim i jashtëzakonshëm prej ministrit të Financave, prej Qeverisë, është duke u bërë lidhur me interesin e investitorëve, gjë që mua po më revoltonte shumë, sepse na këta i kemi votuar për interesin e vendit tonë. Këta nëse mendojnë se janë përfaqësues të biznesit të odave ekonomike, të financuesve, e kanë gabim. Atëherë, le të japin dorëheqje dhe na po i zgjedhim do ministra, një qeveri që i mbron interesat për çka paguhen. S'ka kurrfarë kuptimi, nuk ka diskutim që ministri Shala nuk e thotë se nuk po vijnë investitorët e huaj, gjithë gajlen ua mban atyre, ndërkaq i paguar është për t'i qarë dertet Kosovës. Faleminderit, i nderuar!

KRYETARI: Emrush, faleminderit! Veç ministri ia qan hallin! Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të respektuar kolegë,

Debatet e kërkuar në Kuvend për çështje me interes të caktuar janë të mirëseardhura sepse qesin në shesh shumë gjëra me interes për qytetarët dhe institucionet e Kosovës. Pra, qesin në pah cili është interesi dhe pasojat për privatizimin e ndërmarrjeve publike apo për transformimin e pronës publike. Mirëpo, me këtë rast, kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së nuk e shoh si shqetësim serioz për nismën e privatizimit të PTK-së, si ndërmarrje publike profitabile në Kosovë.

Këtë e potencoj sepse me 27 korrik të këtij viti, kur ishte në rend të ditës Strategjia për privatizimin e PTK-së deputetët e opozitës në vend që të qëndronin në seancë dhe të bënin vlerësimin duke begatuar me rekomandime Strategjinë, në vend që të japin opinionin e tyre se kjo iniciativë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizim të PTK-së mos të jetë e ngutshme por të hulumtohen dhe të gjenden modalitete dhe opsione që shkojnë e drejtojnë në një privatizim të mirëfilltë, deputetët e opozitës qëndronin në hapësira të ndërtesës së Kuvendit duke pritur se si po përfundon kjo pikë e rendit të ditës.

Atë ditë, edhe komisioni funksional nuk ka qenë në nivel të përgjegjësive, sepse Strategjia është proceduar pa rekomandime të komisionit funksional. Atë ditë dhe sot shpreh habinë se kujt po i ngutet privatizimi i ndërmarrjes më profitabile në Kosovë. Pra, me datën 27 korrik është dashtë të debatohet bashkërisht dhe ta vlerësojmë procesin e transformimit të pronës publike, të hulumtojmë modalitete, të caktojmë dinamikën dhe planin kohor për procesin e privatizimit të PTK-së.

Të gjithë e kemi të qartë, po edhe unë, se ekonomia e lirë e tregut, qarkullimi dhe lëvizja e lirë janë kusht për integritet evropian. Në këtë drejtim, unë, me datën 27 korrik e kam dhënë vlerësimin për privatizimin e PTK-së, por edhe me këtë rast do t'i jap disa vlerësime.

Në Kuvendin e Kosovës është debatuar Strategjia për privatizim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky debat dhe debati i datës 27 korrik, dhe debati apo vlerësimi i Strategjisë me rekomandime nga komisioni funksional është me interes të veçantë sepse do t'ia bëjmë Qeverisë së Republikës së Kosovës të ditur se privatizimi i pronës publike duhet të jetë shumë transparent, duhet të

bazohet në ligj dhe përgjegjësi e saj është që vërtet ky proces të jetë i mirëfilltë dhe t'i plotësojë të gjitha kriteret. Këtë vlerësim e bëj sepse në shumë debate dhe shumë letra të drejtuara neve si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës na sugjerojnë, dhe ne jemi plotësisht të vetëdijshëm, se duhet të jemi të kujdesshëm gjatë privatizimit të ndërmarrjeve publike. Kjo na është thënë edhe gjatë takimeve që kemi pas nderin të bëjmë në institucionet evropiane.

Dhe, krejt në fund, me këtë rast do të kërkoja që me rastin e ardhjes në procedurë të Strategjisë me rekomandime nga komisioni funksional, një vëmendje e veçantë t'i kushtohet modaliteteve më të mira që e kanë bërë shtetet dhe të caktohen afatet kohore dhe procesi i privatizimit të jetë shumë transparent, në mënyrë që të gjitha çështjet të shkojnë ashtu siç është më së miri për qytetarët dhe institucionet e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kam një numër të paraqitur por, Hajdin, ke ardhur me vonësë. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë, sinqerisht, shpeshherë jam në dilemë a t'i dëgjoj bindjet e mia profesionale dhe konceptet e mia, apo nga presioni i folklorizmave dhe populizmave të heq dorë nga bindjet të cilat konfirmojnë një qëndrim profesional për të ardhmen e vendit. Dhe, nuk e di, e nuk do të mund, si duket, kurrë që të jem as populist, as folklorist. Por, mbase edhe ministri i Financave do të ishte dëmi më i madh i popullit të ishte i tillë.

Unë këtu, para jush, kam paraqitur në emër të Grupit ndërministror një strategji, të cilën 5 ministra të përfaqësuar proporcionalisht sipas ligjit edhe nga pozita edhe nga opozita, e aprovuar edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës, një strategji e cila është pranuar në parim nga ky Kuvend.

Deri më tani, janë dëgjuar mjaft kritika, disa prej tyre mjaft me vend. Por 2-3 tema të cilat janë shtruar këtu, konsideroj, se ky grup ndërministror do t'i marrë parasysht dhe do t'i analizojë dhe t'i rekomandojë Qeverisë për t'i shkrirë ato dhe për t'ua sjell juve më 27-tin... Kryesisht do t'ua sjellin më 27-tin.

Zoti kryetar, do të ju kisha lutur, nëse ka mundësi për kulturë, të paktën, të debatit, disa njerëz që janë tepër të disponuar veç me shantazhua këtu, t'i ndalni...

KRYETARI: Është vërtet mirë të dëgjoni, ju lutem deputetë! Ne ju dëgjuam, edhe ministri ju dëgjoi. Unë ju kisha lutur që vërtet të dëgjoni. Ne duhet të mësohemi të dëgjojmë edhe mendimin e kundërt, a u pajtuam apo s'u pajtuam. Duhet të kemi vesh!

(Ndërhyrje)

MINISTRI AHMET SHALA: Dhe ky komision ndërministror, konform të gjitha këshillave profesionale, që u dhanë edhe ide mjaft të mira këtu, dhe propozime të cilat neve do t'i inkorporojmë në strategjinë e cila do të diskutohet këtu më 27-tin.

Unë ju thashë dhe prapë duhet të risforcoj mendimi tim, se mendimet të cilat ngrisin interesin nacional, ngrisin transparencën dhe rrisin vlerën e PTK-së do t'i marrim parasysht. Kjo do të jetë mbështetja ime. Besoj se edhe kolegët e mi, ministra – ministri i Transportit, Tregtisë dhe Industrisë, ministri i Pushtetit Lokal dhe ministri i Mirëqenies Sociale do ta mbështesin këtë dhe i cili do të aprovohet në Qeveri dhe si e tillë, si finale, do ta aprovojme.

Unë besoj se edhe fjala e kryetarit të Parlamentit, ku ishte në këtë frymë, do të ulemi bashkë dhe të bashkërendojmë veprimet në boshtin strategjik të këtij transferi. Nuk është pak me u transferuar ky aset në një aset tjetër. Të gjitha sugjerimet me vlerë që i kemi dhënë qoftë në numrin e përqindjes, qoftë në transparencën, qoftë në kohën neve do t'i shqyrtojmë në Grupin ndërministror dhe do t'i sjellim, besoj, këtu për aprovim.

Unë do të ju kisha lutur që t'i lëmë emocionet anash, t'i lëmë folklorizmat anash dhe të bisedojmë në ato parime të cilat u thanë nga deputetët mjaft me dinjitet dhe me profesionalizëm.

Të gjitha elementet dhe pikëpyetjet që janë shtruar qoftë sa i përket kapacitetit ose të drejtës ligjore, që po ngritet me zë dhe trumbetim nga njerëz me mbase agjende tjera, apo emocione të pakontrollueshme, neve do t'i shqyrtojmë dhe nga ekspertë, vërtetë ekspertë juridikë, do t'i japim përgjigjet më 27-tin dhe unë besoj se është reflektuar edhe në dokumentet deri më tash.

Gjithsesi, ju falënderoj të gjithëve dhe uroj që në seancat e ardhshme të ketë besoj përmbajtjen dhe shprehjen e emocioneve të të gjithëve në frymën e një bashkërenditjeje dhe bashkëpunimi për një qëllim objektiv të caktuar. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju kisha lutur! Jemi në përfundim, të bëheni të durueshëm dhe ju në të djathtë mos jepni shenjë në të majtë. Fjalën përfundimtare, e ka deputeti Lulzim Zeneli!

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke pasur parasysh përfundimet që i ka nxjerrë Kuvendi i Republikës së Kosovës me datën 27 korrik, me të cilat kërkohet nga komisioni funksional që të propozojë dokument-strategjinë me të gjitha rekomandimet në shtator, për miratim final, atëherë lind një pyetje, dhe kryetari i Kuvendit, unë besoj, do ta sqarojë para deputetëve: Si është e mundur që Qeveria të hapë tenderin e privatizimit pa vendimin e Kuvendit?

Pushteti aktual, me politikat e tij, konsiderojmë se i ka vë në lajthitje edhe të gjithë partnerët ekonomikë, të cilët janë të interesuar të marrin pjesë me investimet në Kosovë, mirëpo ajo çka është më e rëndësishmja, e ka injoruar Kuvendin e Kosovës në tërësi ndaj obligimeve kushtetuese.

Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës të nxjerrë një vendim, ku kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërpresë çdo aktivitet që lidhet me shitjen e PTK-së deri sa nuk bëhet një vlerësim i detajuar i aseteve të PTK-së.

Sot, i nderuari kryetar i Kuvendit, të gjithë deputetët e dhanë mendimin, fjalë të mira dhe shumë përmbajtjesore, mirëpo jemi të shqetësuar dhe të brengosur mjaft që punët po ecin dhe në këtë drejtim duke ecur punët, Kuvendi jo vetëm që është anashkaluar, por është injoruar në detaje nga ana e ekzekutivit të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, Kuvendi nuk është gjyqësor për të marrë veprime të gjyqit as të dikujt tjetër. Nëse Qeveria e privatizon Postë-Telekomin ose Valën, atëherë organet e drejtësisë duhet të veprojnë, por përsëri nuk jemi ne që veprojmë.

Ne nuk i kemi dhënë si Kuvend vizën për privatizim.

(Ndërhyrje e deputetit Driton Tali)

Ju lutem! Ne bëmë një debat dhe sipas propozuesit, ne s'kemi çka votojmë në fund. Mirëpo, edhe një herë po kërkoj nga komisioni përkatës, me këta deputetë:

- Muzejene Selmani, kryetare
- Ethem Çeku, zëvendëskryetar,
- Mursel Halili, zëvendëskryetar i dytë,
- Kaqusha Jashari,
- Adem Grabaovci,
- Fatmir Rexhepi,
- Sala Berisha-Shala,
- Zef Morina,
- Adem Salihaj,
- Qamile Morina, dhe
- Mufera Shinik.

Që gjatë këtyre dhjetë ditëve, në konsultim me ministrin dhe komisionin përkatës ndërmënistror, ta bëjnë raportin me rekomandimet dhe ne si Kuvend ta kryejmë detyrën dhe obligimin tonë sipas raporteve me rekomandime që merret edhe mbi bazën e këshillave profesionale.

Prandaj, këtë seancë e shpall të mbyllur! Mirupafshim nesër në orën 10:00!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve të Kuvendit të Kosovës